



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR



RAPORTI VJETOR 2023

PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

SHKODËR

SHKURT 2024

RAPORTI VJETOR

MBI ECURINË E PUNËS NË PROKURORI PËR VITIN 2023

Bazuar në detyrimet ligjore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, të parashikuara nga neni 50 e vijues i ligjit Nr.97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm me Nr.72/1 prot, datë 15.01.2023, "Për paraqitjen e raportit vjetor për ecurinë e punës në prokurori në vitin 2023", si dhe bazuar në përcaktimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 06.07.2023 „Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithëshme për vitin 2022“, urdhërit Nr.103, datë 25.07.2023 «Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023», në Rekomandimet Prioritare të miratuara me VKM Nr.226, datë 13.04.2023, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.2/2023, dhe planit të veprimit të miratuar me urdhërin nr.70/2023, për zbatimin e rekomandimeve prioritare, «Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në kundër kriminalitetit për vitin 2023», të Urdhërave dhe Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe në mbështetje të legjislacionit penal në tërësi, paraqesim përpara Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, raportin vjetor të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për vitin 2023.

I nderuar z. Prokuror i Përgjithshëm !

Ju paraqesim Raportin Vjetor 2023, me treguesit e punës për periudhën një vjeçare në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Gjatë vitit 2023, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, si dhe Prokurorisë pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë dhe në vijim pas miratimit të "Hartës së Re Gjyqësore", gjatë punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është synuar realizimi në mënyrë sa më të plotë dhe korrekte i detyrave tona Kushtetuese dhe Ligjore.

Ngarkesa e punës gjatë vitit 2023, qoftë në periudhën Janar-Prill dhe në vijim Maj-Dhjetor 2023, ka qenë në të njëjtat parametra me një vit më parë më një trend në zbritje, e cila në disa drejtime është përballuar edhe gjatë këtij viti nga një trupë e reduktuar e prokurorëve, të ndihmuar nga oficerët e policisë gjyqësore dhe administrate e saj, në ushtrimin e ndjekjes penale, mbrojtjen dhe përfaqësimit e akuzës në gjykim, veprimet dhe detyrat në fazën e ekzekutimeve, marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, si dhe në kryerjen e detyrave të tjera administrative-penale.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (në pjesën më të madhe të vitit Maj-Dhjetor 2023), ka në strukturë një organikë prej 20 prokurorësh, ku efektivisht gjatë këtij viti kanë ushtruar detyrën vetëm 11 deri në 15 prokurorë në pjesën e dytë të vitit me ndryshime gjatë vitit, që do të thotë, se vetëm rreth 2/3 e strukturës

apo organikës ka qenë në detyrë efektivisht gjatë këtij viti, fakt ky që ka ndikuar në nivelin e ngarkesës së prokurorëve, numrin e dosjeve të përfunduara, numrin e dosjeve të mbartura në hetim dhe problematika të tjera të dala gjatë këtij viti.

Përtej vështirësive dhe problematikave të evidentuara, prokurorëve u është kërkuar në vijimësi zbatimi i drejtë dhe aplikimi i të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe i të gjitha parashikimeve ligjore të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, në tërësi të legjislacionin penal, etj.

Duhet pranuar se janë hasur vështirësi dhe problematika gjatë fazës së bashkimit të prokurorive, por që është arritur të kalohen gjatë kësaj periudhe me angazhimin e të gjithë personelit, si dhe të faktit që ngarkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë nuk ka qenë në një ngarkesë të lartë. Fakt që ka ndikuar pozitivisht në bashkimin e shpejtë të dy prokurorive.

Gjithashtu, gjatë gjithë vitit është punuar për hartimin dhe nxjerrjen e akteve dhe rregullave standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, në zbatim të rregullores së brendshme, me qëllim sigurimin e një organizimi, drejtimi dhe kontrolli efikas të punës në prokurori, të rritjes dhe garantimit të pavarësisë së prokurorëve dhe nxitjen për kuptimin dhe zbatimin sa më drejtë dhe në mënyrë efikase të përgjegjësive nga çdo prokuror dhe oficer i policisë gjyqësore, si dhe nga ana e administratës dhe nënpunësve të tjerë të prokurorisë.

Sipas urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm, për përgatitjen e raportit vjetor, paraqesim të dhënat si më poshtë:

❖ DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT NË VITIN 2023.

- Masat e marra për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të dala në zbatim të saj.
- Masat e marra për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Masat e marrë në kuadër të misionit kushtetues dhe ligjorë të prokurorisë dhe forcimin e ligjshmërisë;
- Masat e marrë për luftën kundër korrupsionit;
- Masat e marrë në luftën kundër krimit të organizuar;
- Masat e marra për respektimin e të drejtave të njeriut;
- Masat e marra për respektimin e të drejtave të miturve dhe grupeve vulnerabël, si të pandehur dhe viktimat;
- Masat e marra për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;

- Masat e marra për rritjen e përdorimit të metodave speciale hetimore dhe në hetimet proaktive;
- Problematikat e hasura gjatë vitit 2023.

❖ **Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre, etj.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka qenë e angazhuar gjatë gjithë vitit 2023, në marrjen e masave për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave si dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerrë në zbatim të tyre, në lidhje me këto prioritetet;

- *Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë datë 06.07.2023, "Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2022";*
- *Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.103, datë 25.07.2023, "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023";*
- *Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave miratuar me vendimin Nr.226, datë 13.04.2023, "Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm";*
- *Udhëzimi i Përgjithshëm Nr.02, datë 12.05.2023 "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm".*
- *Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.70, datë 12.05.2023, "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023";*
- *Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr. 10, datë 17.07.2020 "Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm".*
- *Udhëzim i Përgjithshëm nr. 4 datë 18.10.2022 "Për disa shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr 10, datë 30.12.2021 "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore";*
- *Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr. 03, datë 06.09.2022, "Për ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.10/2020 „Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore nëprokuroritë me juridiksion të përgjithshëm“.*
- *Shkresa e Prokurorit të Përgjithshëm me nr.1737, datë 15.11.2023, "Mbi rritjen e efijçensës në bashkërendimin me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar";*
- *Udhëzimit të Përgjithshëm nr.08, datë 15.11.2021, "Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar";*

- Udhëzimit të Përgjithshëm nr.08/2020, datë 19.05.2020, "Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" i ndryshuar me Udhëzimin e Përgjithshëm me nr.06, datë 23.07.2021 "Për disa shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08/2020, datë 19.05.2020, "Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" të Prokurorit të Përgjithshëm;
- Udhëzimit nr. 03 datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori" të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Udhëzimin nr. 55 prot datë 10.09.2018 "Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".
- Urdhëri/ shkresa e Prokurorit të Përgjithshëm me nr.1737 prot, datë 15.11.2023 „Mbi rritjen e efikasitetit mbi bashkërendimin me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar“
- Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë Nr.02, datë 07.01.2021, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër".
- Udhëzimi i Përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë Nr.17/2, datë 04.09.2023 "Mbi njohjen dhe zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 06.07.2023".
- Udhëzimi i Përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë Nr.13, datë 29.05.2023 "Mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023".
- Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë Nr.17/3, datë 05.09.2023 "Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 "për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2022";
- Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë Nr.14, datë 29.05.2023 "Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023";
- Udhëzimi i Përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë Nr.03, datë 20.01.2023, "Për garantimin e të drejtave dhe interesave të viktimave të veprave penale gjatë hetimit të kallzimeve dhe procedimeve penale".
- Udhëzimit i Përgjithshëm Nr.12, datë 20.07.2020, «Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm» i Prokurorit të Përgjithshëm.
- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.33, datë 04.09.2020 «Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve, në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër» i Drejtuesit të Prokurorisë, i ndryshuar me udhëzimin me nr.33/1, datë 09.03.2023.
- Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë Nr.15, datë 05.06.2023 "Për delegimin e kompetencave administrative/procedurale Prokurorit të çështjes".

- Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë Nr.16, datë 09.06.2023 "Për evidentimin dhe saktësimin e procedimeve penale financiare dhe pasurore dhe saktësimin e sistemit PRESTO".
- Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë Nr.30, datë 21.11.2023 "Mbi rritjen e efikasitetit në bashkëpunimin me Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar".
- Si dhe akte të tjera nënligjore, urdhëra, udhëzime të përgjithshme, udhëzime të posaçme, vendime, etj, të dala në zbatim të tyre.

❖ Masat administrative të mara mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë;

- Në pjesën e parë të vitit 2023 ka vijuar zbatimi i parashikimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë «Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021». Ndërsa, nga muaji korrik 2023 e në vijim të administrimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë «Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022», datë 06.07.2023, si dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.103, datë 25.07.2023 «Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023», të dërguar edhe me shkresën me nr.1150/3 prot, datë 26.07.2023, të Prokurorisë së Përgjithshme, nga Drejtuesi i Prokurorisë menjëherë është bërë shpërndarja dhe njohja e këtyre akteve nga të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Në udhëzimet e dhëna në vijimësi është mbajtur parasysh dhe është respektuar në vijimësi pavarësia e institucionit dhe e prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale dhe në administrimin e materialeve hetimore dhe referuese dhe në kryerjen e hetimeve për çështje të caktuara. Gjatë këtyre takimeve dhe diskutimeve është vlerësuar nevoja e nxjerrjes ose jo të urdhërave dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe të një plan veprimi në lidhje me Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë. Në mbledhjet e zhvilluara, takimet dhe udhëzimet e dhëna janë diskutuar pikat e kësaj Rezolute dhe janë nxitur prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në zbatimin e drejtëpërdrejtë të saj gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje konkrete që janë objekt dhe prioritet i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.
- Si rezultat i këtyre takimeve dhe analizave të realizuara, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Udhëzimi i Përgjithshëm me nr.17/2, datë 04.09.2023 «Mbi njohjen dhe zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 06.07.2023», ky udhëzim u është bërë i njohur të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës, duke u diskutuar edhe në mbledhjet dhe takimet e organizuara. Ky udhëzim është nxjerrë në bazë dhe për lehtësimin e zbatimit në praktikë të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm duke e përshtatur me rrethanat konkrete dhe problematikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Në vijim janë nxitur prokurorët në garantimin e pavarësisë së tyre nga njëra anë dhe rritjen e përgjegjshmërisë së tyre nga ana tjetër. Gjithashtu, janë nxitur në forcimin e rolit të tyre në fillimin e ndjekjes penale dhe forcimin e rolit aktiv në hetimet paraprake dhe në fillimin kryesisht të ndjekjes penale. Prokurorët janë udhëzuar në kontrollin periodik dhe efektiv të punës së oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve në

lidhje me dosjet e deleguara prej tyre, kjo qoftë me informacione periodike, verifikimin e urdhërave të delegimit dhe gjendjs në të cilat ndodhen procedimet penale prej tyre. Kjo, me qëllim kryerjen e hetimeve të plota dhe cilësore dhe shmangien e vonesave dhe zvarritjeve në përfundimin e hetimeve.

- Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore janë udhëzuar që të angazhohen drejtëpërdrejtë në rritjen e tyre profesionale, në plotësimin e formularëve për trajnime dhe seminare dhe për pjesëmarrjen fizike të tyre ose online në trajnimet e realizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Drejtësisë, si dhe nga organizatat dhe shoqatat e tjera vendase dhe të huaja duke respektuar edhe fushat specifike ku ata kanë më shumë nevojë apo në lidhje me veprat penale problematikat që u kanë dalë në seksionet ku ata ushtrojnë detyrën.
- Në vijimësi, janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime konkrete për çështje të caktuara nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe janë kërkuar informacione në lidhje me çështje konkrete objekt i Rezolutës së Kuvendit. Në rastet kur është vlerësuar se këto detyra dhe objektiva në procedimet penale konkrete janë komplekse, ka zvarritje apo vonesa dhe nuk janë përfunduar me përparësi nga ana e prokurorëve, si dhe nuk janë kryer veprimet hetimore me përparësi nga ana e oficerëve të çështjeve konkrete është udhëzuar dhe rekomanduar kryerja me prioritet e detyrave të lëna. Në disa raste janë nxjerrë edhe udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete për të cilat janë vlerësuar të domosdoshme apo rastet prioritet i Rezolutës së Kuvendit.
- Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë «Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022», datë 06.07.2023, si dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.103, datë 25.07.2023 «Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023», nga Drejtuesi i Prokurorisë është nxjerrë urdhëri me nr.17/3, datë 05.09.2023 «Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 06.07.2023, «Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022», ky urdhër së bashku me planin e veprimit u është bërë i njohur prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, duke u diskutuar edhe në mbledhjet dhe takimet e organizuara. Ku urdhëri ka nxjerrë detyra dhe objektiva konkrete për zbatim nga ana e prokurorëve dhe oficerëve me qëllim zbatimin sa më të plotë në praktikë të Rezolutës dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Në mbledhjet e zhvilluara, takimet dhe udhëzimet e dhëna janë diskutuar pikat e këtij plani veprimi, mënyra e zbatimit të tij dhe fazat e zbatimit. Gjithashtu, janë orientuar Drejtuesit e Seksioneve, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në zbatimin e drejtëpërdrejtë të tij gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje konkrete, si dhe në kryerjen e detyrave administrative që janë objekt dhe fokus i Rezolutës dhe i urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Janë marrë masa dhe janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime edhe për oficerët e policisë gjyqësore në drejtim të rritjes së cilësisë dhe efektivitetit të veprimeve hetimore të kryera prej tyre, në lidhje me raportimet periodike për veprimet e kryera, si dhe për rritjen e cilësisë së relacioneve të çështjeve të përfunduara dhe shpejtësisë së përfundimit të tyre.
- Gjatë vitit 2023, është nxitur bashkëpunimi i ngushtë dhe efektiv me të gjitha shërbimet e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër dhe Komisaritet, në

Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, si dhe Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat, me policinë gjyqësore të Doganave dhe të Hetimit Tatimor, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, etj. Ku si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë kryer hetime në vijimësi duke përdorur edhe metodat speciale të hetimit. Gjithashtu, vijojnë hetimet për një sërë procedimesh penale të referuara nga këto institucione në bashkëpunim mes këtyre shërbimeve të policisë gjyqësore.

- Në vazhdimësi janë marrë masa konkrete për përmirësimin e “Sistemit të menaxhimit të çështjeve” (CAMS), duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë e IT-së dhe Drejtorinë Ekonomike dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme, me qëllim rishikimin dhe mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve, për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm mbi hedhjen dhe administrimin e këtyre të dhënave. Duhet theksuar se edhe gjatë këtij viti ka pasur disa raste të mosfunksionimit si duhet të sistemit Cams, për disa orë apo në ditë. Gjithashtu, është kërkuar përgjegjshmëri në hedhjen dhe nxjerrjen e statistikave nga zyra e regjistrit.
- Janë hasur vështirësi edhe gjatë këtij viti për shkak të mungesës së bazës së mjaftueshme materiale për të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore apo vjetërsisë e amortizimit të tyre dhe mungesës së parametrave optimale të tyre. Kjo për shkak të mungesës së kompjuterave, të printerave, fotokopjeve dhe pjesës tjetër të bazës materiale, e cila vazhdon të mos jetë në sasinë e mjaftueshme, të jenë në gjendje jo optimale apo të vjetëruara, etj. Gjithashtu, largësia e zyrave të Prokurorisë me godinën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër vijon të krijojë probleme, vonesa dhe humbje kohe të vlefshme për magjistratët duke pritur në vijimësi zhvillimin e seancave gjyqësore, e cila ka krijuar vonesa, zvarritje dhe humbje kohe në masë të konsiderueshme në raport me kohën që duhet tu shërbejë prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale. Në këtë drejtim duhet të shtohen fondet e buxhetit për vitet në vijim me qëllim shmangien e mungesave dhe krijimin e kushteve sa më normale të punës.
- Duhet theksuar se, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, janë hasur vështirësi për shkak të organikës së vogël faktike të numrit të prokurorëve gjatë këtij viti në raport me numrin e përgjithshëm të organikës (*aktualisht organika është me 20 prokurorë dhe gjendja faktika është me 13 prokurorë dhe vetëm në tetor 2023 organika ka shkuar 15 prokurorë për vetëm 2 muaj, pasi në dhjetor janë larguar 2 prokurorë, ku një prokuror është zgjedhur në KLP dhe 1 prokuror është pezulluar për shkak të procesit të Vetingut*), por megjithatë është ruajtur ndarja e seksioneve me 3 seksione (*Seksioni i Përgjithshëm, Seksioni për të Miturit dhe dhunën në familje ... dhe Seksioni i Posaçëm*) si dhe Zyra apo Seksioni për Ekzekutimet dhe Marrëdhëniet Juridiksonale me Jashtë me 1 prokuror.
- Gjatë kësaj periudhe me ardhjen e magjistratëve të rinj, janë plotësuar tre seksionet me nga tre prokurorë në respektim të parashikimeve ligjore dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, janë transferuar edhe dy prokurorë të rinjë dhe është rikthyer një prokuror pas procesit të «Vetingut», por që efektivisht do të fillojnë punën gjatë muajit Tetor 2023, ku vetëm pas kësaj periudhe ka pasur një përmirësim të punës dhe ndarjes së ngarkesës në këtë prokurori, por është zbehur gjatë muajit Dhjetor 2023.

- Gjatë këtij viti, ka pasur 1 prokurorë të pezulluar për shkak të procesit të Vetingut dhe 1 prokuror është zgjedhur anëtar në KLP duke u larguar gjatë kësaj periudhe Tetor-Dhjetor 2023, fakt që ka ndikuar në punën dhe ngarkesën në prokurori duke e frenuar uljen ngarkesës në prokurori. Një fakt ky që ka ndikuar edhe në cilësinë dhe shpejtësinë në hetimeve dhe në zbatimin e detyrimeve dhe të prioritetëve të Rezolutës.

❖ **Treguesit dhe indikatorët në lidhje me pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake.**

- Edhe gjatë vitit 2023, ka vijuar puna për konsolidimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorëve, qoftë në respektimin e garancive kushtetuese dhe ligjore por nga ana tjetër edhe evidentimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së tyre në raport me punën dhe palët në proces. Është synuar në respektimin e afateve hetimore dhe procedurale në tërësi, si dhe në respektimin e të drejtave dhe kërkesave të palëve dhe kthimin e përgjigjeve në kohë.
- Sipas të dhënave statistikore në këtë prokurori, rezultojnë trajtuar rreth 4017 materiale të ndryshme. Janë raportuar rreth 400 materiale të referuara. Janë mosfilluar rreth 356 kallëzime penale, nga këto 339 mosfillime për kallzime të Prokurorisë Shkodër dhe 17 mosfillime për kallzime të Prokurorisë Pukë.
- Gjatë këtij viti janë hetuar gjithësej 2708 procedime penale duke përjashtuar kallëzimet e mosfilluara apo në verifikim, apo dosjet e parashkuara, etj, (nga këto të mbartuara nga viti 2022 janë rreth 1047 procedime penale (1012 të Prokurorisë Shkodër dhe 35 të Prokurorisë Pukë) dhe të regjistruara si të reja gjatë këtij viti janë 1641 procedime penale (1616 procedime penale të Prokurorisë Shkodër dhe 25 procedime penale të Prokurorisë Pukë) dhe të ardhura me transferim 23 procedime penale dhe të rifilluara 15 procedime penale të tjera).
- Gjatë këtij viti, nga këto procedime penale në tërësi janë përfunduar hetimet për 2013 procedime penale (1956 procedime penale të Prokurorisë Shkodër dhe 57 procedime penale të Prokurorisë Pukë) dhe janë në hetim 695 procedime penale (692 procedime penale të Prokurorisë Shkodër dhe 3 procedime penale të Prokurorisë Pukë). Njëkohësisht është marrë pjesë në gjykimin e 1406 çështjeve penale themeli me rreth 1689 të pandehur, si dhe në shumë çështje të tjera penale administrativo-penale, heqje zotësie, kërkesa mjekësore apo me të dëmtuar akuzues sipas nenit 59 të K.Pr.Penale, si person i tretë dhe kërkesa të tjera në fazën e ekzekutimit, etj.
- Pavarësisht ngarkesës së madhe në punë, nga prokurorët e kësaj prokurorie në kuadër të bashkëpunimit me policinë e shtetit është rritur numri i hetimeve proaktive. Prokurorët janë zëvendësuar vetëm në respektim të kritereve dhe kushteve ligjore sipas parashikimeve të ligjit procedural penal.
- Gjatë gjithë vitit ka vijuar puna në drejtim të afirmimit dhe konsolidimit qoftë të pavarësisë së prokurorit ashtu edhe në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë së tij. Duke synuar që të bëhet e qartë që pavarësia e prokurorit është pavarësia dhe autonomia e tij për marrjen e vendimeve në kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale, përfaqësimin në gjyq të çështjeve dhe/ose akuzave penale dhe urdhërimin ose mbikqyerjen e ekzekutimit të vendimeve penale. Gjithashtu, ata duhet të kuptojnë qartë që ndjekja penale është një detyrim kushtetues dhe ligjor i tyre. Nga ana tjetër duhet të mbajnë përgjegjësi dhe përgjegjshmëri në raport me interesin publik, respektimin e afateve procedurale dhe të drejtat dhe garancitë ligjore të palëve në proces dhe respektimin e transparencës dhe gjithashtu ruajtjen e sekretit hetimor.

- Rezulton se janë filluar kryesisht 15 (pesëmbëdhjetë) procedime penale (në raport me 10 procedime në vitin 2022, me një rritje prej 5 procedimesh apo me rritje 50%), por janë edhe disa procedime të tjera të filluara kryesisht mbi bazën e njoftimeve të përcipta apo indirekte dhe jo mbi bazën e kallëzimeve penale konkrete. Në këtë drejtim megjithëse ka një trend rritës, vlerësojmë se duhet të vijojnë akoma më shumë puna dhe nxitja e prokurorëve në drejtim të shtimit të numrit të procedimeve penale të filluara kryesisht. Në këtë drejtim, duhet pranuar se ngarkesa e madhe me dosje në verifikim, hetim dhe gjykim deri në vitin 2023 ka ndikuar drejtëpërdrejtë dhe frenuar prokurorët në fillimin kryesisht të procedimeve penale.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, përsa i përket veprave të rënda penale dhe ato objekt i Rezolutës si dhe ato me ndjeshmëri të lartë shoqërore apo me interes për publikun ka nxitur dhe udhëzuar qoftë prokurorët ashtu dhe oficerët e policisë gjyqësore në kryerjen e hetimeve të plota dhe të thelluara, me qëllim hetimin e plotë të çështjeve penale konkrete apo në zbulimin dhe identifikimin formave të bashkëpunimit të veçantë në kryerjen e veprimtarisë kriminale.
- Rezulton se gjatë vitit 2023, është rregjistruar 2 (dy) procedime penale për nenin 244 të K.Penal, me 1 (një) person nën hetim. Nga këto procedime, për një procedim penal janë përfunduar hetimet dhe është dërguar për gjykim me 1 person të marrë të pandehur, ndërsa për një procedim penal vijojnë hetimet.
- Në lidhje me nenin 259 të K.Penal, rezulton se janë hetuar 11 (njëmbëdhjetë) procedime penale, ku janë mbartur 7 (shtatë) procedime penale me 3 persona nën hetim dhe janë rregjistruar edhe 4 (katër) procedime penale të reja me 2 persona nën hetim, nga të cilët 6 (gjashtë) procedime penale me 4 persona nën hetim janë pushuar për mungesë prova apo mungesë fakti dhe 1 (një) procedim penal është pezulluar, ndërsa vijojnë të jenë në hetim 4 (katër) procedime penale.
- Në vijimësi janë udhëzuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, që në lidhje me këto grup veprash penale të synohet në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së hetimeve (realizimin e hetimeve proaktive), kryerjen e hetimeve të shpejta, si dhe përdorimin e metodave speciale të hetimit, rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe agjencitë ligjzbatuese në realizimin e hetimeve sa më të plota, si dhe në ashpërsimin e qëndrimeve dhe të politikës penale si në caktimin e masave të sigurimit ashtu edhe në masën e dënimeve.
- Në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 248 të K.Penal, gjatë këtij viti janë hetuar 79 procedime penale. Ku dy procedime penale i përkasin Prokurorisë Pukë, 1 procedim penal të mbartur dhe 1 procedim penal të ri të rregjistruar gjatë këtij viti, ku të dy procedimet penale vijojnë të jenë në hetim. Ndërsa, nga Prokuroria Shkodër, rezulton se janë mbartur 45 (dyzet e pesë) procedime penale dhe janë rregjistruar edhe 32 (tridhejtë e dy) procedime penale të reja. Nga procedimet e hetuara për nenin 248 të K.Penal, janë përfunduar hetimet për 59 (pesëdhjetë e nëntë) procedime penale, ku 14 procedime penale me 51 të pandehur janë dërguar për gjykim, ndërsa 44 procedime penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim, 1 procedim penal është pezulluar, ndërsa 4 procedime penale janë transferuar në prokuroritë kompetente. Vijojnë hetimet për 16 procedime penale të tjera.
- Rezulton se me krijimin e «Seksionit të Posaçëm» seksionit kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimeve pasurore, ku këto vepra janë përfshirë si pjesë e këtij seksioni, ku janë marrë masa për plotësimin e tij dhe në vijim janë nxitur dhe orientuar prokurorët dhe oficerët në dhënien përparësi të hetimeve të

këtyre veprave dhe procedimeve penale në përputhje me parashikimet e prioriteteve të rezolutës. Ku evidentohet fakti se janë hetuar një numër më i madh procedimesh penale dhe gjithashtu janë përfunduar një numër më i madh procedimesh penale dhe numri i procedimeve penale në hetim dhe të mbartura ëshë më i vogël. Gjithashtu, evidentohet fakti se një numër më i madh çështjes dhe personash në hetim janë marrë të pandehur duke u dërguar për gjykim.

- Gjatë të vitit 2023, janë hetuar 60 (gjashtëdhjetë) procedime penale në lidhje me veprën penale të «Pastrimit të produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale», parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (nga këto 1 procedim penal është i Prokurorisë Pukë, i mbartur nga viti 2022 dhe për të është marrë vendim për moskompetencë duke e dërguar në prokurorinë kompetente). Nga këto procedime janë 47 procedime penale të mbartura dhe 11 (njëmbëdhjetë) procedime penale të reja të rregjistruara gjatë këtij viti. Nga këto procedime, 4 procedime penale me 10 persona të pandehur janë dërguar për gjykim duke u akuzuar edhe për nenin 287 të K.Penal, të lidhura edhe procedime dhe me vepra të tjera penale ose jo. Ndërsa, për 28 (njëzet e tetë) procedime penale është paraqitur në gjykatë kërkesë për pushimin e çështjes pasi nuk provohet kryerja e vepres penale, mungesë provash, mungesë fakti, etj. Ndërsa 3 procedime penale janë transferuar në Prokuroritë kompetente. Për 7 procedime penale është marrë vendim për pezullimin e hetimeve kryesisht për shkak të nisjes së letërporosive. Për procedimet penale të tjera 21, po vijojnë hetimet. Duhet theksuar se ka një ulje të referimeve penale në lidhje me këtë vepër penale në raport me vitet e kaluara, por këtë vit ka dosje të dërguar për gjykim si dhe kërkesa për sekuestro dhe konfiskime. Në dy raste personat e dërguar për gjykim janë deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të K.Penal, ndërsa vijon gjykimi për rastet e tjera.
- Në vijimësi vihet re se vazhdon cilësia jo e kënaqëshme e referimeve në lidhje me këtë veper penale. Kjo ka bërë që edhe numri i veprimeve hetimore dhe akteve të kërkuara të jetë i madh dhe të ketë zgjatje në kohë deri në marrjen e një vendimi përfundimtar. Për këto arsye, është hasur në vështirësive në evidentimin e saktë të pasurive me burim të paligjshëm të subjekteve të referuara apo subjekteve të lidhur dhe me provueshmërisë e krijimit të saj në rrugë kriminale dhe për mundësinë e ngritjes së një akuze të bazuar. Në lidhje me këto vështirësi kanë ndikuar jo vetëm lëvizja e prokurorëve dhe e oficerëve të shërbimeve, por gjithashtu edhe ngarkesa me dosje në hetim, niveli i lartë i informalitetit dhe gjithashtu vonesat në kthimin e përgjigjeve nga institucione të ndryshme dhe vështirësitë në gjetjen e ekspertëve dhe në kryerjen e akteve të ekspertimeve financiare dhe kontabël, etj.
- Nga këto janë mbi **5 raste të vendosjes së sekuestros preventive** mbi pasuri të paluajtshme me dyshime se burojnë nga veprimtari kriminale kërkesa këto të miratuara nga gjykata dhe të vëna në ekzekutim.
- Në këtë drejtim hetimit dhe evidentimit të të dhënave të mësipërme është nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë Urdhëri me nr.16, datë 09.06.2023 «Për evidentimin dhe saktësimin e procedimeve penale financiare dhe pasurore dhe saktësimin e sistemit presto», me qëllim evidentimin dhe rakordimin periodikisht të hetimeve dhe procedimeve penale financiare për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/b të K.Penal, plotësimin në kohë reale dhe mbajtjen e saktë të sistemit Presto dhe rakordimin me Pikën e Kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme. Ku janë orientuar prokurorët që në përfundim të hetimeve dhe paraqitjes së kërkesës për gjykim apo për pushim sipas rastit, apo vendimarrje tjetër, të dërgojnë menjëherë një kopje të vendimit apo kërkesës zyres së rregjistrat dhe pikës së kontaktit, me qëllim hedhjen e të dhënave në sistemin PRESTO.

- Gjatë vitit 2023, rezulton se janë hetuar 60 (gjashtëdhjetë) referime pasurore, në lidhje me procedime të tjera penale ose jo. Këto procedime pasurore për 9 raste është marrë vendim mosfillimi, ndërsa për 16 raste është marrë vendim pushimi të hetimit pasuror. Këto procedime pasurore konstatojmë që janë në rënie gjatë këtij viti dhe kanë problematika të ngjashme me procedimet penale të rregjistruara për vepren penale të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal. Gjatë këtij viti thuajse nuk ka pasur referime të reja pasurore, ku për 9 raste është marrë vendim mosfillimi. Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështje të referimeve pasurore me vendim pushimi pasi nuk është evidentuar pasuri konkrete me prejardhje kriminale. Gjithashtu, ka pasur 7 (shtatë) raste të vendosjes së sekuestros konservative në lidhje me prona me prejardhje të dyshuar me burime të paligjshme dhe **2 (dy) raste të konfiskimit të këtyrë pasurive**.
 - Nga procedimet penale të rregjistruara dhe hetuara gjatë vitit 2023, rezulton se mbi 40 (dyzet) procedime penale të mbartura dhe të rregjistruara të reja, janë hetuar me metodat speciale të hetimit, duke zhvilluar hetime proaktive (përgjime ambjentale dhe telefonike, vëzhgime, blerje e simuluar, e metoda të tjera speciale, etj), kryesisht në lidhje me vepra të rënda penale kundër jetës dhe shëndetit, në lidhje me narkotikët (prodhim, shitje, trafikim, kultivim), në lidhje me shpërdorimin e detyrës, korrupsionit, si dhe në lidhje me trafikimin e personave apo shfrytëzimin e prostitucionit, etj.
- ❖ **Të dhëna në lidhje me masat efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje dhe me bazë gjinore dhe veprat penale me të mitur.**
- Gjatë këtij viti ka pasur **81 referime** për vepra penale ku janë përfshirë persona të mitur si të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë të vepres penale. Nga këto, për 12 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal.
 - Ndërsa, në 47 raste është vendosur rregjistrimi i procedimit penal me të mitur autorë si të mitur në konflikt me ligjin. Ku nga 32 persona nën hetim, 31 janë të mitur meshkuj dhe vetëm 1 është e mitur femër në konflikt me ligjin. Nga këto rezulton se të miturit në konflikt me ligjin ndahen në grupmoshat 14-16 rreth 11 të mitur dhe në grupmoshën 16-18 vjeç janë 20 të mitur.
 - Në këto çështje në 1 rast është caktuar masa e sigurimit arrest në burg, për vepra të rënda penale (neni 139-25) dhe faktit që i mituri është përsëritës, ndërsa në 3 raste janë caktuar masat e sigurimit arrest në shtëpi dhe në pak raste detyrim paraqitje. Në 12 raste është marrë masa e shmangies nga ndjekja penale për të miturit në konflikt me ligjin dhe pushimi i çështjes. Ndërsa 10 çështje me 10 të mitur në konflikt është marrë masa e verejtjes me shkrim dhe në 2 raste masë tjetër shmangieje.
 - Në 10 çështje me 10 të mitur në konflikt me ligjin janë dërguar për gjykim. Ndërsa vijojnë hetimet për rastet e tjera.
 - Rezulton se nga këto procedime penale, 20 procedime penale kanë qenë me viktimë të vepres penale të mitur, rreth 22 viktimë, nga të cilat 10 viktimë femra dhe 12 viktimë meshkuj.
 - Në lidhje me procedimet penale me viktimë të vepres penale të mitur rezulton se ka pasur një sërë procedimesh. Për tu theksuar është fakti që referimet e këtyre grupveprave janë relativisht të dobëta dhe nga ana tjetër haset në vështirësi në gjetjen dhe sigurimin e provave që provojnë vepren penale dhe fajësinë e autorëve, kjo edhe për shkak të mungesës së bashkëpunimit të plotë të viktimave të këtyre veprave penale, qoftë viktimave gra të përndjekjes apo dhunës në familje apo dhunës seksuale por edhe viktimave të mitur në lidhje me braktisjen e të miturve, keqtrajtimit apo dhunës seksuale

etj, kjo edhe për shkak të raportit të afërt i dyshuar-viktimë (në shumë raste janë anëtar të së njëjtës familje) që ndikon edhe në kryerjen e hetimeve të plota dhe të shpejta dhe cilësore nga ana procedurale dhe me synimin dhënien e dënimeve sa më të përshtatshme me këto raste dhe vepra penale.

❖ **Në lidhje me shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve dhe agjensive ligjzbatuese.**

- Gjatë vitit 2023, është synuar dhe mbajtur një bashkëpunim të ngushtë dhe efektiv me të gjitha shërbimet e Policisë Gjyqësore në Prokurori, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër dhe Komisariatet, në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, si dhe Agjensinë e Mbikqyerjes Policore, me policinë gjyqësore të Doganave dhe të Sektorit Verior të Hetimit Tatimor, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, etj. Ku si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë kryer hetime në vijimësi duke përdorur edhe metodat speciale të hetimit.
- Në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar është synuar në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore (Shish, Tatime, Dogana, AMP, DPPSH, etj), për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike. Janë udhëzuar dhe orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në përmirësimin e referimeve si fillim dhe në vijim të cilësisë së hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë të pastrimit të parave në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim dhe përdorimit të teknikave speciale të hetimit.
- Gjithashtu, janë nxitur prokurorët në rritjen dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet hartimit në kohë të letërporosive, në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qënieve njerëzore, etj.
- Gjatë kësaj periudhe rezulton se, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 278 të K.Penal, janë mbartur në hetim 9 procedime penale dhe janë rregjistruar edhe 25 procedime penale të reja, në lidhje me paragrafë të ndryshëm të kësaj vepre penale. Nga këto procedime, rezulton se 12 procedime penale me 16 persona të pandehur janë dërguar për gjykim. 1 procedim penal është pushuar për shkaqe të tjera, 1 procedim penal është transferuar në prokurorinë kompetente dhe 11 procedime penale janë pezulluar. Ndërsa vijojnë të jenë hetim edhe 9 procedime penale të tjera.
- Gjatë kësaj periudhe rezulton se, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 278/a të K.Penal, janë mbartur në hetim 3 procedime penale dhe janë rregjistruar dhe 1 procedim penale i ri. Ndërsa në lidhje me dy kallzime penale të paraqitura nga DVP Shkodër, ndër të tjera edhe për nenin 278/a të K.Penal, në njërin rast është marrë vendimi mosfillimi, ndërsa në rastin tjetër procedimi është rregjistruar për vepra të tjera penale, si për nenin 278 të K.Penal. Nga këto procedime, rezulton se për 1 procedim penale është marrë vendim pezullimi, ndërsa vijojnë të jenë hetim edhe 3 procedime penale të tjera.
- Gjatë kësaj periudhe duhet theksuar se referimet në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 278/a të K.Penal, janë të dobëta, si në sasi ashtu edhe në cilësi, pa të dhëna të sakta apo të mangëta që kanë ndikuar në zgjatjen e hetimeve dhe nga ana tjetër në pezullimin apo pushimin e tyre pasi nuk është arritur të sigurohet prova të sakta për identifikimin e autorëve dhe ngritjen e akuzës ndaj tyre. Në këtë drejtim duhet të

shtohen përpjekjet dhe koordinimi i informacionit me të gjitha agjensitë ligjzbatuese në mënyrë që të sigurohen të dhëna të plota në drejtim të rritjes së cilësisë së hetimeve për këtë veper penale.

- Në vijimësi është synuar të rritet shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira në këtë drejtim (agjencitë ligjzbatuese, prokuroria dhe sistemi gjyqësor) për rastet e trafikimit të armëve të zjarrit dhe duhet thënë se po lëvizet në këtë drejtim por jo me ritmin dhe seriozitetin e duhur.
- Nga ana tjetër, duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe kanë vijuar, takimet, mbledhjet dhe diskutimet me prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në drejtim të përmirësimit të zbatimit të manualit për pastrimine parave dhe rikuperimin e aseteve në kuadrin e projektit FILAPP.
- Janë nxitur prokurorët dhe është synuar në drejtim të rritjes së efektivitetit të hetimeve financiare. Me synim shtimin e rasteve të sekuestrimit dhe konfiskimeve dhe nga ana tjetër shtimin e çështjeve të dërguara për gjykim dhe rastet e dënimeve të të pandehurve në lidhje me këto vepra penale.
- Në këtë drejtim prokurorëve dhe policisë gjyqësore u është kërkuar dhe janë orientuar në shtimin e trajnimeve dhe seminareve në lidhje me fushat e pastrimit të parave dhe hetimeve financiare me qëllim për të përmirësuar teknikat e hetimit financiar.
- Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë sugjeruar prokurorët dhe oficerët që të plotësojnë formularët e trajnimeve vazhduese duke zgjedhur tema në lidhje me këto grup veprash në mënyrë që të marrin trajnime dhe njohuri me metodat dhe praktikat e reja më të mira të hetimit të tyre.
- Në vijimësi është synuar në drejtim të rritjes së eficensës së hetimeve për çështjet e pastrimit të parave, si dhe rritjen e bashkëpunimit institucional ndërmjet Institucioneve Financiare, Agjensisë së Inteligjencës Financiare, Policisë së Shtetit, etj, në lidhje me rastet e monedhave të falsifikuara në vend.
- Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe janë hetuar 4 raste në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 183 të K.Penal, kryesisht janë procedime penale të mbartura. Nga këto procedime penale, për 1 rast me 1 person të marrë të pandehur është dërguar për gjykim, ndërsa për dy raste janë marrë vendime për pezullimin e hetimeve, ndërsa 1 rast vijon të jetë në hetim.
- Prokurorët janë nxitur dhe orientuar në drejtim të shtimit të kapaciteteve institucionale dhe profesionale të tyre, si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional nëpërmjet përdorimit të rrjetit të pikave të kontaktit, të ngritur në zbatim të Konventës së KiE-së për krimin kibernetik për të rritur efektivitetin në lufën kundër krimin kibernetik dhe mashtrimin në internet.
- Gjatë vitit 2023, të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë ndjekur seminare dhe trajnime në lidhje me aplikimet e bëra më parë prej tyre në Shkollën e Magjistraturës apo institucione të tjera. Trajnime dhe seminare që po vijnë edhe në vijim të këtij viti, sipas aplikimeve dhe profileve të punës së prokurorëve dhe oficerëve dhe sipas seksioneve ku bëjnë pjesë apo për seminare të vlerësuara sipas nevojës së tyre dhe aplikimeve të bëra në Shkollën e Magjistraturës, trajnimeve të organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë apo nga shoqata dhe organizata vendase apo të huaja.
- Në vijimësi gjatë gjithë vitit ka vijuar rritja e komunikimit dhe forcimi i bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të

përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal, etj. Duhet thënë se në vijimësi janë kthyer përgjigjet dhe informacionet e kërkuara nga ILD sipas kërkesave të tyre, duke respektuar afatet procedurale dhe natyrën e kërkesës, që në disa raste duhet thënë se kemi hasur në vështirësi për shkak të kërkesave voluminoze apo për shkak të vështirësive të nxjerrjes të të gjitha të dhënave të kërkuara nga ILD, duke qenë se kërkesat përfshijën të dhëna që nuk disponohen në mënyrë elektronike apo në sistemit elektronike si, CAMS, PRESTO, etj.

- Në vijimësi nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë marrë masat e duhura administrative dhe procedurale në lidhje me zbatimin e planit të veprimit dhe evidentimin e ecurisë së zbatimit të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

❖ **Masat administrative të mara mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave;**

- Menjëherë pas administrimit të akteve dhe shkresave përkatëse nga Prokuroria e Përgjithshme dhe të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.226, datë 13.04.2023, si dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.02, datë 12.05.2023, “*Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm*”, të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është bërë shpërndarja dhe njohja e këtyre akteve të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Në vijim janë organizuar takime, diskutime dhe mbledhje, Mbledhja e Prokurorëve dhe mbledhjet e prokurorisë ku janë diskutuar këto Rekomandime Prioritare dhe janë orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata në zbatimin e drejtëpërdrejtë dhe më përparësi të tyre gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje që janë objekt i Rekomandimeve Prioritare. Gjatë kësaj periudhe, është synuar në përvetësimin dhe zbatimin me përparësi të prioriteve sipas rëndësisë së tyre dhe rasteve konkrete të verifikuara, të hetuara apo të përfaqësimit në gjykim.
- Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Udhëzimi i Përgjithshëm me nr.13, datë 29.05.2023 «*Mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023. ...*». Në vijim është bërë shpërndarja dhe njohja e tij për të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Shkodër dhe administratës. Në mbledhjet dhe diskutimet e realizuara janë udhëzuar dhe orientuar prokurorët në përvetësimin dhe zbatimin e rekomandimeve prioritare në tërësi dhe secilës prej prioritetëve në veçanti, kjo sipas rëndësisë dhe specifikës së zbatimit të tyre. Nëpërmjet këtij udhëzimi është synuar në zbatimin sa më të plotë të Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, si dhe nxitja e secilit prokuror në veçanti për zbatimin e tyre në dosjet që kanë në hetim dhe gjykim.
- Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Urdhëri me nr.14, datë 29.05.2023 «*Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për zbatimin e rekomandimeve prioritare të këshillit të ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023*». Në vijim është bërë shpërndarja dhe njohja e tij për të gjithë prokurorët

dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Shkodër dhe administratës. Në mbledhjet dhe diskutimet e realizuara për këtë fakt, janë udhëzuar dhe orientuar prokurorët në zbatimin rigoroz të planit të veprimit duke respektuar detyrimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet brenda të cilëve duhet zbatuar këto detyrime dhe prioritete. Është synuar në përfshirjen e Zv/Drejtuesit dhe Drejtuesve të seksioneve drejtëpërdrejtë në zbatimin efektiv të këtij plan veprimi, por edhe në përfshirjen e secilit prokuror në zbatimin e këtyre pikave në çështjet e hetuara prej tyre, duke respektuar pavarësinë e tyre.

- Janë udhëzuar prokurorët për zbatimin e këtyre prioriteteve në afate konkrete, duke ngarkuar Zv/Drejtuesin dhe Drejtuesit e Seksioneve në verifikimin dhe raportimin periodik, të arritjeve, të problematikave dhe evidentimin e mënyrës së zbatimit të planit të veprimit nga secili prokuror dhe oficer.
- Në vijim të zbatimit të Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Rregullores së Brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Shkodër, nga Drejtuesi i Prokurorisë është nxjerrë Urdhëri me Nr.46, datë 07.09.2022 “Për ri-organizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër” i ndryshuar edhe gjatë vitit 2023, kjo për shkak të lëvizjeve të prokurorëve dhe oficerëve, duke marrë masat për plotësimin e tre seksioneve të prokurorisë me së paku nga tre prokurorë dhe tre oficerë për secilin seksion në raport edhe me numrin aktual të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.
- Ky fakt është ndikuar edhe nga reforma e “**Hartës së Re Gjyqësore**”, ku përsa i përket kësaj prokurorie rezulton se është shkriur Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, duke u bërë pjesë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ku janë bashkuar në organikën e kësaj prokurorie dy prokuror dhe një oficer (*një prokuror vijon të jetë i komanduar gjatë gjithë periudhës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*).
- Gjatë këtij viti, janë marrë masat e duhura dhe në kohë, për zbatimin e orientimeve, udhëzimeve dhe ndryshimeve të ndodhura në vijimësi gjatë punës në këtë Prokurori dhe reformës së hartës së re gjyqësore, qoftë nga Drejtuesi ashtu edhe nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe administrata.
- Në vijim të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.10, datë 17.07.2020 « Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm » dhe Memorandumit të Bashkëpunimit Nr.1079, datë 15.07.2020, nga Drejtuesi i Prokurorisë, si dhe kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm me nr.887/1 prot, datë 29.06.2022, për rritjen e efektivitetit të hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale të pastrimit të parave dhe procedimeve pasurore, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm me nr. 41, datë 07.07.2022, “Për rritjen e efektivitetit të hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale të pastrimit të parave dhe procedimeve pasurore”, që po vijon të zbatohet edhe gjatë kësaj periudhe.
- Nga Drejtuesi i Prokurorisë, është nxjerrë urdhëri me nr.16, datë 09.06.2023, “Për evidentimin dhe saktësimin e procedimeve penale financiare dhe pasurore dhe saktësimin e sistemit Presto”, kjo me qëllim evidentimin e saktë të procedimeve penale, pasurore dhe financiare, ku janë urdhëruar dhe orientuar të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore që kanë në hetim procedime penale financiare për

veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/b, etj të K.Penal, të rakordojnë periodikisht me zyrën e regjistrimit dhe punonjësen që mban sistemin Presto dhe Pikën e Kontaktit me Prokurorinë e Përgjithshme, në lidhje me gjendjen e këtyre procedimeve penale dhe pasurorë. Gjithashtu, u është kërkuar që në përfundim të hetimeve dhe paraqitjes së kërkesës për gjykim apo për pushim sipas rastit, apo vendimarrje tjetër, prokurori i çështjes i dërgon menjëherë një kopje të vendimit apo kërkesës zyres së regjistrimit dhe pikës së kontaktit, punonjëses që mban sistemin PRESTO, për të hedhur në sistem të dhënat e procedimit penal apo pasuror të përfunduar. Kjo ka sjellë një përmirësim në lidhje me mbajtjen sa më të saktë të të dhënave dhe të sistemit dhe ri-freskimin e sistemit në kohë reale.

- Duhet theksuar se, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, janë hasur vështirësi të shumta për shkak të organikës së vogël faktike të numrit të prokurorëve gjatë këtij viti në raport me numrin e përgjithshëm të organikës (*aktualisht organika është me 20 prokurorë dhe gjendja faktika është me 12 prokurorë*) është ruajtur ndarja e seksioneve me 3 seksione (*Seksioni i Përgjithshëm, Seksioni për të Miturit dhe dhunën në familje ... dhe Seksioni i Posaçëm*) si dhe zyra apo seksioni për ekzekutimet dhe marrëdhëniet juridiksonale me 1 prokuror. Gjatë kësaj periudhe me ardhjen e magjistratëve të rinj, janë plotësuar tre seksionet me nga tre prokurorë në respektim të parashikimeve ligjore dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Gjithashtu, janë transferuar edhe dy prokurorë të rinjë dhe është rikthyer një prokurorë por që efektivisht kanë filluar detyrën vetëm gjatë muajit tetor 2023, ku vetëm pas kësaj periudhe ka pasur një përmirësim të punës dhe ndarjes së ngarkesës në këtë prokurori. Por në vijim të kësaj periudhe Tetor-Dhjetor 2023 është larguar një prokuror i zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe është pezulluar një prokuror si pasojë e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke krijuar vështirësi në administrimin, ri-hedhjen në short dhe përfundimin e çështjeve penale nga prokurorët e tjerë brenda këtij viti.
- Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime konkrete për çështje të caktuara nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe është kërkuar informacione në lidhje me çështje konkrete objekt i Rekomandimeve Prioritare të cilat është vlerësuar se janë komplekse, janë zvarritur apo nuk janë përfunduar me përparësi nga ana e prokurorëve, si dhe nuk janë kryer veprimet hetimore me përparësi nga ana e oficerëve të çështjeve përkatëse. Në disa raste janë nxjerrë edhe udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete për të cilat janë vlerësuar të domosdoshme apo edhe ndikuar nga parashikimet e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, apo nga kërkesat e palëve dhe informacionet e vetë prokurorëve të çështjeve konkrete.
- Janë nxitur prokurorët drejtëpërdrejtë apo përmes Drejtuesve të Seksioneve në lidhje me pikat e planit të veprimit për marrjen e masave për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, duke ju kërkuar prokurorëve që në rastet që ata mund të marrin dijeni nga publiku, nga media apo informacionet që ata mund të administrojnë për shkak të funksionit apo gjatë ushtrimit të detyrës të tregohen sa më aktivë për fillimin kryesisht të hetimeve. Si rezultat i tyre, gjatë kësaj periudhe ka pasur një rritje të procedime të filluara kryesisht me 15 procedime penale.
- Në vijimësi janë udhëzuar prokurorët që të ushtrorjnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të policisë gjyqësore (OPGJ-ve), duke i inkurajuar ata që të evidentojnë

rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore për shkak të zvarritjeve dhe mungesës së dilijencës në përmbushjen e detyrave që u ngarkon ligji.

- Prokurorët në vijimësi janë udhëzuar që të evidentojnë dhe paraqesin shqetësimet dhe vështirësitë që ata lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal e procedural penal, metodikat/protokollet e hetimit për vepra ose grupvepra penale dhe që më pas këto shqetësime tu paraqiten Prokurorisë së Përgjithshme dhe Shkollës së Magjistraturës për të mundësuar trajtimin e tyre në programet e trajnimeve vazhduese, si dhe në vazhdimësi të merren masa për rritjen profesionale dhe organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në fusha specifike, sipas ndarjes së tyre në seksione brenda prokurorisë.
- Gjithashtu, janë udhëzuar që të marrin masa e duhura për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj tyre gjatë kryerjes së hetimeve, duke i inkurajuar prokurorët që të raportojnë pa asnjë hezitim rastet kur ndaj tyre është ushtruar ndonjë influencë apo ndikim i kundraligjshëm.
- Në kuadër të forcimit të mekanizmave të kontrollit dhe të llogaridhënies së prokurorit, nga Drejtuesi i Prokurorisë janë aplikuar kërkesat për informacion dhe dhënia e udhëzimeve jo detyruese, me qëllim që të mundësohet kontrolli sipas parashikimeve ligjore, si dhe në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda, të informohen ILD-ja, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm, kjo dhe në kuadër të zbatimit e monitorimit të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe akteve të nxjerra në zbatim të këtij udhëzimi. Në vijimësi u është kthyer përgjigje në kohë të të gjitha kërkesave të ILD dhe është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm për rekomandimet dhe vendimarrjen e tyre.
- Nga ana tjetër përse i përket fazës së hetimeve paraprake në vijimësi u është kërkuar prokurorëve dhe oficerëve të koordinojnë veprimet mes tyre dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të kryerjes në kohë dhe me cilësi të veprimeve hetimore dhe në administrimin e akteve dhe provave për këto çështje.
- Duhet theksuar se janë krijuar vonesa dhe zvarritje edhe nga institucione të ndryshme në kthimin e përgjigjeve, në administrimin e akteve apo të provave të ndryshme nga këto institucione. Ku disa institucione kanë kërkuar parapagimin e shërbimeve ose bllokimin e shërbimeve deri në pagimin e tyre, etj, mungesa e ekspertëve në fusha të ndryshme, si dhe pagesa të larta të ekspertëve në disa fusha, në ekspertimet financiare, kontabël apo kompjuterike, apo përkthimet në gjuhët e rralla, etj. Vonesa janë konstatuar edhe në administrimin e të dhënave nga kompanitë celulare apo atyre financiare. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa dhe procedura të komplikuar në rastet e ekspertimeve mjeko-ligjore dhe toksikologjiko-ligjore, në lidhje me dorëzimet e provave materiale, si dhe në rastet e kërkimit të kartelave mjekësore nga institucione të ndryshme mjekësore. Vështirësi dhe vonesa janë konstatuar edhe nga I.P.Sh, duke filluar që me vonesat në sjelljen e fotove kriminalistike dhe në përfundimin e tabelave fotografike të kqyerjes së vendit të ngjarjes apo sendve dhe në vijim në ekspertimet kimike të farave të Cannabis sativae, ku nga ekspertët dhe qendrat e ndryshme QTTB, janë krijuar vështirësi dhe vonesa apo pamundësi në kultivimin e tyre, si dhe ekspertimet biologjike apo atyre kompjuterike, ku nga ekspertët është konstatuar mungesë e reagentëve dhe lëndës së parë në rastin e ekspertimeve të ADN apo vështirësi në hapjen e aparateve me kode, etj në rastin e ekspertimeve kompjuterike, etj.

- Edhe në fazën e gjykimit janë orientuar dhe nxitur prokurorët në aplikimin e instituteve të reja dhe në aplikimin e gjykimeve të posaçme, si dhe në pasjen parasysh dhe zbatimin në praktikë të masave të dënimit të përshtatshme në rastin e çështjeve objekt të rekomandimeve, në ashpërsimin e tyre dhe lehtësimin e tyre sipas llojit të veprës penale, subjektit apo viktimës së veprës penale.
- Gjithashtu, janë zhvilluar mbledhje periodike me prokurorët dhe me oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me verifikimin e ecurisë së përfundimit të çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve, plotshmërisë së hetimeve, në respektimin e afateve, si dhe në respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit penal.
- Janë nxitur prokurorët në marrjen e masave të duhura në drejtim të kthimit të përgjigjeve ndaj subjekteve të procedimeve penale (person nën hetim, i pandehur, viktimë, etj) dhe mbrojtësve të tyre brenda afateve ligjore, pasi në disa raste është konstatuar vonesa apo mosrespektim i afateve apo mospranim i kërkesave të palëve të paarsyetuara nga ana e prokurorëve. Në këto raste, u është tërhequr vëmendja dhe janë nxitur prokurorët në respektimin e afateve ligjore dhe në respektimin e të drejtave të këtyre subjekteve.
- Në lidhje me luftën kundër korrupsionit në vazhdimësi janë marrë masa me qëllim rritjen e cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit që janë kompetencë lëndore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit, për aq sa është e mundur, si dhe duke rritur numrin e personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave.
- Është synuar dhe janë nxitur prokurorët në rritjen e numrit të hetimeve proaktive pasurore dhe financiare, veçanërisht për rastet që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie. Në vazhdimësi po synohet shtimi i numrit të hetimeve proaktive (*çështje të filluara kryesisht*) me qëllim përmirësimin e cilësisë së hetimeve të veprave kundër korrupsionit, si dhe rritjen e të dhënave konkrete për sa i përket çështjeve të dërguara për gjykim dhe numrit të të pandehurve të dënuar.
- Në vijimësi është synuar në drejtim të shtimit të numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe hetimit për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura, si dhe shtimi i aseteve të sekuestruara/konfiskuara. Prokurorët janë orientuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me policinë gjyqësore dhe institucionet e tjera ligjzbatuese me fokus në luftën kundër korrupsionit.
- Janë udhëzuar dhe orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, që të ndjekin me përparësi kallëzimet/çështjet penale që kanë të bëjnë me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, duke kryer hetime të plota, të paanshme, të shpejta, me profesionalizëm dhe me efektivitet, në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe SPAK-un. Ku duhet thënë se këto procedime janë përfunduar me vendimarrje përfundimtare pothuajse në tërësinë e tyre.
- Në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar është synuar në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet strukturave të prokurorisë, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore (Shish, Tatime, Dogana,

AMP, DPPSH, etj), për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike. Janë udhëzuar dhe orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në përmirësimin e referimeve si fillim dhe në vijim të cilësisë së hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë të pastrimit të parave në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim dhe përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore.

- Gjithashtu, janë nxitur prokurorët në rritjen dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet hartimit në kohë të letërporosive, në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qënieve njerëzore, etj.
- Në raport me forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut është synuar në shtimin e numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (gjykimit me marrëveshje, me urdhër penal) dhe rritja e rasteve të gjykimit të drejtëpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin, rrezikshmërinë e veprës, si dhe duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve.
- Gjatë kësaj periudhe, rezulton se ka gjetur aplikim në një masë të kënaqshme gjykimi me marrëveshje, më i kufizuar është aplikur gjykimi me urdhër penal, si dhe gjykimi i drejtëpërdrejtë. Kjo për shkak të llojit të veprave penale për të cilat aplikohet urdhëri penal, mungesës së vullnetit nga ana e palës së të pandehurit, si dhe vështirësitë në kryerjen e hetimeve të shpejta në rastin e gjykimit të drejtëpërdrejtë.
- Në lidhje me forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut në vazhdimësi janë udhëzuar dhe orientuar prokurorët në aplikimin e dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore, etj.
- Nga ana tjetër, prokurorëve u është kërkuar që të ashpërsojnë masat e sigurimit dhe masat e dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/ shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve. Gjithashtu, është synuar në rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ashpërsimi i politikës penale për autorët e veprës penale të dhunës në familje.
- Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore janë udhëzuar në ndjekjen me përparësi të kallëzimeve penale dhe procedimeve penale që kanë të bëjnë me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, duke kryer hetime të plota, të paanshme, të shpejta, me profesionalizëm dhe me efektivitet, në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe SPAK-un.
- Në lidhje me forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional është synuar në vazhdimësi për konsolidimin e bashkëpunimit nëpërmjet nxitjes për shkëmbim të të dhënave, kryerjes së analizave të përbashkëta për rastet e referuara, sipas oficerëve të shërbimeve që kanë bërë referimet përkatëse, shkëmbimit dhe kërkimit të ekspertizës, krijimin e procedurave standarde hetimore me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm të grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe veprimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e pastrimit të parave, pastrimit të të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe terrorizmit.

- Në vijimësi është punuar dhe po punohet që gjatë kryerjes së veprimeve të përbashkëta hetimore të përfshihen oficerët e shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre, në respektim të parimit për të caktuar si OPGJ oficerin e strukturës referuese sipas institucioneve ligjzbatuese.
- Po punohet në zhvillimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerë të policive gjyqësore në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave, veçanërisht në rastet e hetimeve financiare, evazionit fiskal dhe krimin kibernetik.

❖ **Në lidhje me masat procedurale të marra për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare dhe në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.2/2022:**

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë marrë masa dhe janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave dhe në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm me nr.2/2023. Në vijimësi janë marrë masat e duhura procedurale për zbatimin në praktikë të këtyre Rekomandimeve dhe detyrimeve të Udhëzimit të Përgjithshëm, në të gjitha drejtimet e orientuara nga aktet e mësipërme, si më poshtë.

- Gjatë këtij viti, janë filluar kryesisht 15 (pesëmbëdhjetë) procedime penale (në raport me 10 procedime në vitin 2022, me një rritje prej 5 procedimesh apo me rritje 50%), por janë edhe disa procedime të tjera të filluara kryesisht mbi bazën e njoftimeve të përcipta apo indirekte dhe jo mbi bazën e kallëzimeve penale konkrete. Në këtë drejtim megjithëse ka një trend rritës, vlerësojmë se duhet të vijojnë akoma më shumë puna dhe nxitja e prokurorëve në drejtim të shtimit të numrit të procedimeve penale të filluara kryesisht. Në këtë drejtim, duhet pranuar se ngarkesa e madhe me dosje në verifikim, hetim dhe gjykim deri në vitin 2023 ka ndikuar drejtëpërdrejtë dhe frenuar prokurorët në fillimin kryesisht të procedimeve penale.
- Gjatë vitit 2023, janë rregjistruar 2 (dy) procedime penale për nenin 244 të K.Penal, me 1 (një) person nën hetim. Nga këto procedime, për një procedim penal janë përfunduar hetimet dhe është dërguar për gjykim me 1 person të marrë të pandehur, ndërsa për një procedim penal vijojnë hetimet.
- Në lidhje me nenin 259 të K.Penal, rezulton se janë hetuar 11 (njëmbëdhjetë) procedime penale, ku janë mbartur 7 (shtatë) procedime penale me 3 persona nën hetim dhe janë rregjistruar edhe 4 (katër) procedime penale të reja me 2 persona nën hetim, nga të cilët 6 (gjashtë) procedime penale me 4 persona nën hetim janë pushuar për mungesë prova apo mungesë fakti dhe 1 (një) procedim penal është pezulluar, ndërsa vijojnë të jenë në hetim 4 (katër) procedime penale.
- Në vijimësi janë udhëzuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, që në lidhje me këto grup veprash penale të synohet në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së hetimeve (realizimin e hetimeve proaktive), kryerjen e hetimeve të shpejta, si dhe përdorimin e metodave speciale të hetimit, rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe agjencitë ligjzbatuese në realizimin e hetimeve sa më të plota, si dhe në ashpërsimin e qëndrimeve dhe të politikës penale si në caktimin e masave të sigurimit ashtu edhe në masën e dënimeve.
- Duhet vënë në dukje se ka një rritje të çështjeve të përfunduara në këtë grup veprash në raport me një vit më parë (viti 2022), kjo edhe për faktin që gjatë kësaj periudhe kohe seksioni i posaçëm ka funksionuar me tre prokuror duke rritur punën dhe përfundimin e dosjeve në këtë grup veprash penale.

- Duhet theksuar se prioritetet në luftën kundër krimit të organizuar, nga ana e Prokurorisë gjatë vitit 2023 kanë qenë një sërë detyrash dhe objektivash të realizuara pjesërisht gjatë vitit 2022. Si dhe shtimi i procedimeve penale të hetuara me metodat speciale të hetimit, rritjen e procedimeve të filluara kryesisht, si dhe hetimet proaktive, etj.
- Gjithashtu, është synuar në rritjen e cilësisë së hetimeve të këtyre grupveprave nëpërmjet rritjes të numrit të procedimeve penale/të pandehurve të dërguar për gjykim, si dhe numrit të pandehurve të dënuar me vendim të formës së prerë, veçanërisht për veprat penale të trafikeve të kundraligjshme, ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, prodhimi dhe shitja e narkotikëve, trafikimi i narkotikëve, kultivimin e bimëve narkotike, etj.
- Është synuar në vijimësi në shtimin e numrit të hetimeve proaktive në tërësinë e tyre, zgjerimin e hetimeve në drejtim të numrit të personave të marrë të pandehur, si dhe në drejtim të llojit dhe numrit të veprave penale që do të hetohen brenda një procedimi penal në lidhje me veprat penale të cituara sa më sipër;
- Gjithashtu është synuar në rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me organet dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare në rastet e pastrimit të produkteve të vepres penale që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale, duke rritur jo vetëm sasinë e referimeve për këtë veper penale, por në rradhë të parë përmirësimin e cilësisë së referimeve në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 287 të K.Penal si dhe në hetimet pasurore;
- Janë orientuar prokurorët në kryerjen e hetimeve të plota dhe të gjithëanëshme dhe cilësore në drejtim të rritjes së numrit të çështjeve të dërguara për gjykim, dhe si rrjedhojë rritjen e numrit të personave të marrë të pandehur dhe rritjen e personave të dënuar në lidhje me këto vepra penale.
 - Gjatë vitit 2023, në lidhje me veprën penale „Rrëmbimi apo mbajtja peng e personit“ e parashikuar nga neni 109/1 i K.Penal, është rregjistruar 1 (një) procedim penal që aktualisht ndodhet akoma në hetim.
 - Në lidhje me veprën penale „Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë“ të parashikuar nga neni 109/b të K.Penal, rezulton se janë mbartur në hetim 3 (tre) procedime penale dhe janë rregjistruar 3 (tre) procedime penale të reja. Nga këto procedime 4 (katër) procedime penale janë pushuar për mungesë fakti apo shkaqe të tjera. Ndërsa 2 (dy) procedime penale janë pezulluar për mos identifikimin e autorëve të vepres penale.
 - Në lidhje me veprën penale „Heqja e paligjshme e lirisë“ të parashikuar nga neni 110 të K.Penal, rezulton se janë hetuar 2 procedime penale nga Prokuroria Pukë, një procedim penal i mbartur dhe 1 procedim i rregjistruar i ri, ku të 2 (dy) këto procedime penale janë pezulluar për mos identifikimin e autorëve të vepres penale.
 - Nga ana tjetër, rezulton se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur çështje të filluara apo të mbartura në lidhje me veprat penale të „Trafikimit të qënieve njerëzore të rritur apo të miturve“.
 - Gjatë vitit 2023 në lidhje me veprën penale “Trafikim i mjeteve motorrike” të parashikuar nga neni 141/a i K.Penal, rezulton se janë hetuar 31 (tridhjetë e një) procedime penale, ku 9 procedime penale janë të mbartura, 11 procedime janë rregjistruar gjatë këtij viti dhe 6 procedime penale janë rifilluar gjatë vitit pas

pezullimit të mëparshëm kryesisht për ekzekutim letërporosie dhe 5 procedime penale janë të ardhura me transferim.

- Nga këto procedime penale për 4 procedime penale me 5 persona të marrë të pandehur janë dërguar për gjykim. Ndërsa 11 procedime penale janë dërguar me kërkesë për pushim, për mungesë fakti apo prove apo shkaqe të tjera. Ndërsa 12 procedime penale është vendosur pezullimi, për mungesë të identifikimit të autorit apo për dërgim letërporosishë. Ndërsa 4 (katër) procedime penale të tjera janë dërguar për kompetencë në Prokuroritë e tjera. Aktualisht nuk ka asnjë procedim penal në hetim.
- Gjatë këtij viti, një vëmendje dhe kujdes i veçantë i është kushtuar edhe veprave penale në fushën e narkotikëve (nenet 283, 283/a, 284, etj), rezulton se gjatë këtij viti, janë hetuar 371 procedime penale. Nga këto, 9 procedime penale janë të Prokurorisë Pukë, nga të cilat të gjitha procedimet penale, pra 8 procedime penale janë të mbartura dhe nuk ka procedime penale të rregjistruara gjatë këtij viti. Nga 363 procedimet penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në lidhje me këto vepra penale rezulton se janë mbartur në hetim 97 procedime penale dhe janë rregjistruar 266 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) procedime penale të reja.
- Për veprën penale «Prodhimi dhe shitja e narkotikëve», të parashikuar nga neni 283 të K.Penal, janë hetuar gjithësej 113 (njëqind e trembëdhjetë) procedime penale. Ku 27 procedime penal janë procedime penale të mbartura nga vitet e mëparshme dhe 84 procedime penale janë të rregjistruara në këtë vit. Nga këto, janë edhe 2 procedime penale të Prokurorisë Pukë, të cilat janë procedime penale të mbartura dhe 1 procedim penal me 3 persona të marrë të pandehur me masë arresti në burg janë dërguar për gjykim, ndërsa 1 procedim penal është pezulluar për shkak të mosidentifikimit të autorit. Nga procedimet penale të hetuara, rezulton se janë përfunduar 73 procedime penale ndërsa 38 procedime penale janë akoma në hetim. Në lidhje me mënyrën e përfundimit rezulton se 27 procedime penale me 53 persona të pandehur ku 30 prej tyre me masë arrest në burg janë dërguar për gjykim. Ndërsa 38 procedime penale janë pushuar për mungesë fakti apo shkaqe të tjera, ndërsa 8 procedime penale janë pezulluar për shkak të mosidentifikimit të autorit.
- Për veprën penale «Trafikimi i narkotikëve», të parashikuar nga neni 283/a të K.Penal, janë hetuar gjithësej 15 (pesëmbëdhjetë) procedime penale dhe për 1 material referues është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Nga këto procedime, 13 procedime penale janë përfunduar ndërsa vijojnë në hetim edhe 2 procedime penale. Nga procedimet penale të përfunduara rezulton se 3 procedime penale me 3 të pandehur, është dërguar për gjykim, ndërsa 4 procedime penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim, 5 procedime penale janë pezulluar për mosidentifikimin e autorit të vepres penale, ndërsa 1 (një) procedim penal është dërguar për kompetencë në një prokurori të tjetër.
- Për veprën penale «Kultivimi i narkotikëve», të parashikuar nga neni 284 të K.Penal, janë hetuar 242 (dyqind e dyzet e dy) procedime penale, ku 66 procedime penale janë të mbartura nga një vit më parë dhe 170 janë procedime penale të reja, ndërsa 6 procedime penale janë të Prokurorisë Pukë, ku 1 procedim penal me 3 persona të pandehur është dërguar për gjykim dhe 5 procedime penale janë pezulluar. Nga këto procedime penale, janë përfunduar 184 procedime penale dhe janë në hetim 52 procedime penale. Rezulton se 17 (shtatëmbëdhjetë)

procedime penale, me 23 persona të pandehur ku 10 janë me masë sigurimi arrest në burg, janë dërguar për gjykim. 5 (pesë) procedime penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e çështjes. Ndërsa për 161 procedime penale është marrë vendim për pezullimin e hetimeve për mosnjohje të autorit të veprës penale, 1 (një) procedim penal është transferuar në prokurorinë kompetente.

- Për tu vënë në dukje është fakti se kërkesat për pushim të procedimit penal kryesisht lidhen me rastet e kapjes së personave përdorues të lëndëve narkotike me sasi të vogla lëndësh narkotike të sekuestruara, ku nga hetimet ka rezultuar se qëllimi i subjektit nën hetim ka qenë për përdorim vetjak dhe jo për shpërndarje a shitje (konfirmuar edhe me aktet toksikologjiko ligjore e prova të tjera) etj.

❖ Masat e tjera procedurale dhe administrative :

- Në kuadër të zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr.10/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore ...”, i ndryshuar dhe urdhërave dhe udhëzimeve në vijim rezulton se edhe gjatë këtij viti ka vijuar konsolidimi dhe përmirësimi i rezultateve të Seksionit të Posaçëm kundër pastrimit të parave, krimeve financiare. Është caktuar Drejtuesi i këtij seksioni dhe njëkohësisht pikë kontakti me Sektorin e Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme. Janë organizuar trajnime dhe takime periodike nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Organizatat Ndërkombtare në kuadër të veprave të përmendura më lart, si për prokurorët ashtu edhe për oficerët e policisë gjyqësore të këtij seksioni.
- Në lidhje me udhëzimet dhe orientimet për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje dhe për të miturit, janë organizuar mbledhje dhe konsultime me prokurorët dhe oficerët e seksionit të krimeve kundër të miturve dhe dhunës në familje.... Në lidhje me këto grup veprash penale është bërë një punë deri diku e kënaqshme në drejtim të sensibilizimit por, edhe hetimit të këtyre veprave penale, kjo edhe në bashkëpunim me institucionet vendore dhe organizatat dhe shoqatat që operojnë në këto fusha.
- Në vijimësi janë orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe psikologët dhe koordinatorja e viktimave në dhënien e asistimit dhe ndihmës ligjore dhe psikologjike gjatë kontakteve, pyetjeve dhe në intervistimet e tyre. Në këtë drejtim vlerësojmë se duhet të rritet më tej bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me të gjithë aktorët dhe faktorët si dhe me shoqatat e mbrojtjes së viktimave të veprave penale apo Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj, si dhe trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve, oficerëve dhe koordinatorës së viktimave.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se janë hetuar 12 procedime penale në lidhje me veprën penale «Përndjekja», të parashikuar nga neni 121/a të K.Penal, ku 3 procedime penale janë të mbartuara, një procedim penal është rifilluar gjatë këtij viti i pezulluar më parë dhe 8 procedime penale janë rregjistruar të reja gjatë këtij viti. Nga këto procedime penale, 3 procedime penale me 3 të pandehur janë dërguar për gjykim, 6 procedime penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim, 1 procedim është pezulluar dhe vijojnë të jenë në hetim 2 procedime penale.
- Në lidhje me veprat penale të braktisjes së të miturit apo keqtrajtimit të të miturit nenet 124 dhe 124/b të K.Penal, rezulton se janë hetuar 8 procedime penale, ku 6

procedime penale janë të mbartura dhe 2 procedime penale janë të rregjistruara këtë vit. Në lidhje me këto procedime penale, rezulton se 3 (tre) procedime penale me 3 persona të marrë të pandehur janë dërguar për gjykim, 1 (një) procedim penal është dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim, vijojnë 4 procedime penale të jenë në hetim.

- Në lidhje me veprat penale të dhunës në familje të parashikuar nga neni 130/a të K.Penal, rezulton se janë hetuar 91 procedime penale (20 më shumë se një vit më parë), ku 1 procedim penal i përket Prokurorisë Pukë i rregjistruar gjatë këtij viti dhe i dërguar për gjykim me 1 person të marrë të pandehur. Ndërsa 20 procedime penale janë të mbartura nga viti 2022 dhe 70 (shtatëdhjetë) procedime penale janë rregjistruar këtë vit. Në lidhje me këto çështje, rezulton se 46 (dyzet e gjashtë) procedime penale me 46 persona të marrë të pandehur nga të cilët 23 të arrestuar janë dërguar për gjykim, 17 (shtatëmbëdhjetë) procedime penale janë pushuar për mungesë fakti apo shkaqe të tjera, ndërsa 1 procedim penal është transferuar në prokurori tjetër dhe vijojnë të jenë në hetim edhe 26 (njëzet e gjashtë) procedime të tjera penale.
- Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe një kujdes i veçantë është treguar në rastet e procedimeve penale me viktimat të dhunës në familje të mitur dhe viktimave femra, në drejtim të sigurimit të kushteve dhe gjendjes sa më të përshtatshme për të dhënë deklaratime dhe paraqitur prova, si dhe shmangien e kontakteve të drejtëpërdrejta me shkelësit, më përjashtim të rasteve kur ballafaqimi ka qenë i domosdoshëm. Kryerja e intervistave dhe pyetjeve nga oficerë femra, si dhe në praninë e psikologeve dhe mbrojtësve ligjor femra në të gjitha rastet kur kjo ka qenë e mundur.
- Gjatë këtij viti, është arritur që pjesa dërmuese e rasteve të veprave penale të dhunës në familje, me bazë gjinore apo diskriminuese të hetohen nga prokurorët dhe oficerët e trajnuar të seksionit ndaj dhunës në familje dhe të miturve. Në rastet e veprave penale me të mitur kjo ka qenë për të gjitha procedimet. Vështirësi është hasur për shkak të numrit të vogël të prokurorëve, problemeve të gadishmërisë dhe në këto raste, çështja është hetuar me grup hetimor ku së paku një nga prokurorët ka qenë pjesë e seksionit të dhunës në familje dhe të miturve. Aktualisht kjo ka ardhur drejt përmirësimit me plotësimin e seksionit me prokurorë ku pjesa dërmuese e çështjeve me të mitur janë hetuar nga prokurorët e seksionit për të mitur, por lëvizjet e prokurorëve (transferimet, komandimet apo pezullimet, etj) kanë ndikuar në rishortimin e dosjeve dhe në pamundësinë e ruajtjes plotësisht të ndarjes sipas seksioneve.
- Në të gjitha këto procedime, është synuar hetimi në një kohë sa më të shkurtër, kjo edhe në varësi të bashkëpunimit të institucioneve të tjera në paraqitjen dhe marrjen e provave, kjo duke synuar në sigurimin në të gjitha rastet të të drejtave dhe garancive procedurale për viktimat e dhunës në familje, me bazë gjinore apo e viktimave të mitur. Edhe për sa i përket masave dhe llojit të dënimit në këto raste, janë udhëzuar prokurorët dhe është synuar në mbajtjen e dënimeve në mbi mesataren e marzheve të dënimit por duke pasur parasysh edhe rrethanat personale apo lehtësuese e rënduese të autorëve të vepres penale apo raportet me viktimat e veprave penale.
- Gjatë këtij viti ka pasur 116 referime për vepra penale ku janë përfshirë persona të mitur si të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimat të vepres penale. Për 7 raste është vendosur raportimi i tyre dhe për 18 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal, në 69 raste është vendosur rregjistrimi i procedimit penal me të mitur autorë si të mitur në konflikt me ligjin. Ku vetëm në një rast i mituri në konflikt

me ligjin është fëmër ndërsa të gjithë të miturit e tjerë 51 janë meshkuj dhe ndahen sipas grupmoshave 12 të mitur në grupmoshat 14-16 dhe 36 të mitur në grupmoshën 16-18 vjeç. Në 2 raste janë caktuar masat e sigurimit arrest në burg dhe në 3 raste janë caktuar masat e sigurimit arrest në shtëpi dhe detyrim. Në 34 raste është marrë vendim për pushimin e procedimit, ku në një rast është marrë masa e shmangies me paralajmërim me gojë, në 27 raste është marrë masa e shmangies dhe paralajmërimi me shkrim, ndërsa në 6 raste është marrë vendim pushimi për shkaqe të tjera. Ndërsa 12 çështje me 12 të mitur në konflikt me ligjin janë dërguar për gjykim dhe për 5 raste gjykimi ka kaluar seancën paraprake. Në 4 raste është kërkuar dënime alternative dhe vetëm 1 një rast dënim me burgim për shkak të rrethanave të vecantë të vepres penale dhe të të miturit. Ndërsa vijojnë hetimet për rastet e tjera.

- Rezulton se nga këto procedime penale, 27 procedime penale kanë qenë me vitima të vepres penale të mitur, me rreth 30 viktima, nga të cilat 15 viktima femra dhe 15 viktima meshkuj, ku një rast me plagosje të lehtë dhe 3 raste me vdekje.
- Në të gjitha këto procedime, është synuar hetimi në një kohë sa më të shkurtër, kjo edhe në varësi të bashkëpunimit të institucioneve të tjera në paraqitjen dhe marrjen e provave, kjo duke synuar në sigurimin në të gjitha rastet të të drejtave dhe garancive procedurale për viktimat e dhunës në familje, me bazë gjinore apo e viktimave të mitur.
- Edhe për sa i përket masave dhe llojit të dënimit në këto raste, janë udhëzuar prokurorët dhe është synuar në mbajtjen e dënimeve në mbi mesataren e marzheve të dënimit por duke pasur parasysh edhe rrethanat personale apo lehtësuese e rënduese të autorëve të vepres penale apo raportet me viktimat e veprave penale.
- Në 12 çështje me 12 të mitur në konflikt me ligjin janë dërguar për gjykim. Ndërsa vijojnë hetimet për rastet e tjera.
- Rezulton se nga këto procedime penale, 27 procedime penale kanë qenë me viktima të vepres penale të mitur, rreth 30 viktima, nga të cilat 15 viktima femra dhe 15 viktima meshkuj.
- Gjatë vitit 2023 nuk janë rregjistruar procedime penale të reja në lidhje me veprat penale në fushën e terrorizmit.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se nuk ka pasur referime dhe procedime penale të rregjistruara mbi bazën e referimeve apo kallëzimeve penale të ILDKPKI.
- Gjatë vitit 2023 e në vijim, është synuar dhe mbajtur një bashkëpunim të ngushtë dhe efektiv me të gjitha shërbimet e Policisë Gjyqësore në Prokurori, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër dhe Komisaritet, në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, si dhe Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat, me policinë gjyqësore të Doganave dhe të Sektorit Verior të Hetimit Tatimor, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, etj. Ku si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë kryer hetime në vijimësi duke përdorur edhe metodat speciale të hetimit.
- Në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, rezulton se gjatë vitit 2023, janë dërguar dhe ekzekutuar një numër i konsiderueshem i vendimeve penale. Kështu janë nxjerrë urdhëra ekzekutimi për 671 vendime penale. Nga këto rezulton se gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë 59 urdhëra për vendime penale me burgim, janë nxjerrë 52 urdhëra për vendime penale me gjobë, si dhe janë nxjerrë edhe 20 urdhëra për vendime penale me dënime plotësuese.

- Janë nxjerrë 483 urdhëra ekzekutimi për dënime penale të formës së prerë për dënime alternative në aplikim të nenit 59 të K.Penal. Janë nxjerrë 15 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale me dënime alternative ku është aplikuar neni 59/a të K.Penal. Janë nxjerrë 139 urdhëra për dënime alternative ku është aplikuar neni 63 i K.Penal. Gjithashtu, janë nxjerrë 34 urdhëra në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me aplikim të dënime alternative ku është aplikuar neni 64 i K.Penal.
- Në lidhje me këto urdhëra rezulton se gjatë kësaj periudhe janë vënë në ekzekutim dhe janë ekzekutuar 59 urdhëra për vendime penale me burgim, 52 urdhëra për vendime penale me gjobë, 21 urdhëra për vendime penale me dënime plotësuese edhe për urdhëra të mbartura. Janë ekzekutuar 483 urdhëra ekzekutimi për dënime në aplikim të nenit 59 të K.Penal, 15 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale me dënime alternative ku është aplikuar neni 59/a të K.Penal. Janë ekzekutuar 139 urdhëra për dënime alternative ku është aplikuar neni 63 i K.Penal dhe 34 urdhëra në lidhje me dënime alternative ku është aplikuar neni 64 i K.Penal. Rezulton se janë pa ekzekutuar dy vendime penal me dënim me burgim dhe vendime penale me dënim me gjobë.
- Gjithashtu, rezulton se gjatë vitit 2023, janë dërguar dhe ekzekutuar një numër i konsiderueshem i letërporosive. Kështu janë dërguar në gjykatë 8 (tetë) kërkesa për ekstradime personash nga jashtë shteti, ku për këto rastë janë përfunduar apo janë drejt përfundimit procedurat e ekstradimit nga gjykata.
- Janë administruar 26 (njëzet e gjashtë) kërkesa për ekzekutim të letërporosive nga jashtë shteti, nga të cilat janë ekzekutuar apo në proces ekzekutimi të 26 (njëzet e gjashtë) kërkesat dhe nuk ka pasur refuzime të asnjë kërkesë.
- Janë dërguar 59 (pesëdhjetë e nëntë) kërkesa për ekzekutim të letërporosive për jashtë shteti, nga të cilat më shumë se gjysma e tyre janë ekzekutuar, ndërsa akoma nuk ka vendime për pranimin dhe ekzekutimin e pjesës tjetër të kërkesave.
- Janë 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa për njohje të vendimit penal të huaj, në proces ekzekutimi.
- Gjithashtu, po kryhen procedura të tjera ekzekutimi nga zyra e ekzekutimeve, në lidhje me dënimet, me provat materiale, në lidhje me shpenzimet gjyqësore, etj.
- Në mbledhjet, takimet dhe analizat e zhvilluara me shërbimet e ndryshme të policisë gjyqësore dhe me drejtuesit e këtyre policive është kërkuar dhe nxitur përmirësimi i punës me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve, krijimin e grupeve hetimore efektive në rastin e hetimeve të veprave të rënda penale, komplekse apo me numër të madh veprimesh.
- Vijon të sjellë problematika dhe vështirësi në punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, numri i reduktuar i prokurorëve efektiv, por i përmirësuar në raport me vitin 2022. Edhe zbatimi i hartës së re gjyqësore ka sjellë vështirësi gjatë fazës së bashkimit dhe unifikimit të prokurorisë, fakte këto që kanë ndikuar në ngarkesën si dhe performancën e prokurorisë dhe të prokurorëve, në të gjitha drejtimet e punës në këtë Prokurori.
- Plotësimi i organikës dhe strukturës së prokurorisë kryesisht me prokurorë, si dhe shtimi dhe trajnimi i tyre dhe i policisë gjyqësore dhe administratës, sidomos me psikologë, asistues të viktimave dhe ekspertë të fushave të ndryshme do të sillte një përmirësim të ndjeshëm të punës dhe cilësisë së akteve dhe hetimeve penale në të ardhmen.

- Gjatë vitit 2023, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë ndjekur seminare dhe trajnime në lidhje me aplikimet e bëra më parë prej tyre në Shkollën e Magjistraturës, në Prokurorinë e Përgjithshme apo institucione të tjera. Edhe gjatë kësaj periudhe kanë vijuar pjesëmarrjen në trajnimet për prokurorët dhe oficerët sipas profileve të punës së tyre në seksionet ku bëjnë pjesë apo në seminare të vlerësuara sipas nevojës së tyre dhe aplikimeve të bëra në Shkollën e Magjistraturës, trajnimeve të organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë apo nga shoqata dhe organizata vendase apo të huaja.
- Konstatohet se shtimi i trajnimeve në fushën e dispozitave të reja penale dhe procedurale, të dispozitave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, në lidhje me hetimin e veprave penale «Pastrimit të produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale» dhe «Korrupsionit» apo «Shpërdorimit të detyrës», apo në fusha të tjera të ngjashme, do të sillte një përmirësim të dukshëm në cilësinë, shpejtësinë e hetimeve dhe shmangien e rasteve të bërjes së akteve të pavlefshme, të papërdorshme apo jo në cilësinë e duhur si dhe në përmirësimin e mënyrës së hetimit të veprave të ndryshme penale, e në vecanti të atyre objekt i Rekomandimeve Prioritare.
- Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë sugjeruar prokurorët dhe oficerët që të plotësojnë rregullisht formularët e trajnimeve vazhduese duke zgjedhur tema në lidhje me këto grup veprash në mënyrë që të marrin trajnime dhe njohuri me metodat dhe praktikat e reja më të mira të hetimit të tyre.
- Gjatë kësaj periudhe janë hasur në problematika në lidhje me vonesat në hetimet e veprave penale në përgjithësi, si dhe atyre që kanë të bëjnë me rekomandimet prioritare në veçanti, por duhet theksuar se ka një përmirësim në lidhje me përfundimin e çështjeve, me uljen e ngarkesës së prokurorëve dhe oficerëve në raport me një vit më parë, fakt që ka ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe numrit të çështjeve të përfunduara gjatë kësaj periudhe 1 vjeçare në raport me të njëjtën periudhë një vit më parë dhe akoma më shumë në raportin me para dy vitesh.
- Nga ana tjetër, janë shkaktuar vonesa dhe zvarritje për shkak të vonesave të shkaktuara nga ekspertët e Instituti të Policisë Shkencore Tiranë apo edhe Instituti të Mjekësisë Ligjore Tiranë, në lidhje zgjatjen e kohës së përfundimit të ekspertimeve të ndryshme. Apo në vështirësitë e krijuara në kryerjen e ekspertimeve financiare dhe kontabël, për shkak të numrit të vogël të ekspertëve dhe kërkesave të larta financiare për pagesat e tyre, etj.
- Vështirësi janë hasur edhe në drejtim të gjetjes dhe pagimit të përkthyesve të gjuhëve të ndryshme të huaja, sidomos të atyre të gjuhëve të rralla të pjesës aziatike apo afrikane apo për mungesë licensash të tyre, të psikologëve në raste dhe procedime të veçanta apo në orë të vona të natës, etj.
- Gjithashtu, konstatohet vështirësi në administrimin e bazës materiale për prokurorët, oficerët dhe punën e prokurorisë në vijimësi fakt që kërkon një procedurë me të thekshtë në pajisjen e tyre me materiale të ndryshme në respektim të kryerjes së një punë cilësore, të shpejtë dhe eficientë në kuadër të kërkesave të publikut dhe angazhimeve të opinionit kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Një kujdes i veçantë nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i është kushtuar ruajtjes së sekretit të hetimor dhe në lidhje me ndalimin e publikimit të akteve në lidhje me procedimet penale, për krime të rënda, me veprime proaktive, në fushën e korrupsionit etj, pjesa e madhe e tyre objekt i Rekomandimeve Prioritare. Në rastet e konstatimit të cënimit të këtij parimi dhe sigurie janë marrë masa të duhura

procedurale dhe administrative dhe janë tërhequr vëmendja prokurorit, oficeret apo subjekteve të tjera.

- Një kujdes i veçantë është treguar nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me respektimin në mënyrë efektive të të drejtave të pandehurve, personave nën hetim apo të dyshuarve, ashtu dhe të viktimave, të miturve në konflikt me ligjin apo viktimat, në vecanti për veprat penale prioritare të rekomanduara, gjatë gjithë fazave të hetimit dhe gjykimit të çështjeve ashtu edhe në fazën e ekzekutimit.
- Në projekt buxhetin afat mesem kemi kërkuar shtesë fondesh në lidhje me kryerjen e pagesave të ndryshme për ekspertë, përkthyes, psikologë, avokatë, etj. Gjithashtu, kërkohet shtimi i fondeve për krijimin e një baze materiale dhe kompjuterike, si kompjuter, printera, fotokopje dhe materiale të tjera ndihmëse me qëllim shmangien e vështirësive në faza të ndryshme të vitit apo në raport me procedime penale të ndryshme që kërkojnë angazhim jo vetëm personal apo edhe financiar dhe material për përfundimin në kohë të tyre.
- Nga ana tjetër vlerësohet e domodoshme edhe trajnimi i punonjësve të administratës lidhur me proceset e punës si, protokollit, sekretit hetimor, zyra e rregjistrimit dhe sistemet e reja, arshiva, prokurimi publik, etj.
- Mbikqyerja dhe zbatimi në vijimësi i detyrave të përcaktuara në Rekomadimet Prioritare të Këshillit të Ministrave dhe në urdhërat e udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm është një detyrë e përhershme dhe sistematike në punën e Drejtuesit dhe për punën e vetë prokurorëve dhe të prokurorisë në tërësi dhe plan që do të vijojë të gjejë zbatim gjatë gjithë vitit edhe më tej deri në daljen dhe paraqitjen e Rekomandimeve të reja në vijim.

❖ **Masat e marra për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të produkteve të veprave penale dhe krimit financiar...**

- Gjatë vitit 2023, ka vijuar puna për plotësimin dhe konsolidimin e “Seksionit të Posaçëm”, i përbërë nga 3 prokurorë dhe 4 oficerë të policisë gjyqësore. Të cilët kanë hetuar pjesën dërmuese të veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe financiar, pastrimit të produkteve të vepres penale ose vepritarisë financiare, etj, duke përjashtuar procedimet e vjetra penale të ndara me shortet e mëparshme dhe procedimet penale të marra si rrjedhojë e gadishmërisë.
- Prokurorët janë udhëzuar për forcimin e efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal, por edhe nëpunësve publik të administratës tatimore dhe asaj doganore, nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat përkatëse tatimore dhe doganore, apo agjensi të tjera ligjzbatuese.
- Janë marrë masa dhe janë dhënë orientime prokurorëve me qëllim forcimin e kapaciteteve të seksionit të posaçëm kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në kompetencë të këtij seksioni.
- Gjatë vitit 2023, janë hetuar rreth 60 (gjashtëdhjetë) procedime penale në lidhje me vepren penale të «Pastrimit të produkteve të vepres penale ose vepritarisë kriminale», parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (nga këto 1 procedim penal është i Prokurorisë Pukë, i mbartur nga viti 2022 dhe për të është marrë vendim për moskompetencë duke e dërguar në prokurorinë kompetente). Nga këto procedime janë 47 procedime penale të mbartura dhe 11 (njëmbëdhjetë) procedime penale të

reja të rregjistruara gjatë këtij viti. Nga këto procedime, 4 procedime penale me 10 persona të pandehur janë dërguar për gjykim, në lidhje me procedime dhe vepra të tjera penale. Ndërsa, për 28 (njëzet e tetë) procedime penale është paraqitur në gjykatë kërkesë për pushimin e çështjes pasi nuk provohet kryerja e vepres penale, mungesë provash, mungesë fakti, etj. Ndërsa 3 procedime penale janë transferuar në Prokuroritë kompetente. Për 7 procedime penale është marrë vendim për pezullimin e hetimeve kryesisht për shkak të nisjes së letërporosive. Për procedimet penale të tjera 21, po vijojnë hetimet. Duhet theksuar se ka një ulje të referimeve penale në lidhje me këtë veper penale në raport me vitet e kaluara, por këtë vit ka procedime penale të dërguara për gjykim, ku në dy raste janë marrë edhe vendime fajësie dhe dënime për të pandehurit, si dhe 6 kërkesa për sekuestrin e pasurive me burim të paligjshëm dhe 2 raste të konfiskimit të pasurive të sekuestruara.

- Megjithë takimet, analizat dhe udhëzimet e dhëna konstatojmë se vazhdon cilësia jo e kënaqëshme e referimeve në lidhje me këtë veper penale. Kjo ka bërë që edhe numri i veprimeve hetimore dhe akteve të kërkuara të jetë i madh dhe të ketë zgjatje në kohë deri në marrjen e një vendimi përfundimtar. Për këto arsye, është hasur në vështirësive në evidentimin e saktë të pasurive me burim të paligjshëm të subjekteve të referuara apo subjekteve të lidhur dhe me provueshmërisë e krijimit të saj në rrugë kriminale dhe për mundësinë e ngritjes së një akuze të bazuar.
- Nga këto janë mbi 5 raste të vendosjes së sekuestros preventive mbi pasuri të paluajtshme me dyshime se burojnë nga veprimtari kriminale kërkesa këto të miratuara nga gjykata dhe të vëna në ekzekutim.
- Në këtë drejtim hetimit dhe evidentimit të të dhënave të mësipërme është nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë Urdhëri me nr.16, datë 09.06.2023 «Për evidentimin dhe saktësimin e procedimeve penale financiare dhe pasurore dhe saktësimin e sistemit presto», me qëllim evidentimin dhe rakordimin periodikisht të hetimeve dhe procedimeve penale financiare për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/b të K.Penal, plotësimin në kohë reale dhe mbajtjen e saktë të sistemit Presto dhe rakordimin me Pikën e Kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme. Ku janë orientuar prokurorët që në përfundim të hetimeve dhe paraqitjes së kërkesës për gjykim apo për pushim sipas rastit, apo vendimarrje tjetër, të dërgojnë menjëherë një kopje të vendimit apo kërkesës zyrës së rregjistrimit dhe pikës së kontaktit, me qëllim hedhjen e të dhënave në sistemin PRESTO.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se janë hetuar 60 (gjashtëdhjetë) referime pasurore, në lidhje me procedime të tjera penale, procedime paralele ose jo. Këto procedime pasurore për 9 raste është marrë vendim mosfillimi, ndërsa për 16 raste është marrë vendim pushimi të hetimit pasuror. Këto procedime pasurore konstatojmë që janë në rënie gjatë këtij viti dhe kanë problematika të ngjashme me procedimet penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal. Gjatë këtij viti thuhet nuk ka pasur referime të reja pasurore, pasi për 9 raste është marrë vendim mosfillimi duke analizuar cilësinë shumë të dobët të referimeve. Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështje të referimeve pasurore me vendim pushimi pasi nuk është evidentuar pasuri konkrete me prejardhje kriminale. Gjithashtu, ka pasur 3 (tre) raste të vendosjes së sekuestros konservative në lidhje me disa prona me prejardhje të dyshuar me burime të paligjshme.
- Nga procedimet penale të rregjistruara dhe hetuara gjatë vitit 2023, rezulton se mbi 40 (dyzet) procedime penale të mbartura dhe të rregjistruara të reja, janë hetuar me metodat speciale të hetimit, duke zhvilluar hetime proaktive (përgjime ambjentale

dhe telefonike, vëzhgime, blerje e simuluar, e metoda të tjera speciale, etj), kryesisht në lidhje me vepra të rënda penale kundër jetës dhe shëndetit, në lidhje me narkotikët (prodhim, shitje, trafikim, kultivim), në lidhje me shpërdorimin e detyrës, korrupsionit, si dhe në lidhje me trafikimin e personave apo shfrytëzimin e prostitucionit, etj.

- Në lidhje me këtë grup veprash, janë udhëzuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së hetimeve (realizimin e hetimeve proaktive), kryerjen e hetimeve të shpejta, si dhe përdorimin e metodave speciale të hetimit, bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe agjencitë ligjzbatuese në realizimin e hetimeve sa më të plota, si dhe në ashpërsimin e qëndrimeve dhe të politikës penale si në caktimin e masave të sigurimit ashtu edhe në masën e dënimeve.
- Gjithashtu, vlerësohet me shumë efikasitet edhe vijimi i tranimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Pasi, në vijimësi u është sugjeruar prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që të plotësojnë formularët e trajnimeve vazhduese duke zgjedhur tema në lidhje me këto grup veprash në mënyrë që të marrin trajnime dhe njohuri e duhura me metodat dhe praktikën e reja më të mira të hetimit të këtyre grup veprave penale.
- Në mbledhjet, takimet dhe analizat e zhvilluara me shërbimet e ndryshme të policisë gjyqësore dhe me drejtuesit e këtyre policive është kërkuar dhe nxitur përmirësimi i punës me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve, krijimin e grupeve hetimore efektive në rastin e hetimeve të veprave të rënda penale, komplekse apo me numër të madh veprimesh.
- Në respektim të detyrimeve ligjore por edhe për plotësimin e mangësive apo përmirësimin e metodave të hetimit edhe gjatë këtij viti prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë marrë pjesë në një numër të madh të seminareve dhe trajnimeve në lidhje me aplikimet e bëra më parë prej tyre. Prokurorët dhe oficerët kanë ndjekur trajnimet dhe seminarët e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, trajnimeve të organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë apo nga shoqata dhe organizata vendase dhe të huaja. Kjo ka sjellë plotësimin jo vetëm të detyrimeve ligjore për secilin prej tyre por edhe marrjen e njohurive të duhura dhe metodave të reja dhe zbatimin e tyre në praktikë në çështje të caktuara të hetuara prej tyre.

❖ **Masat administrative të marra për hedhjen në sistemin elektronik e-tracking PRESTO.**

- Në këtë drejtim edhe gjatë vitit 2023, janë zhvilluar takime, konsultime dhe janë dhënë udhëzime për prokurorët e Seksionit të Posaçëm, si dhe me oficerët e policisë gjyqësore dhe zyrën e regjistrimit në drejtim të përmirësimit të sistemit, trajnimit të prokurorëve dhe oficerëve dhe sekretarëve të regjistrimit si dhe mbajtjen e sistemit dhe përditësimin e të dhënave të kohë reale. Si dhe dërgimin e tyre në Sektorin e Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme.
- Duhet pranuar se është hasur vështirësi në vënien në zbatim dhe përditësimin e të dhënave, kjo për shkak të ngarkesës së madhe të prokurorëve me detyrat kryesore kushtetuese dhe ligjore dhe kohën që duhet për të hedhur të dhënat dhe përvetësimin e këtij sistemi të ri elektronik.
- Por pamvarësisht problematikave dhe vështirësive të dala në vijimësi janë orientuar dhe nxitur prokurorët dhe oficerët dhe stafi ndihmës në gjetjen e hapësirës së duhur

kohore në evidentimin dhe hedhjen e të dhënave në sistem dhe dërgimin e tyre në kohë reale dhe në përfitimin e statistikave sa më të sakta dhe të plota të çështjeve të pastrimit të parave në respektim të përmbushjes së planit të veprimit ICRG/FATF në kuadrin e integritetit evropian të vendit.

- Në këtë drejtim rezulton se gjatë vitit 2023, që nga vënia në funksion e sistemit PRESTO, nga ana e Seksionit të Posaçëm në lidhje me vepren penale « Pastrimi i produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale » të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal.
- Nga Drejtuesi i Prokurorisë është nxjerrë Urdhëri me nr.16, datë 09.06.2023 «Për evidentimin dhe saktësimin e procedimeve penale financiare dhe pasurore dhe saktësimin e sistemit presto», me qëllim evidentimin dhe rakordimin periodikisht të hetimeve dhe procedimeve penale financiare për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/b të K.Penal, plotësimin në kohë reale dhe mbajtjen e saktë të sistemit Presto dhe rakordimin me Pikën e Kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme. Ku janë orientuar prokurorët që në përfundim të hetimeve dhe paraqitjes së kërkesës për gjykim apo për pushim sipas rastit, apo vendimarrje tjetër, të dërgojnë menjëherë një kopje të vendimit apo kërkesës zyrës së rregjistrimit dhe pikës së kontaktit, me qëllim hedhjen e të dhënave në sistemin PRESTO.
- Në vijimësi dhe në mënyrë periodike 3, 6, 9 mujore dhe vjetore janë siguruar dhe janë nxjerrë të dhënat statistikore dhe analitike, qoftë manuale dhe elektronike duke realizuar plotësimin në kohë me të dhënave dhe rregjistrave elektronik dhe manual për shortimet, verifikimet dhe procedimet penale të filluara dhe hetuara në vijimësi. Gjithashtu është raportuar në mënyrë periodike në Sektorin e Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

❖ Të dhëna në lidhje me masat efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje dhe me bazë gjinore dhe veprat penale me të mitur.

- Edhe gjatë këtij viti janë zbatuar në vijimësi parashikimet e Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr.17/2020 « Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje», edhe gjatë kësaj periudhe ka vijuar zbatimi dhe mbikqyerja e zbatimit sa më të drejtë në praktikë të tij nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Në veçanti janë organizuar mbledhje dhe konsultime me prokurorët dhe oficerët e seksionit të krimeve kundër të miturve dhe dhunës në familje... Në lidhje me këto grup veprash penale është bërë një punë e kënaqshme në drejtim të sensibilizimit por edhe hetimit të këtyre veprave penale, kjo edhe në bashkëpunim me institucionet vendore dhe organizatat dhe shoqatat që operojnë në këto fusha.
- Në vijimësi janë orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe psikologët dhe koordinatorja e viktimave në dhënien e asistimit dhe ndihmës ligjore dhe psikologjike gjatë kontakteve, pyetjeve dhe në intervistimet e tyre. Në këtë drejtim vlerësojmë se duhet të bëhet një punë më e madhe dhe një bashkëpunim më i ngushtë me shoqatat e mbrojtjes së viktimave të veprave penale apo Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj, si dhe trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve, oficerëve dhe koordinatorës së viktimave.
- Nga të dhënat e administruara, gjatë vitit 2023, rezulton se janë hetuar 12 procedime penale në lidhje me vepren penale «Përndjekja», të parashikuar nga neni 121/a të

K.Penal, ku 3 procedime penale janë të mbartuara, një procedim penal është rifilluar gjatë këtij viti i pezulluar më parë dhe 8 procedime penale janë rregjistruar të reja gjatë këtij viti. Nga këto procedime penale, 3 procedime penale me 3 të pandehur janë dërguar për gjykim, 6 procedime penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim, 1 procedim është pezulluar dhe vijojnë të jenë në hetim 2 procedime penale.

- Në lidhje me veprat penale të braktisjes së të miturit apo keqtrajtimit të të miturit nën 124 dhe 124/b të K.Penal, rezulton se janë hetuar 8 procedime penale, ku 6 procedime penale janë të mbartura dhe 2 procedime penale janë të rregjistruara këtë vit. Në lidhje me këto procedime penale, rezulton se 3 (tre) procedime penale me 3 persona të marrë të pandehur janë dërguar për gjykim, 1 (një) procedim penal është dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim, vijojnë 4 procedime penale të jenë në hetim.
- Në lidhje me veprat penale të dhunës në familje të parashikuar nga neni 130/a të K.Penal, rezulton se janë hetuar 91 procedime penale (20 më shumë se një vit më parë), ku 1 procedim penal i përket Prokurorisë Pukë i rregjistruar gjatë këtij viti dhe i dërguar për gjykim me 1 person të marrë të pandehur. Ndërsa 20 procedime penale janë të mbartura nga viti 2022 dhe 70 (shtatëdhjetë) procedime penale janë rregjistruar këtë vit. Në lidhje me këto çështje, rezulton se 46 (dyzet e gjashtë) procedime penale me 46 persona të marrë të pandehur nga të cilët 23 të arrestuar janë dërguar për gjykim, 17 (shtatëmbëdhjetë) procedime penale janë pushuar për mungesë fakti apo shkaqe të tjera, ndërsa 1 procedim penal është transferuar në prokurori tjetër dhe vijojnë të jenë në hetim edhe 26 (njëzet e gjashtë) procedime të tjera penale.
- Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe një kujdes i veçantë është treguar në rastet e procedimeve penale me viktime të dhunës në familje të mitur dhe viktimave femra, në drejtim të sigurimit të kushteve dhe gjendjes sa më të përshtatshme për të dhënë deklaratime dhe paraqitur prova, si dhe shmangien e kontakteve të drejtëpërdrejta me shkelësit, më përjashtim të rasteve kur ballafaqimi ka qenë i domosdoshëm. Kryerja e intervistave dhe pyetjeve nga oficerë femra, si dhe në praninë e psikologeve dhe mbrojtësve ligjor femra në të gjitha rastet kur kjo ka qenë e mundur.
- Është arritur që pjesa dërmuese e rasteve të veprave penale të dhunës në familje, me bazë gjinore apo diskriminuese të hetohen nga prokurorët dhe oficerët e trajnuar të seksionit ndaj dhunës në familje dhe të miturve. Në rastet e veprave penale me të mitur kjo ka qenë për të gjitha procedimet. Vështirësi është hasur për shkak të numrit të vogël të prokurorëve, problemeve të gadishmërisë dhe në këto raste, çështja është hetuar me grup hetimor ku së paku një nga prokurorët ka qenë pjesë e seksionit të dhunës në familje dhe të miturve.
- Në të gjitha këto procedime, është synuar hetimi në një kohë sa më të shkurtër, kjo edhe në varësi të bashkëpunimit të institucioneve të tjera në paraqitjen dhe marrjen e provave, kjo duke synuar në sigurimin në të gjitha rastet të të drejtave dhe garancive procedurale për viktimat e dhunës në familje, me bazë gjinore apo e viktimave të mitur. Edhe për sa i përket masave dhe llojit të dënimit në këto raste, janë udhëzuar prokurorët dhe është synuar në mbajtjen e dënimeve në mbi mesataren e marzheve të dënimit por duke pasur parasysh edhe rrethanat personale apo lehtësuese e rënduese të autorëve të vepres penale apo raportet me viktimat e veprave penale.
- Gjatë kësaj periudhe ka pasur 116 referime për vepra penale ku janë përfshirë persona të mitur si të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktime të vepres penale. Për 7

raste është vendosur raportimi i tyre dhe për 18 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal, në 69 raste është vendosur rregjistrimi i procedimit penal me të mitur autorë si të mitur në konflikt me ligjin. Ku vetëm në një rast i mituri në konflikt me ligjin është femër ndërsa të gjithë të miturit e tjerë 51 janë meshkuj dhe ndahen sipas grupmoshave 12 të mitur në grupmoshat 14-16 dhe 36 të mitur në grupmoshën 16-18 vjeç. Në 2 raste janë caktuar masat e sigurimit arrest në burg dhe në 3 raste janë caktuar masat e sigurimit arrest në shtëpi dhe detyrim. Në 34 raste është marrë vendim për pushimin e procedimit, ku në një rast është marrë masa e shmangies me paralajmërim me gojë, në 27 raste është marrë masa e shmangies dhe paralajmërimi me shkrim, ndërsa në 6 raste është marrë vendim pushimi për shkaqe të tjera. Ndërsa 12 çështje me 12 të mitur në konflikt me ligjin janë dërguar për gjykim dhe për 5 raste gjykimi ka kaluar seancën paraprake. Në 4 raste është kërkuar dënime alternative dhe vetëm 1 një rast dënim me burgim për shkak të rrethanave të vecantë të vepres penale dhe të të miturit. Ndërsa vijojnë hetimet për rastet e tjera.

- Rezulton se nga këto procedime penale, 27 procedime penale kanë qenë me vitima të vepres penale të mitur, me rreth 30 viktimat, nga të cilat 15 viktimat femra dhe 15 viktimat meshkuj, ku një rast me plagosje të lehtë dhe 3 raste me vdekje.
- Në të gjitha këto procedime, është synuar hetimi në një kohë sa më të shkurtër, kjo edhe në varësi të bashkëpunimit të institucioneve të tjera në paraqitjen dhe marrjen e provave, kjo duke synuar në sigurimin në të gjitha rastet të të drejtave dhe garancive procedurale për viktimat e dhunës në familje, me bazë gjinore apo e viktimave të mitur.
- Edhe për sa i përket masave dhe llojit të dënimit në këto raste, janë udhëzuar prokurorët dhe është synuar në mbajtjen e dënimeve në mbi mesataren e marzheve të dënimit por duke pasur parasysh edhe rrethanat personale apo lehtësuese e rënduese të autorëve të vepres penale apo raportet me viktimat e veprave penale.
- Ndërsa, në 47 raste është vendosur rregjistrimi i procedimit penal me të mitur autorë si të mitur në konflikt me ligjin. Ku nga 32 persona nën hetim, 31 janë të mitur meshkuj dhe vetëm 1 është e mitur femër në konflikt me ligjin. Nga këto rezulton se të miturit në konflikt me ligjin ndahen në grupmoshat 14-16 rreth 11 të mitur dhe në grupmoshën 16-18 vjeç janë 20 të mitur.
- Në këto çështje në 1 rast është caktuar masa e sigurimit arrest në burg, për vepra të rënda penale (neni 139-25) dhe faktit që i mituri është përsëritës, ndërsa në 3 raste janë caktuar masat e sigurimit arrest në shtëpi dhe në pak raste detyrim paraqitje. Në 12 raste është marrë masa e shmangies nga ndjekja penale për të miturit në konflikt me ligjin dhe pushimi i çështjes. Ndërsa 10 çështje me 10 të mitur në konflikt është marrë masa e vërejtjes me shkrim dhe në 2 raste masë tjetër shmangieje.
- Në 10 çështje me 10 të mitur në konflikt me ligjin janë dërguar për gjykim. Ndërsa vijojnë hetimet për rastet e tjera.
- Rezulton se nga këto procedime penale, 20 procedime penale kanë qenë me viktimat të vepres penale të mitur, rreth 22 viktimat, nga të cilat 10 viktimat femra dhe 12 viktimat meshkuj.
- Në lidhje me procedimet penale me viktimat të vepres penale të mitur rezulton se ka pasur një sërë procedimesh. Për tu theksuar është fakti që referimet e këtyre grupveprave janë relativisht të dobëta dhe nga ana tjetër haset në vështirësi në gjetjen dhe sigurimin e provave që provojnë vepren penale dhe fajësinë e autorëve, kjo edhe për shkak të mungesës së bashkëpunimit të plotë të viktimave të këtyre veprave

penale, qoftë viktimave gra të përndjekjes apo dhunës në familje apo dhunës seksuale por edhe viktimave të mitur në lidhje me braktisjen e të miturve, keqtrajtimit apo dhunës seksuale etj, kjo edhe për shkak të raportit të afërt i dyshuar-viktimë (në shumë raste janë anëtar të së njëjtës familje) që ndikon edhe në kryerjen e hetimeve të plota dhe të shpejta dhe cilësore nga ana procedurale dhe me synimin dhënien e dënimeve sa më të përshtatshme me këto raste dhe vepra penale.

❖ **Masat e marra për rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të Luftës Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit.**

- Në respektim dhe zbatim të kërkesave të «Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional» ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me nr.8126, miratuar me datë 05.12.2020, janë marrë masa në vijimësi për rritjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe rritjen e komunikimeve përsa i përket shkëmbimeve të informacioneve për procedimet reciproke me interes të përbashkët apo edhe të njëanshëm.
- Gjatë vitit 2023, janë trajtuar rreth 22 (njëzet e dy) materiale kallëzuese ose hetimore të ardhura për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), ku gjatë vitit 2022 kanë 13 materiale të ardhura nga SPAK, me një rritje prej 9 materialesh apo rreth 70 %.
- Në lidhje me këto materiale të ardhura për kompetencë është bërë regjistrimi i tyre si kallzime penale dhe hedhja në shortin elektronik sipas seksioneve që u përkasin dhe në 9 (nëntë) raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal pasi në kallëzimet e ardhura nuk ka pasur elemente të vepres penale të kallëzuara. Në 13 (trembëdhjetë) raste është regjistruar procedim penal dhe kanë vijuar hetimet.
- Nga procedimet penale të hetuara, rezulton se për 1 (një) rast pas hetimeve të kryera është marrë vendim për shpalljen e moskompetencës dhe dërgimin e materialit për kompetencë në një prokurori tjetër, për 1 (një) rast tjetër pas hetimeve të kryera është paraqitur kërkesë për pushimin e procedimit pasi nuk janë gjetur të dhëna për ngritjen e ndonjë akuze. Vijnë të jenë në hetim 11 (njëmbëdhjetë) procedime penale të tjera, për të cilat rezulton se duhet të kryhen edhe veprime të tjera hetimore.
- Gjithashtu, rezulton se 3 (tre) procedime penale pas hetimeve të kryera është marrë vendim moskompetence dhe janë dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme.
- Vlerësojmë se bashkëpunimi me Prokurorinë e Posaçme ka ardhur në rritje, si në zbatim të «Aktit të koordinimit ndërinstitucional» ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me nr.8126, miratuar me datë 05.12.2020, por gjithashtu për shkak të procedimeve penale të lidhura si dhe faktit të hetimit të çështjeve për vepra penale në kompetencë të të dy prokurorive.

❖ **Masat e marra dhe rezultatet e treguesit në zbatimin e urdhërit penal, marrëveshjet e pranimit të fajësisë dhe gjykimin të drejtëpërdrejtë dhe dënimet alternative:**

- Puna dhe detyrat e prokurorëve gjatë vitit 2023 është orientuar dhe nxitur në kryerjen në përputhje të plotë dhe në respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të të

gjitha palëve të procesit penal. Kjo duke pasur parasysh të parimet themelore të legjislacionit penal dhe ato proceduralo penale. Janë nxitur dhe udhëzuar në kryerjen e hetimeve të shpejta, të plota dhe të gjithëanëshme, duke pasur parasysh edhe vështirësitë e krijuara nga mungesat në strukturën e prokurorisë, vonesat në marrjen e përgjigjeve nga institucione të ndryshme dhe mungesat e ekspertëve të fushave të ndryshme, kërkesat dhe pretendimet e ndryshme të palëve në proces, etj, të cilat kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në ngarkesën e prokurorisë dhe e secilit prej prokurorëve, si në numrin e dosjeve të hetuara, ashtu edhe në numrin e dosjeve të mbartura dhe në cilësinë e hetimeve të dosjeve të përfunduara.

- Gjatë vitit 2023, rezulton se janë dërguar në gjykatë 5 (pesë) procedime penale me 5 të pandehur me kërkesë për miratimin e urdhërit penal, kundrejt 4 kërkesave në vitin 2022. Nga këto kërkesa të 5 kërkesat janë miratuar nga gjykata. Këto kërkesa janë për veprat penale të parashikuara nga nenet 179/a, 278/3 dhe 280 të K.Penal.
- Vlen për tu theksuar se në vitin 2023, ka një situatë të njëjtë me një vit më parë, me një rast më shumë të aplikimit të urdhërit penal (viti 2022 ka 4 aplikime). Në këtë drejtim ka ndikuar një sërë faktorësh, mungesa e të pandehurve në një sërë procedimesh për vepra për të cilat aplikohet ky institut, siç është rasti i vepres penale të parashikuar nga neni 297 i K.Penal, ku ka pasur disa raste në vitet 2020 dhe 2021, ndërsa nuk ka asnjë rast në vitin 2023, kjo për shkak të mungesës apo mos shfaqjes së dëshirës apo pranimit nga të pandehurit të këtij instituti dhe rrethana të tjera objektive dhe subjektive. Për këtë arsye, vlerësohet se duhet të vijojë nxitja e prokurorëve në aplikimin e këtij instituti në vijim pasi, vlerësojmë që ky gjykim i posaçëm duhet të gjejë aplikim më të gjërë në vijimësi.
- Gjatë vitit 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka përfunduar hetimet dhe janë dërguar në gjykatë rreth 44 (dyzet e katër) procedime penale me 48 të pandehur me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë së të pandehurit dhe caktimin e dënimit (gjatë vitit 2022 kanë qenë 73 marrëveshje), pra ka një ulje të dukshme më të madhe sa gjysma e një viti më parë prej rreth 29 procedime penale më pak ose një rënie prej 39 %. Kryesisht këto marrëveshje janë aplikuar në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 170/a/2, 179/a, 180/a/2, 186, 199/a, 248, 250, 279, 288, 288/a, 291, 295/a, 301, 305, 324/a të K.Penal, etj. Në pjesën dërmuese të tyre këto marrëveshje janë pranuar nga gjykata, në 28 raste janë miratuar, në 2 raste është refuzuar marrëveshja dhe është kthyer për hetime, ndërsa 14 (katërmbëdhjetë) çështje vijnë në gjykim. Procedimet penale të dërguara me marrëveshje në gjykatë bëjnë fjalë për vepra penale me rrezikshmëri të ulët dhe për të cilat gjykata ka krijuar kryesisht një lloj praktike të dënimit të tyre me aplikimin e dënimeve alternative të parashikuara nga nenet 59, 59/a deri 63 e vijues të Kodit Penal.
- Konstatohet se prej 2 vitesh vijon trendi i uljes së zbatimit edhe të këtij gjykimi të posaçëm. një ulje të ndjeshme të aplikimit të këtij instituti të ri, në raport me një vit më parë. Një nga faktorët kryesorë janë ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2021, në lidhje me seancën paraprake dhe gjykimin e shkurtuar. Gjithashtu, faktor tjetër është mungesa e konsensusit apo pëlqimit nga i pandehuri, apo edhe mungesa e arritjes së një marrëveshje me të pandehurin dhe mbrojtësin e tij nga prokurori në pikat e saj, etj, të cilat kanë bërë që të aplikohet procedura standarte e dërgimit në gjyq. Ndryshe nga vitet e mëparshme kur ky gjykim është aplikuar më shumë në rastet e veprave penale të parashikuara nga nenet 137, 145, 199/a të K.Penal, gjatë këtij viti ka ndikuar numri më i ulët i këtyre veprave por edhe fakti që

nga ana e të pandehurve dhe mbrojtësve nuk është kërkuar apo pranuar të gjykohen me këtë procedurë.

- Nga ana tjetër rezulton se vetëm 3 (tre) procedime penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykimin e drejtëpërdrejtë të çështjes po aq sa një vit më parë (*viti 2022 janë 3 kërkesë për gjykim të drejtëpërdrejtë*). Për këto kërkesa, gjykata ka vendosur pranimin e tyre duke proceduar me gjykim të drejtëpërdrejtë pamvarësisht qëndrimit të mbajtur për vlerësimin e arresteve dhe caktimin e masave të sigurimit. Në lidhje me këtë institut rezulton se ka një situatë të njëjtë si një vit më parë, por vijon të mos gjejë aplikimin e duhur ky gjykim i posaçëm. Ky institut është aplikuar në rastet e veprave penale të parashikuara nga neni 291 i Kodit Penal. Mosaplikimi i këtij instituti lidhet me disa faktorë, ku në rradhë të parë është ngarkesa e prokuroreve me çështje të tjera në hetim dhe gjykim, vështirësitë në kryerjen e veprimeve të shpejta hetimore dhe përfundimin e hetimeve dhe ndikimi i vogël që ka ky institut ka në raport me institutet e reja, si gjykimi me marrëveshje apo gjykimi me procedurën e gjyqimit të shkurtuar sidomos me ndryshimet e reja, fakt që nxit të pandehurit dhe mbrojtësit në një qëndrim dhe ndikim negativ ndaj aplikimit të këtij instituti. Në këtë drejtim vlerësoj se duhet të bëhet një punë akoma më e madhe dhe nxitje më e fortë e prokurorëve në aplikimin më të madh të këtij lloji gjykimi në vijim të vitit 2024.
- Në lidhje me hetimin dhe gjykimin e personave të mitur është synuar gjithmonë në drejtim të respektimit të të drejtave dhe garancive procedurale të të miturve. Gjithashtu, është synuar në ndërgjegjësimin e policisë gjyqësore në respektimin e këtyre të drejtave dhe garancive që në fazën e hetimeve të para e në vijim, si dhe gjatë gjyqimit të këtyre veprave penale. Është hasur në vështirësi në asistimin e të miturve nga psikologë, në rastet e veprimeve hetimore në orët e vona të natës apo në rastet e procedimeve penale të ardhura nga komisarariatet e tjera apo në lidhje me të mitur me vendbanime të largëta. Në vijimësi është synuar në marrjen e vendimeve sa më lehtësuese dhe të përshtatshme me moshën e tyre, duke marrë vendime shmangie nga ndjekja penale apo aplikimin e dënimeve alternative në masë.
- Nga ana tjetër rezulton se gjatë vitit 2023 janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e çështjes 551 procedime (viti 2022 janë 856 kërkesa pushimi), për të cilat gjykata ka vendosur pranimin e tyre në lidhje me 262 çështje. Ndërsa në 20 raste ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe kthimin e çështjes për hetime. Vijon gjykimi për çështjet e tjera. Mospranimi i kërkesës dhe kthimi i çështjes për kryerjen e hetimeve shtesë lidhet më shumë në rastet e veprave penale të parashikuara nga nenet 99 (në dy raste), 199/a (në dy raste), 287 (në 6 raste), 290 të K.Penal, etj.
- Nga ana e Prokurorisë Pukë rezulton se gjatë vitit 2023 janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e çështjes 15 procedime, për të cilat gjykata ka vendosur pranimin e tyre në lidhje me 14 çështje. Ndërsa në 1 rast ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe kthimin e çështjes për hetime.
- Nga ana tjetër rezulton se gjatë vitit 2023 janë dërguar në gjykatë me kërkesë për dërgimin në gjyq 801 procedime me 956 të pandehur, për të cilat gjykata ka vendosur pranimin e tyre në lidhje me 559 çështje. Ndërsa në mbi 5 raste ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe pushimin e çështjes ose të akuzës dhe në mbi 4 raste ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme. Vijon gjykimi për çështjet e tjera. Në lidhje me rastet e pushimit është vlerësuar nga prokurori i çështjes nëse ka vend për ankim pas administrimit të vendimit të arsyetuar. Gjithashtu, edhe në rastet e kthimit të çështjes për hetimi është rakorduar dhe komunikuar me prokurorin e çështjes që me administrimin e vendimit të arsyetuar të

evidentojë faktet nëse ka vend për ushtrimin e ankimit apo jo, si dhe me vijimin e kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata.

- Nga procedimet penale të dërguara për gjykim, në 853 (tetëqind e pesëdhjetë e tre) çështje (nga këto 837 raste të Prokurorisë Shkodër dhe 16 raste të Prokurorisë Pukë), është kërkuar aplikimi i dënimit me gjobë për 54 raste dhe të pandehur. Nuk ka asnjë rast që të jetë kërkuar dënimi me kohën e paraburgimit. Është aplikuar dënimi në minimum 28 raste, ndërsa në 167 raste është kërkuar dënim mesatar, ndërsa në 5 raste në maksimumin e dispozitës.
- Nga procedimet penale të dërguara për gjykim nga Prokuroria Pukë, në 45 (dyzet e pesë) çështje me 63 të pandehur, janë gjykuar 16 çështje. Nuk ka asnjë rast që të jetë kërkuar dënimi me gjobë apo me kohën e paraburgimit. Është aplikuar dënimi në minimum 4 raste, ndërsa në 5 raste është kërkuar dënim mesatar, ndërsa në 1 rast në maksimumin e dispozitës. Ndërsa 6 raste janë aplikuar dënimet alternative.
- Në rastet e tjera 642 çështje të tjera (637 çështje të Prokurorisë Shkodër dhe 6 raste të Prokurorisë Pukë), janë aplikuar dënimet alternative të parashikuara nga nenet 53, 59, 59/a, 63, etj, të K.Penal, kjo pa përfshirë gjykimin me marrëveshje apo me urdhër penal, si dhe duke pasur parasysh natyrën e vepres penale, rrezikshmërinë e pakët të vepres penale dhe rrezikshmërinë e pakët të autorit, personalitetin e tij dhe rrethanat lehtësuese. Aplikimi i dënimeve alternative është kërkuar në rastet e veprave penale me rrezikshmëri të vogël si ato të parashikuara nga nenet 84, 89, 121/a, 124/b, 130/a/1, 134/1, 137, 145, 151, 159, 172, 178, 180, 180/a, 181, 186, 188, 189, 197, 199/a, 205, 235, 236, 237, 242, 273, 274, 277, 279, 280, 282, 283/1, 284, 288/a, 290, 291, 297, 298, 305, 305/b, 317, 324/a, 328, etj, të Kodit Penal.
- Përsa i përket veprave penale që prekin zgjedhjet e lira, rezulton se për vitin 2023 janë hetuar 6 (gjashtë) procedime penale me 14 persona nën hetim, ku 2 procedime penale janë të mbartura, 3 procedime të rregjistruara të reja dhe 1 procedim i ardhur me transferim, këto për nenet 327/a, 328, 328/a dhe 330/a të K.Penal. Nga këto procedime penale 1 (një) procedim penal me 10 të pandehur është dërguar për gjykim. Ndërsa 1 (një) procedim penal për nenin 330/a të K.Penal është pezulluar. 1 (një) penal me 4 persona nën hetim është dërguar për kompetencë në prokurorinë kompetente për nenin 328/a të K.Penal. Vijnë të jenë në hetim 3 (tre) procedime penale.
- Në lidhje me këto procedime penale janë orientuar prokurorët në drejtim të kryerjes së hetimeve të shpejta dhe përfundimin e tyre, ku janë përfunduar tre procedime dhe janë drejt përfundimit tre procedimet e tjera. Në këtë drejtim vlerësojmë se është bërë një punë relativisht e mirë nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të caktuar me këto procedime për kryerjen e veprimeve të shpejta hetimore dhe efektive dhe hetimet e plota të faktit penal dhe të fajësisë së shkelësve dhe autorëve të këtyre veprave penale.

❖ **Masat e marra në drejtim të zbatimit të Udhëzime të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.**

Nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm janë nxjerrë një kuadër i gjërë ligjor me urdhëra dhe udhëzime të përgjithshme me qëllim normimin më të mirë dhe plotësimin apo rregullimin e veprimtarisë së prokurorisë si gjatë vitit 2023 ashtu edhe në vitet e mëparshme. Ndër

udhëzimet e dala gjatë vitit 2023, apo që kanë vijuar zbatimin gjatë këtij viti janë si më poshtë :

- *Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.103, datë 25.07.2023, "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023";*
- *Udhëzimi i Përgjithshëm Nr.02, datë 12.05.2023 "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm".*
- *Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.70, datë 12.05.2023, "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023";*
- *Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr. 10, datë 17.07.2020 "Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore nëprokuroritë me juridiksion të përgjithshëm".*
- *Kërkesa dhe udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm me nr.887/I prot, datë 29.06.2022, për rritjen e efektivitetit të hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale të pastrimit të parave dhe procedimeve pasurore;*
- *Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr. 03, datë 06.09.2022, "Për ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.10/2020 „Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore nëprokuroritë me juridiksion të përgjithshëm".*
- *Udhëzimit të Përgjithshëm nr.08, datë 15.11.2021, "Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar";*
- *Udhëzimit të Përgjithshëm nr.08/2020, datë 19.05.2020, "Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" i ndryshuar me Udhëzimin e Përgjithshëm me nr.06, datë 23.07.2021 "Për disa shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08/2020, datë 19.05.2020, "Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" të Prokurorit të Përgjithshëm;*
- *Udhëzimit nr. 03 datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori" të Prokurorit të Përgjithshëm.*
- *Udhëzimin nr. 55 prot datë 10.09.2018 "Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".*
- *Udhëzimit i Përgjithshëm Nr.12, datë 20.07.2020, «Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm» i Prokurorit të Përgjithshëm.*
- *Udhëzimi i Përgjithshëm nr.33, datë 04.09.2020 «Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve, në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër» i Drejtuesit të Prokurorisë.*

- Udhëzimit të Përgjithshëm me nr.03, datë 26.10.2018 „Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar „Sekret Shtetëror“, të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr.07 datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës”.
- Urdhëri Nr.120, datë 08.09.2020 “Për miratimin e disa shtesave në “Rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me urdhërin nr.32, datë 31.01.2017.
- Urdhëri Nr.124, datë 24.09.2020 “Për caktimin e formës së rregjistrit dhe mënyrën e mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore të çështjeve me të mitur, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”.
- Urdhërit Nr.87, datë 28.07.2021, të Prokurorit të Përgjithshëm për “Miratimin e rregullave për përdorimin e sistemit të Integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit”;
- Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr.14 datë 21.09.2020 “Për ushtrimin e të drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve.
- Udhëzimin nr. 55 prot datë 10.09.2018 “Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr. 4 datë 18.10.2022 "Për disa shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr 10, datë 30.12.2021 "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”;
- Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr. 03, datë 06.09.2022, “Për ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.10/2020 „Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore nëprokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.
- Shkresa e Prokurorit të Përgjithshëm me nr.1737, datë 15.11.2023, “Mbi rritjen e efikasitetit në bashkërendimin me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”;
- Udhëzimit të Përgjithshëm nr.08, datë 15.11.2021, “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar”;
- Urdhëri/ shkresa e Prokurorit të Përgjithshëm me nr.1737 prot, datë 15.11.2023 „Mbi rritjen e efikasitetit mbi bashkërendimin me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”
- Gjatë vitit 2023 ashtu si në vitet e mëparshme në vjimësi është mbajtur rregullisht regjistri i posaçëm në lidhje me korrespondencën dhe komunikimet mes drejtuesit dhe prokurorëve, si dhe në lidhje me kërkesat për informacion dhe kthim përgjigje, ashtu edhe në lidhje me udhëzimet e posaçme dhe akte të tjera udhëzuese e orientuese.
- Gjatë vitit 2023, ka pasur një numër të ulët udhëzimesh të posaçme për procedime dhe çështje të caktuar, kryesisht në lidhje me kërkesat e prokurorëve të veçantë por edhe raste të udhëzimeve të nxjerra nga drejtuesi mbi bazën e kërkesave për informacion apo verifikimeve të kryera rast pas rasti.

- Masa konkrete janë marrë edhe në drejtim të nxitjes së prokurorëve për rritjen e shpejtësisë dhe cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe hetimeve në lidhje me të gjitha procedimet penale, por në veçanti me procedimet penale për çështjet e trajtuara si prioritare. Në fazën e hetimeve u është kërkuar prokurorëve dhe oficerëve të koordinojnë veprimet mes tyre dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të kryerjes në kohë dhe me cilësi të veprimeve hetimore dhe në administrimin e akteve dhe provave për këto çështje.
- Në fazën e gjykimit janë orientuar dhe nxitur prokurorët në aplikimin e instituteve të reja dhe gjykimeve të posacme, me qëllim zbatimin e tyre në një numër më të madh procedimesh penale dhe çështjesh.
- Janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime për oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me kontrollin e veprimeve hetimore të kryera në vijimësi, si dhe për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të veprimeve hetimore të kryera prej tyre, në lidhje me raportimet periodike për veprimet e kryera, si dhe për rritjen e cilësisë së relacioneve të çështjeve të përfunduara dhe respektimit të afateve të përfundimit të tyre.
- Për shkak të lëvizjes së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit, (edhe si rezultat i zbatimit të Hartës së re Gjyqësore), janë nxjerrë disa urdhëra për ndryshimin e urdhërit të ndarjes së prokurorëve dhe oficerëve në seksione. Ku nga njëra anë është synuar plotësimi i seksioneve me prokurorë dhe oficer për aq sa ka qenë e mundur dhe nga ana tjetër duhet thënë se ka krijuar vështirësi në përshtatjen e tyre me hetimin e grupveprave të secilit seksion dhe në shpejtësinë dhe cilësinë e hetimit të çështjeve penale në tërësi.
- Në pjesën më të madhe të rasteve të administrimit të urdhëra apo udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e drejtuesit janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime në zbatim të tyre dhe në raste me të pakta nuk janë nxjerrë akte por janë marrë masat e duhura për shpërndarjen e këtyre akteve tek prokurorët dhe tek oficerët e policisë gjyqësore, si dhe tek administrata sipas rastit dhe janë marrë në drejtim të njohjes dhe zbatimit të plotë të tyre dhe janë diskutuar pika të vecanta të këtyre akteve me qëllim kuptimin e saktë të tyre dhe ruajtjen e një standarti në zbatimin e tyre. Gjithashtu në vazhdimësi janë dhënë orientime për zbatimin e këtyre akteve dhe është ndjekur dhe mbikqyrur mënyra e zbatimit të tyre në praktikë dhe në raste konkrete.
- Në lidhje me udhëzimin e përgjithshëm me Nr.07 datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës”, janë marrë masa për njohjen dhe zbatimin e tij dhe gjithashtu janë dhënë orientime për mënyrën e shfrytëzimit të zyrës së ekspertëve dhe marrjen e mendimit të tyre në çdo çështje komplekse, me ndjeshmëri të lartë apo në rastet e kryerjes së ri-ekspertimeve. Në disa raste gjatë vitit është kërkuar ndihma e kësaj zyre dhe janë marrë mendimin me vlerë për ekspertimet e kërkuara dhe për mënyrën e hetimit të çështjes konkrete.
- Edhe në lidhje me urdhërin Nr.124, datë 24.09.2020 “Për caktimin e formës së rregjistrimit dhe mënyrën e mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore të çështjeve me të mitur, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”, janë marrë masa për njohjen dhe zbatimin e tij. Janë organizuar mbledhje dhe diskutime në lidhje me rregullat e mbajtjes dhe plotësimin të rregjistrave në tërësi dhe ato që kanë lidhje me të miturit në veçanti. Është bërë mbikqyerja periodike e zbatimit të urdhërit, si dhe e mënyrës dhe rregullshmërisë së raportimit të statistikave.

- Në lidhje me Udhëzimi i Përgjithshëm me Nr.14 datë 21.09.2020 “Për ushtrimin e të drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve, është bërë i njohur dhe është vënë në zbatim në këtë prokurori. Vlerësojmë se ky udhëzim ndihmon dhe lehtëson punën e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqore dhe ndikon në shpejtimin e administrimit të informacionit. Është udhëzuar dhe synuar në aplikimin dhe zbatimin masiv të tij. Por duhet pranuar se përdorimin i të dhënave dhe databazave të të tretëve nuk ka gjetur një aplikim masiv dhe janë hasur vështirësi të ndryshme në aksesimin e këtyre programeve për shumë arsye. Për këtë fakt, vlerësojmë se trajnimi i prokurorëve dhe oficerëve me përdorimin e tyre, si dhe përmirësimi i sistemeve dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet përkatëse do të sillte një përdorim me efikas të tyre.
- Në lidhje me Urdhërin me Nr.87 datë 28.07.2021 “Për miratimin e rregullave për përdorimin e sistemit të integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit“, të Prokurorit të Përgjithshëm“, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë urdhëri me nr.32, datë 09.09.2021 „Mbi sistemin e integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit“, ku në vijim këto urdhëra janë shpërndarë për njohje dhe zbatim për prokurorët, oficerët dhe stafin ndihmës. Në bashkëpunim me Drejtuesen e Seksionit janë marë masa për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij urdhëri për të siguruar një informacion në kohë reale dhe periodik në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktime të vepres penale. Gjithashtu, në bashkëpunim me zyrën e regjistrimit dhe zyrën e kordinatorës është mbajtur regjistri i posaçëm elektronik dhe është siguruar hedhja në kohë e të dhënave dhe nxitja e prokurorëve dhe oficerëve në kryerjen e hetimeve të shpejta dhe të plota, si dhe respektimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të mitur.
- Në lidhje me Udhëzimin e Përgjithshëm nr.08/2020, datë 19.05.2020, “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” i ndryshuar me Udhëzimin e Përgjithshëm me nr.06, datë 23.07.2021 “Për disa shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08/2020, datë 19.05.2020, “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” të Prokurorit të Përgjithshëm, me qëllim evidentimin sa më të saktë të të gjitha shpenzimeve procedurale penale dhe kryerjen e pagesave të këtyre shpenzimeve në kohë, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë urdhëri “Për evidentimin, dokumentimin dhe pagimin e tarifave dhe shpenzimeve procedurale penale në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër”. Në vijim janë marrë masa për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij urdhëri për të siguruar një evidentim të plotë të të gjitha shpenzimeve procedurale dhe pasqyrimin e saktë të tyre, si dhe në evidentimin dhe pagesën e të gjitha veprimeve apo akteve procedurale sipas rregullave dhe tarifave përkatëse.
- ❖ Në vijim të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.12, datë 20.07.2020, «Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm», nga Drejtuesi i Prokurorisë është nxjerrë dhe po vijon zbatimi i udhëzimit të përgjithshëm nr.33, datë 04.09.2020 «Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve, në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër» i ndryshuar pjesërisht. Gjithashtu ka vijuar mbikqyerja e mënyrës së zbatimit të udhëzimit nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Shkodër, duke nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme (4 udhëzime gjatë vitit 2023), si dhe janë nxjerrë kërkesa

për informacion në mënyrë periodike ose sipas rastit (kërkesave apo ankesave të palëve) drejtuar prokurorëve në lidhje me çështje konkrete apo procedime penale të caktuara.

❖ Masa konkrete janë marrë edhe në drejtim të nxitjes së prokurorëve dhe shpejtësisë dhe cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe hetimeve në lidhje me të gjitha procedimet penale, por në veçanti me procedimet penale për çështjet e trajtuara në rekomandimet prioritare. Në fazën e hetimeve u është kërkuar prokurorëve dhe oficerëve të koordinojnë veprimet mes tyre dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të kryerjes në kohë dhe me cilësi të veprimeve hetimore dhe në administrimin e akteve dhe provave për këto çështje. Në fazën e gjykimit janë orientuar dhe nxitur prokurorët në aplikimin e instituteve të reja dhe gjykimeve të posaçme dhe në lidhje me aplikimin e masave të përshtatshme të dënimeve në çështjet apo veprat penale objekt të Rezolutës.

❖ **Masat e marra për zbatimin e Udhëzimit të përgjithshëm me Nr.17/2020 « Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje».**

- Edhe gjatë këtij viti janë zbatuar në vijimësi parashikimet e Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr.17/2020 « Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje», edhe gjatë kësaj periudhe ka vijuar zbatimi dhe mbikqyerja e zbatimit sa më të drejtë në praktikë të tij nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Në veçanti janë organizuar mbledhje dhe konsultime me prokurorët dhe oficerët e seksionit të krimeve kundër të miturve dhe dhunës në familje.... Në lidhje me këto grup veprash penale është bërë një punë e kënaqshme si në drejtim të sensibilizimit dhe karakteristik parandalues dhe gjithashtu të hetimit të këtyre veprave penale, kjo edhe në bashkëpunim me institucionet vendore dhe organizatat dhe shoqatat që operojnë në këto fusha.
- Në vijimësi janë orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe psikologët dhe koordinatorja e viktimave në dhënien e asistimit dhe ndihmës ligjore dhe psikologjike gjatë kontakteve, pyetjeve dhe në intervistimet e tyre. Në këtë drejtim vlerësojmë se duhet të bëhet një punë më e madhe dhe një bashkëpunim më i ngushtë me shoqatat e mbrojtjes së viktimave të veprave penale apo Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj, si dhe trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve, oficerëve dhe koordinatorës së viktimave.
- Nga të dhënat e administruara, gjatë vitit 2023, rezulton se janë hetuar 12 procedime penale në lidhje me veprën penale «Përndjekja», të parashikuar nga neni 121/a të K.Penal, ku 3 procedime penale janë të mbartuara, një procedim penal është rifilluar gjatë këtij viti i pezulluar më parë dhe 8 procedime penale janë rregjistruar të reja gjatë këtij viti. Nga këto procedime penale, 3 procedime penale me 3 të pandehur janë dërguar për gjykim, 6 procedime penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim, 1 procedim është pezulluar dhe vijojnë të jenë në hetim 2 procedime penale.
- Në lidhje me veprat penale të braktisjes së të miturit apo keqtrajtimit të të miturit nenet 124 dhe 124/b të K.Penal, rezulton se janë hetuar 8 procedime penale, ku 6 procedime penale janë të mbartura dhe 2 procedime penale janë të rregjistruara këtë vit. Në lidhje me këto procedime penale, rezulton se 3 (tre) procedime penale me 3 persona të marrë të pandehur janë dërguar për gjykim, 1 (një) procedim penal është

dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim, vijojnë 4 procedime penale të jenë në hetim.

- Në lidhje me veprat penale të dhunës në familje të parashikuar nga neni 130/a të K.Penal, rezulton se janë hetuar 91 procedime penale (20 më shumë se një vit më parë), ku 1 procedim penal i përket Prokurorisë Pukë i regjistruar gjatë këtij viti dhe i dërguar për gjykim me 1 person të marrë të pandehur. Ndërsa 20 procedime penale janë të mbartura nga viti 2022 dhe 70 (shtatëdhjetë) procedime penale janë regjistruar këtë vit. Në lidhje me këto çështje, rezulton se 46 (dyzet e gjashtë) procedime penale me 46 persona të marrë të pandehur nga të cilët 23 të arrestuar janë dërguar për gjykim, 17 (shtatëmbëdhjetë) procedime penale janë pushuar për mungesë fakti apo shkaqe të tjera, ndërsa 1 procedim penal është transferuar në prokurori tjetër dhe vijojnë të jenë në hetim edhe 26 (njëzet e gjashtë) procedime të tjera penale.
- Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe një kujdes i veçantë është treguar në rastet e procedimeve penale me viktime të dhunës në familje të mitur dhe viktimave femra, në drejtim të sigurimit të kushteve dhe gjendjes sa më të përshtatshme për të dhënë deklarime dhe paraqitur prova, si dhe shmangien e kontakteve të drejtëpërdrejta me shkelësit, më përjashtim të rasteve kur ballafaqimi ka qenë i domosdoshëm. Kryerja e intervistave dhe pyetjeve nga oficerë femra, si dhe në praninë e psikologeve dhe mbrojtësve ligjor femra në të gjitha rastet kur kjo ka qenë e mundur.
- Është arritur që pjesa dërmuese e rasteve të veprave penale të dhunës në familje, me bazë gjinore apo diskriminuese të hetohen nga prokurorët dhe oficerët e trajnuar të seksionit ndaj dhunës në familje dhe të miturve. Në rastet e veprave penale me të mitur kjo ka qenë për të gjitha procedimet. Vështirësi është hasur për shkak të numrit të vogël të prokurorëve, problemeve të gadishmërisë dhe në këto raste, çështja është hetuar me grup hetimor ku së paku një nga prokurorët ka qenë pjesë e seksionit të dhunës në familje dhe të miturve.
- Në të gjitha këto procedime, është synuar hetimi në një kohë sa më të shkurtër, kjo edhe në varësi të bashkëpunimit të institucioneve të tjera në paraqitjen dhe marrjen e provave, kjo duke synuar në sigurimin në të gjitha rastet të të drejtave dhe garancive procedurale për viktimat e dhunës në familje, me bazë gjinore apo e viktimave të mitur. Edhe për sa i përket masave dhe llojit të dënimit në këto raste, janë udhëzuar prokurorët dhe është synuar në mbajtjen e dënimeve në mbi mesataren e marzheve të dënimit por duke pasur parasysh edhe rrethanat personale apo lehtësuese e rënduese të autorëve të vepres penale apo raportet me viktimat e veprave penale.

❖ **Masat e marra për zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr.8/2020 «Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm» dhe Udhëzimit të Përgjithshëm me nr.06, datë 23.07.2021 «Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020, për shpenzimet procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm».**

- Në lidhje me udhëzimin e përgjithshëm me Nr.8/2020 «Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm», i ndryshuar më pas me udhëzimin e përgjithshëm me nr.06, datë 23.07.2021 «Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020, për shpenzimet procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm». Në vijimësi, janë marrë masat e duhura për shpërndarjen dhe njohjen me këto urdhëra të prokurorëve dhe zyrës së financës në lidhje me mënyrën e kuptimit dhe zbatimit të tyre. Në veçanti janë organizuar

mbledhje dhe konsultime me prokurorët dhe oficerët dhe zyrën e financës në lidhje me mënyrën e evidentimit të shpenzimeve dhe mënyrën e pagesës së ekspertëve të ndryshëm, psikologëve dhe mbrojtësve të caktuar kryesisht, etj.

- Në zbatim të këtyre udhëzimeve edhe nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Udhëzimi i Përgjithshëm me Nr.58 datë 17.10.2022 «Për evidentimin, dokumentimin, dhe pagimin e tarifave dhe shpenzimeve procedurale penale në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër». Në vijim është bërë shpërndarja dhe njohja me të e të gjithë prokurorëve dhe oficerëve dhe është diskutuar mënyra e zbatimit të tij në mbledhjet dhe takimet me prokurorët, ku aktualisht po vijon mbikqyerja e zbatimit të tij. Në veçanti janë organizuar mbledhje dhe konsultime me prokurorët dhe oficerët dhe zyrën e financës në lidhje me mënyrën e evidentimit të shpenzimeve dhe mënyrën e pagesës së ekspertëve të ndryshëm, psikologëve dhe mbrojtësve të caktuar kryesisht, etj.
- Janë udhëzuar prokurorët për mënyrën e mbajtjes së procesverbaleve të shpenzimeve procedurale dhe në lidhje me nxjerrjen e urdhërave për pagimin e këtyre shpenzimeve. Gjithashtu, prokurorët janë udhëzuar në evidentimin e saktë të të gjitha shpenzimeve, qoftë atyre të parapaguara nga shteti, ashtu edhe atyre që paguhen në vijimësi, në mënyrë që në përfundim të hetimeve procesverbalet të jenë të plota dhe të sakta dhe ato të evidentohen saktë në rregjistrin e shpenzimeve procedurale.
- Duhet theksuar se disi vështirësi janë hasur edhe në dokumentimin e shpenzimeve të kryera në terren për shkak të mungesës së standartizimit të tyre, në rastin e kqyerjeve të ndryshme, të vendeve apo objekteve, në kryerjen e eksperimenteve apo ekspertizave të ndryshme, etj.
- Është orientuar zyra e financës për kalimin vetëm të urdhërave të pagesave që kanë njëkohësisht nënshkrimet e prokurorit të çështjes dhe të drejtuesit të prokurorisë. Në rastet e veprave penale të filluara mbi ankimit e të dëmtuarit dhe është vendosur pushimi i çështjes për shkak se fakti nuk ekziston apo i dëmtuari ka hequr dorë nga ankimi, janë orientuar prokurorët që pagimi i shpenzimeve ti ngarkohet ankuesit.
- Nuk ka pasur raste të kërimit paraprakisht të sekuestrimin të pasurisë së të pandehurit në rastet kur ka pasur dyshime në mundësinë apo vullnetin e tij në pagimin e shpenzimeve, kjo është bërë edhe për të shmangur çdo pretendim për paragjykim apo njëanëshmëri në çështje.
- Në të gjitha çështjet e përfunduara, të dërguara në gjyq, të pushuara, të pezulluara, janë evidentuar dhe nxjerrë procesverbalet e shpenzimeve procedurale dhe në vijim janë nxjerrë edhe urdhërat e pagimit dhe gjithashtu është proceduar me pagimin e ekspertëve që kanë paraqitur rregullisht dokumentacionin ligjor.
- Në lidhje me pagimin e shpenzimeve pasi vendimi penal ka marrë formë të prerë, janë udhëzuar prokurori i ekzekutimeve dhe prokurorët e tjerë në evidentimin e saktë të shpenzimeve dhe dërgimin e urdhërave të ekzekutimit në kohë në zyrën e përmbartimit dhe në marrjen e masave të tjera ligjore për të bërë të mundur pagimin e shpenzimeve dhe ekzekutimin e të gjitha detyrimeve financiare nga personat e dënuar dhe të parapaguara nga shteti.
- Edhe gjatë vitit 2023, është ka vijuar normalisht zbatimi i udhëzimit me nr.03 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori“, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku në vazhdimësi janë marrë masa për respektimin e këtij udhëzimi. Është bërë hedhja e shortit elektronik gjatë gjithë vitit dhe në ato raste kur janë konstatuar probleme janë marrë masa për hedhjen e shortit manual për të shmangur

vonesën në administrimin e materialeve kallëzuese. Në lidhje me çështjet e gadishmërisë është bërë lista e gadishmërisë dhe materialet e tilla i kanë kaluar prokurorit të gatshëm sipas listës së gadishmërisë. Ndërsa për çështjet e vjetra, të rifilluara, të kthyer nga gjykata dhe kur është bërë zëvendësimi i prokurorit apo heqja dorë është aplikuar shorti manual për shkak të pamundësisë së hedhjes së shortit elektronik.

- Është treguar kujdes në rastet e marrjes së vendimeve për përjashtim nga shorti të prokurorëve të caktuar, duke u nisur nga ngarkesa e tyre dhe ngarkesa në raport me prokurorët e tjerë. Në këtë drejtim është hasur disi në vështirësi për shkak të ndarjes në seksione dhe rëndësisë së ndryhme të çështjeve, si çështje voluminoze, komplekse, me shumë të pandehur apo shumë veprime apo çështje të zgjatura në kohë për karakterin e tyre. Një vëmendje i është kushtuar edhe rasteve të heqjes dorë dhe rasteve të kërkesave të palëve për përjashtimin apo zëvendësimin e prokurorëve. Në këto raste, është kërkuar verifikimi nëse janë kushtet ligjore për heqjen dorë apo për përjashtimin e prokurorit dhe në ato raste kur është konstatuar mungesa e shkaqeve ligjore kërkesa nuk është pranuar si e pabazuar. Në raste të tjera janë marrë vendimet përkatëse për zëvendësimin e prokurorit dhe rihedhja në short e materialit apo e procedimit. Një përjashtim dhe kujdes i është dhënë rastet e çështjeve me të mitur duke synuar që ato të trajtohen nga seksioni përkatës për të miturit.
- Me qëllim zbatimin e drejtë të Udhëzimit të Përgjithshëm me nr.03, datë 26.10.2018 „Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar „Sekret Shtetëror“, të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë urdhëri me nr.18/1, datë 27.05.2021 „Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar „Sekret Shtetëror“. Në zbatim të këtyre akteve janë marrë masa për rritjen e sigurisë dhe procedurës së administrimit, përpunimit dhe ruajtjes së akteve dhe dokumenteve të klasifikuar. Në këtë drejtim është synuar që me këto akte të punojnë vetëm nëpunës që janë pajisur me certifikatë sigurie dhe gjithashtu është kërkuar një kujdes i posacëm në lidhje me administrimin dhe përpunimin e këtyre dokumenteve. Në vijimësi po mbikqyret kjo procedurë me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të sigurisë dhe respektimin e të gjitha procedurave të administrimit, përpunimit dhe ruajtjes e arkivimit të këtyre dokumenteve. Në ato raste kur është evidentuar pakujdesia apo shkelje e këtij udhëzimi janë marrë masa për evidentimin e shkeljes dhe shkelësit dhe marrjes e masave përkatëse sipas parashikimeve ligjore.
- Në lidhje me mbledhjet e prokurorisë gjatë këtij viti, janë pasur parasysh parashikimet ligjore të ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe urdhëri i Drejtuesit të Prokurorisë Nr.02 datë 07.01.2021, “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër” e ndryshuar, ku janë respektuar parashikimet ligjore të njoftimit të mbledhjes me shkrim dhe respektimi i afatit tre ditor për njoftimin e mbledhjeve. Mbledhjet përgjithësisht kanë qenë periodike dhe janë trajtuar çështje të ndryshme që nga ngarkesa e prokurorëve, çështjet e mbartura, respektimi i afateve procedurale, respektimi i të drejtave dhe garancive të subjekteve procedurale, njohja dhe zbatimi i urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, Rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë, Rekomandimet e Këshillit të Ministrave, aktet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, etj, e deri në diskutimin e problematikave të dalë në grupe çështjesh apo në çështje të ngritura nga vetë prokurorët.

- Gjatë kësaj periudhe nga ana e drejtuesit të prokurorisë janë nxjerrë mbi 60 (gjashtëdhjetë) akte, si urdhëra, udhëzime të përgjithshme e udhëzime të posaçme dhe kërkesa për informacion në lidhje me hetimet e kryera, veprimet hetimore, afatet e hetimeve, dosjet e mbartura, të drejtuara prokurorëve në tërësi apo prokurorëve konkret për çështje të caktuara, duke vlerësuar dosjet e mbartura, vonesat apo zvarritje dhe dosjet me të arrestuar apo me ndjeshmëri publike. Gjithashtu, janë nxjerrë edhe rreth 4 (2+2) udhëzime të posaçme për çështje konkrete në lidhje me hetimet e kryera, për zëvendësim apo mospranimin e kërkesës për zëvendësim apo heqje dorë të prokurorit, si dhe dhënien e orientimeve dhe sugjerimeve për veprimet hetimore që duhet të kryhen në vijim, etj.

❖ **Raportim mbi veprimtarinë e prokurorisë në kuadër të zbatimit Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.**

- Në vijimësi që nga hyrja në fuqi e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit miratuar me ligjin Nr.37/2017, është punuar me qëllim respektimin dhe zbatimin rigoroz të të gjitha parashikimeve të këtij ligji. Janë orientuar dhe udhëzuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe psikologët dhe koordinatorja e viktimave në dhënien e asistencës, këshillimit dhe ndihmës ligjore dhe psikologjike gjatë kontakteve, pyetjeve dhe në intervistimet me viktimat e këtyre veprave por edhe në rastin e personave nën hetim apo të pandehurve të mitur, etj.
- Ngarkesën kryesore në lidhje me veprat penale dhe çështjet me të miturit gjatë këtij viti e ka pasur Seksioni 2, ku pjesë e këtij seksioni janë veprat penale në lidhje me të miturit, si të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë të vepres penale, ashtu edhe ato të dhunës në familje. Ky seksion përbëhet me tre prokurorë dhe oficerë, si dhe me stafin ndihmës ku duhet pranuar se kanë bërë një punë të mirë në drejtim të orientimit dhe ndërgjegjësimit të subjekteve të tjera procedurale, si dhe në rritjen e bashkëpunimit me subjektet dhe institucionet e tjera lokale dhe qendrore me fokus të miturit dhe viktimat e dhunës në familje. Është bashkëpunuar me strukturat përkatëse pranë bashkive si dhe me shoqatat e mbrojtjes së viktimave të veprave penale, të dhunës në familje apo Njësisë për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijës, etj.
- Duhet theksuar gjithashtu se parashikimet e ligjit Nr.37, viti 2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, kanë nxjerrë detyra dhe problematika të reja për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore dhe implementimi i plotë të këtij ligji, i akteve të tjera dhe institucioneve të reja mbetet një sfidë për tu realizuar dhe duhet pranuar që në këtë drejtim po punohet me seriozitet por, përsëri mbetet shumë për tu bërë nga të gjitha palët, pasi në vijimësi janë konstatuar mangësi në faza të ndryshme të procesit penale më të mitur.
- Seksioni i të Miturve, gjatë vitit 2023, ka funksionuar normalisht pamvarësisht problematikave të ndryshme gjatë viti, duke respektuar parashikimet ligjore, ku është përbërë nga 3 (tre) prokurorë dhe 4 (katër) oficer të policisë gjyqësore, një nga prokurorët është caktuar edhe Drejtues Seksioni.
- Në vijimësi, janë udhëzuar dhe orientuar prokurorët dhe oficerët jo vetëm në zbatimin e parashikimeve ligjore por edhe në zbatimin dhe përqëndrimin edhe në urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm “Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur person nën hetim, i dëmtuar, viktimë e vepres

penale ose edhe si dëshmitar”, duke siguruar pjesëmarrjen e psikologut gjatë hetimit, si asistues i të miturit ashtu edhe në kryerjen e raportit psikologjik për të miturin gjatë hetimeve, si dhe është orientuar në drejtim të ruajtjes së sekretit të informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore dhe provave të mbledhura nga policia gjyqesore, në rastet e hetimeve në ngarkim të pandehurve të mitur.

- Gjatë kësaj periudhe ka pasur 116 referime për vepra penale ku janë përfshirë persona të mitur si të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë të vepres penale. Për 7 raste është vendosur raportimi i tyre dhe për 18 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Në 69 raste është vendosur rregjistrimi i procedimit penal me të mitur autorë si të mitur në konflikt me ligjin. Ku vetëm në një rast i mituri në konflikt me ligjin është femër ndërsa të gjithë të miturit e tjerë 51 janë meshkuj dhe ndahen sipas grupmoshave 12 të mitur në grupmoshat 14-16 dhe 36 të mitur në grupmoshën 16-18 vjeç. Në 2 raste janë caktuar masat e sigurimit arrest në burg dhe në 3 raste janë caktuar masat e sigurimit arrest në shtëpi dhe detyrim.
- Nga këto procedime penale, rezulton se në 34 raste është marrë vendim për pushimin e procedimit, ku në një rast është marrë masa e shmangies me paralajmërim me gojë, në 27 raste është marrë masa e shmangies dhe paralajmërimi me shkrim, ndërsa në 6 raste është marrë vendim pushimi për shkaqe të tjera.
- Ndërsa 12 çështje me 12 të mitur në konflikt me ligjin janë dërguar për gjykim dhe për 5 raste gjykimi ka kaluar seancën paraprake. Në 4 raste është kërkuar dënime alternative dhe vetëm 1 një rast dënim me burgim për shkak të rrethanave të vecantë të vepres penale dhe të të miturit. Ndërsa vijojnë hetimet për rastet e tjera.
- Rezulton se nga këto procedime penale, 27 procedime penale kanë qenë me viktimë të vepres penale të mitur, me rreth 30 viktimë, nga të cilat 15 viktimë femra dhe 15 viktimë meshkuj, ku një rast me plagosje të lehtë dhe 3 raste me vdekje.
- Në të gjitha këto procedime, është synuar hetimi në një kohë sa më të shkurtër, kjo edhe në varësi të bashkëpunimit të institucioneve të tjera në paraqitjen dhe marrjen e provave, kjo duke synuar në sigurimin në të gjitha rastet të të drejtave dhe garancive procedurale për viktimat e dhunës në familje, me bazë gjinore apo e viktimave të mitur.
- Edhe për sa i përket masave dhe llojit të dënimit në këto raste, janë udhëzuar prokurorët dhe është synuar në mbajtjen e dënimeve në mbi mesataren e marzheve të dënimit por duke pasur parasysh edhe rrethanat personale apo lehtësuese e rënduese të autorëve të vepres penale apo raportet me viktimat e veprave penale.
- Pjesa më e madhe e të miturve në konflikt me ligjin janë moshës 16-18 vjeç (36 persona), ndërsa pjesa tjetër janë të grupmoshës 14-16 vjeç (12 persona), ndërsa 4 raste kanë qenë nën moshën 14 vjeç. Në lidhje me gjininë 98 % e të miturve në konflikt me ligjin 51 janë meshkuj dhe 2 % apo vetëm 1 rast është femër. Nga ana tjetër në lidhje me viktimat e mitura 15 janë femra ose 50 % e tyre dhe po ashtu 15 janë meshkuj ose 50 %.
- Rezulton se ka një rritje të numrit të procedimeve penale 69 procedime me persona të dyshuar të mitur gjatë këtij viti (kundrejt 63 procedime në vitin 2022). Në lidhje me hetimin dhe gjykimin e personave të mitur prokurorët dhe oficerët janë nxitur dhe udhëzuar në drejtim të respektimit të të drejtave dhe garancive procedurale të të miturve, respektimin e konfidencialitetit të këtyre çështjeve dhe ruajtjen e të dhënave të personave të mitur të përfshirë në këto çështje në pozita të ndryshme procedurale.

- Thuajse në të gjitha procedimet penale më të mitur është kërkuar aplikimi i dënimeve alternative si shmugia nga procedimi dhe në raste të tjera aplikimi i parashikimeve ligjore të neneve 53, 59, 63 të K.Penal, kjo duke pasur parasysh natyrën e vepres penale, rrezikshmërinë e paketë të vepres penale dhe të autorit, personalitetin e tij dhe rrethanat lehtësuese.

❖ **Raportim mbi veprimtarinë e prokurorisë në lidhje me të dhënat dhe ecurinë e rasteve të referuara nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Institucionet e tjera.**

- Në lidhje me procedimet penale të referuara nga institucionet e Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet e tjera qëndrore rezulton se gjatë këtij viti i është kushtuar kujdes dhe vëmendje në drejtim të administrimit dhe hetimit të shpejtë të tyre, si dhe kryerjes së hetimeve sa më të plota dhe sa më cilësore.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se ka pasur 13 (njëmbëdhjetë) raste të materialeve referuara nga Prokuroria e Përgjithshme (kundrejtë 11 materiale në vitin 2022), të cilat janë rregjistruar menjëherë si kallzime penale. Gjithashtu, ka qenë pothuajse edhe kaq raste të tjera të cilat janë administruar si materiale apo kallzime shtesë duke qenë se tashmë ishte rregjistruar një kallzim penal apo procedim penal mbi bazën e të njëjtëve kallzime apo fakte të referuara nga kallzuesit në dy apo edhe më shumë drejtime njëkohësisht, si në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga këto referime, për 2 materiale është marrë vendim mosfillimi të procedimit penal. Ndërsa 11 materiale janë rregjistruar si procedime penale.
- Nga këto procedime penale, 2 procedime penale me 2 të pandehur janë hetuar dhe janë dërguar për gjykim. 3 procedime penale pasi janë hetuar janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e çështjes. Për 1 procedim penal është marrë vendim moskompetence. Ndërsa 5 (pesë) procedime penale ndodhen aktualisht në hetim.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se nuk ka pasur 1 referim nga KQZ Tiranë, i cili më pas është rregjistruar si procedim penal dhe është dërguar për gjykim me 10 persona të pandehur në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 327/a të K.Penal.
- Nga prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë dërguar për kompetencë 57 procedime penale apo kallzime penale.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se nga DRSSH Shkodër janë referuar 20 kallzime penale, ku për 6 prej tyre është marrë vendim mosfillimi, për 2 raste është marrë vendim moskompetence duke i dërguar në prokuroritë kompetente, ndërsa kallzimet e tjera janë rregjistruar dhe hetuar.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se nga I.M.T Bashkia Shkodër janë referuar 53 kallzime penale, ku për 6 prej tyre është marrë vendim mosfillimi, ndërsa kallzimet e tjera janë rregjistruar dhe hetuar, ku thuajse të gjitha kallzimet lidhen me veprën penale të parashikuar nga neni 199/a të K.Penal.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se nga Zyra Përmbarrimore Shkodër janë referuar 7 kallzime penale, ku për 3 prej tyre është marrë vendim mosfillimi, ndërsa 4 kallzimet e tjera janë rregjistruar si procedime penale dhe janë hetuar.

- Gjatë vitit 2023, rezulton se nuk ka pasur referime dhe procedime penale të regjistruara mbi bazën e referimeve apo kallëzimeve penale të institucionit të K.L.Sh-së.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se nuk ka pasur referime dhe procedime penale të regjistruara mbi bazën e referimeve apo kallëzimeve penale të institucionit të I.L.D-së.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se nuk ka pasur referime dhe procedime penale të regjistruara mbi bazën e referimeve apo kallëzimeve penale të institucionit të I.L.D.K.P.K.I-së.
- Gjatë vitit 2023, rezulton se nuk ka pasur referime dhe procedime penale të regjistruara mbi bazën e referimeve apo kallëzimeve penale të institucionit të Avokatit të Popullit.
- Edhe gjatë të vitit 2023, ashtu si edhe vitet e mësparshme është mbajtur një bashkëpunim i ngushtë dhe në rritje e komunikimeve dhe takimeve me të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, kjo duke pasur parasysh edhe vështirësitë e ndryshme të dala gjatë vitit. Kjo me qëllim të rritjen e efijencës dhe cilësisë së hetimeve dhe të veprimtarisë administrativo penale të prokurorisë. Është arritur bashkëpunim deri diku i kënaqshëm me organet vendore, si, Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Vau Dejës, Këshillat Bashkiake dhe Këshillin e Qarkut, por gjithashtu edhe në lidhje me kallëzimet penale të referuara prej tyre. Gjithashtu, kemi pasur një bashkëpunim të mirë me Prefektin, me njësitë administrative, ASHK, Tatimet, Doganat, etj.
- Bashkëpunim shumë të mirë dhe në rritje kemi pasur me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Zyrat Përmbarimore, me Degën Territoriale të Shërbimit të Provës, Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, Institutin e Policisë Shkencore dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore, etj.
- Në mbledhjet, takimet dhe analizat e zhvilluara me këto polici dhe me drejtuesit e tyre është insistuar në rritjen e efijencës dhe cilësisë së hetimeve, krijimin e grupeve hetimore efektive në rastin e hetimeve të veprave të rënda penale, komplekse apo me numër të madh veprimesh.
- Në vijimësi gjatë këtij viti, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë ndjekur vazhdimisht seminare dhe trajnime sipas profileve të punës së tyre në seksione, por edhe trajnime të vlerësuara sipas nevojës së tyre dhe gjithashtu trajnimet në fushën e «Pastrimit të produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale» dhe hetimeve pasurore, etj. Organizimi i seminareve dhe trajnimeve si të prokurorëve ashtu edhe të oficerëve të policisë gjyqësore në fushën e drejtësisë penale për të mitur vlerësohet i domosdoshëm me qëllim kryerjen e hetimeve të shpejta dhe cilësore dhe garantimin e të drejtave të këtyre subjekteve. Gjithashtu, vlerësohet e nevojshme shtimin e seminareve dhe trajnimeve në lidhje me ndryshimet e reja në Kodin Penal, në Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, si dhe trajnimet me veprat dhe grupveprat, të cilat i kanë kaluar për kompetencë prokurorive të rretheve, si trafikimi i narkotikëve, trafikimi i armëve, trafikimi i personave, hetimet pasurore, etj.

- Nga të dhënat e përgjithshme dhe ato të analizës, rezulton se rastet e hetimeve të filluara kryesisht nga prokurorët, kanë një rritje me një vit më parë por duhet pranuar se mbeten të ulëta, në raport me numrin e përgjithshëm të kallzimeve penale dhe procedimeve penale. Ky fakt i ndikuar shumë edhe nga ngarkesa e madhe e çështjeve në hetim dhe gjykim, të shkaktuara nga numri i vogël i prokurorëve, po ashtu ka ndikuar edhe nga ngarkesa, profesionalizmi dhe puna jo në nivelin e duhur e policisë gjyqësore. Në rastet kur prokurorët kanë konstatuar vetë fakte penale apo dyshime kanë orientuar menjëherë oficerët që të verifikojnë rastet me qëllim fillimin kryesisht të rasteve të dyshimta. Pamvarësisht kësaj, vijimi i nxitjes së mëtejshme dhe gjatë vitit 2024, besojmë se do të shërbejë rritjes së mëtejshme numrit të procedimeve penale të filluara kryesisht.
- Në këtë analizë vlen të përmendim, se sa i përket bashkëpunimit me agjensitë e ndryshme ligjzbatuese, nga këto agjensi duhet të bëhen përpjekje maksimale që të rriten referimet për kryerjen e veprave penale.
- Një bashkëpunim i ngushtë ka vijuar gjatë vitit 2023 edhe me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Drejtoritë e saj, Drejtoria e Koordinimit, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, etj, me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ku janë administruar dhe zbatuar urdhërat, udhëzimet dhe vendimet e tyre dhe nga ana tjetër janë adresuar kërkesat dhe ankesat për zgjidhje në vijimësi duke konstatuar një mbështetje dhe bashkëpunim në rritje dhe inkurajues për të ardhmen.
- Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është synuar dhe treguar një kujdes i veçantë në lidhje me kthimin e përgjigjeve, dërgimin e informacioneve, akteve dhe dokumentacionit të kërkuar nga Drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisioni i Apelit, Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, etj.
- Bashkëpunim i shumë i mirë dhe në rritje kemi pasur me Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe me Prokuroritë e Rretheve me Juridiksion të Përgjithshëm. Kjo në lidhje me ankimet e bëra dhe me mundësinë e bërjes së ankimeve shtesë, për njoftimet e seancave në apel apo vendimet e marra nga Gjykata e Apelit, si dhe nga ana tjetër në lidhje me procedimet e ardhura apo ato të dërguara për kompetencë nga prokuroritë e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm, etj.
- Gjatë vitit 2023, është synuar dhe nxitur bashkëpunimi i ngushtë me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kjo me qëllim rritjen performancës dhe përfaqësimit në gjykim. Ku është synuar dhe realizuar në masë të madhe paraqitja në kohë dhe shqyrtimi i kërkesave të hetimeve paraprake, si dhe me qëllim bërjen e kërkesave të sakta dhe të plota, të mbështetura në prova dhe në bazë ligjore. Kjo i ka shërbyer gjykimit në kohë të këtyre kërkesave dhe shmangien e rasteve të vonesave të paarsyeshme apo cënimit të sekretit hetimor. Gjithashtu, ka pasur komunikime të vazhdueshme në lidhje me përfaqësimin në

gjykim të çështjeve penale si në fazën e seancës paraprake ashtu edhe në gjykimin në themel, si dhe kërkesat e tjera në fazën e gjykimit apo të ekzekutimit të vendimeve. Prokurorët janë nxitur në drejtim të respektimit të disiplinës, etikës në gjykim dhe jashtë tij, respektimit të procedurës gjyqësore, solemnitetit në gjykim dhe shmangies së problematikave të zvarritjes së gjykimit, shtyrjes apo mungesës në seanca gjyqësore apo mosrespektimit të detyrimeve procedurale, etj.

- Një bashkëpunim i ngushtë gjatë vitit ka qenë edhe me Shkollën e Magjistraturës, ku nga prokurorët ashtu edhe nga oficerët e policisë gjyqësore në vazhdimësi është ndjekur procesi i trajnimit vazhdues, qoftë drejtëpërdrejtë në Shkollë ashtu edhe trajnimet lokale, me qëllim rritjen e tyre profesionale dhe specializimin sipas seksioneve apo njohjen më të mirë dh zbatim të legjislacionit penal në tërësi.

❖ ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË PËR VITIN 2023.

- Volumi i punës në hetim gjatë vitit 2023;
- Çështje të përfaqësuara në gjykatë dhe mënyra e përfundimit të tyre;
- Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë;
- Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale;
- Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror;
- Treguesit e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale, peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre;
- Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal.

❖ Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë, volumi i punës në hetim.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, gjatë vitit 2023 ka funksionuar nën një organizim të përcaktuar strukturor, në përputhje me ndryshimet e bëra në ligj dhe strukturën e mitratuar në fillim të vitit 2023 dhe në vijim në muajin maj nga Prokurori i Përgjithshëm.

Detyra dhe funksionet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit Nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit Nr.2, datë 19.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimit Nr.3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, është nxjerrë Urdhëri Nr.1 datë

02.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e punës në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”, i ndryshuar, Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë Nr.02, datë 07.01.2021, “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”, si dhe urdhërat për ndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në seksione, të ndryshuar gjatë vitit, për shkak të ndryshimeve ligjore apo faktike, etj.

Në bazë të urdhërit në fjalë janë krijuar tre seksione të veçanta dhe një seksion/zyrë për pjesën e ekzekutimeve, e konkretisht:

- *Seksioni 1, Seksioni i Përgjithshëm.*
- *Seksioni 2, Seksioni për ndjekjen penale dhe ngritjen e akuzës në gjykim për veprat penale të kryera nga të miturit apo ndaj tyre, veprat penale kundër moralit dhe marrëdhënieve familjare dhe veprat penale në fushën e qarkullimit, etj.*
- *Seksioni 3, Seksioni i Posaçëm kundër Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit, Krimeve Financiare dhe Hetimeve Pasurore”.*
- *Seksioni/Zyra 4, Zyra e ekzekutimeve të vendimeve penale, marrëdhënieve juridiksionale me jashtëdhe kërkesave gjatë fazës së ekzekutimeve.*
- Ky urdhër “Për ri-organizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”, është ndryshuar gjatë vitit nga Drejtuesi i Prokurorisë kjo e ndikuar nga numri i procedimeve penale, numri i prokurorëve, ndryshimet e ardhura nga shkrirja e prokurorive si rrjedhojë e zbatimit të “Hartës së Re Gjyqësore”, si dhe lëvizjet dhe largimet e prokurorëve apo lëvizjet e oficerëve të policisë gjyqësore.
- Kjo ndarje është bërë në kushtet e respektimit të organikës dhe strukturës faktike të prokurorisë dhe mbi bazën e këtyre seksioneve është bërë ndarja e prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore. Në ruajtjen e kësaj ndarje është pasur si qëllim sigurimi i një ngarkese pjesërisht të balancuar mes seksioneve, duke marrë parasysh llojin e veprave penale në hetim dhe volumin e tyre, por për shkak të lëvizjeve të shpeshta dhe të paparashikueshme dhe referimeve të veprave penale është hasur në vështirësi në realizimin e një barazie të ploteë.
- Në vijimësi është synuar që edhe brenda seksioneve të kishte një ngarkesë sa më të ekuilibruar. Në pjesën më të madhe të kohës ka funksionuar sistemi CAMS, duke pasur përparësi hedhja e shortit elektronik dhe si përjashtim është aplikuar shorti manual. Gjithashtu, lëvizja e prokurorëve, largimet, komandimet dhe rikthimi në detyrë, kanë bërë që të mos ketë një ndarje të barabartë të ngarkesës dhe çështjeve mes prokurorëve.


❖ **Treguesit statistikorë 1 vjeçar të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal, në hetim.**

- Gjatë vitit 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (duke përfshirë edhe ngarkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë), në total janë trajtuar rreth 4017 materiale verifikuese dhe hetimore (Shkodër dhe Pukë), që e përbëjnë referimet, raportimet, kallëzimet penale,

procedime penale të mbartura, të ardhura për kompetencë, të rifilluara dhe të rregjistruara gjatë vitit 2023 ose rreth 257 materiale më pak se në vitin 2022, me një rënie prej 6 % (gjatë vitit 2022 janë trajtuar 4274 materiale). Nga këto materiale **3261** janë procedime penale të mbartura, të rifilluara dhe të rregjistruara rishtazi dhe **756** janë mosfillime dhe raportime.

- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë vitit 2023 janë rregjistruar si procedime penale të reja **1641 procedime penale**. Nga këto 1616 procedime janë procedime të reja të Prokurorisë Shkodër dhe 25 procedime penale janë procedime të reja të Prokurorisë Pukë. Rezulton se janë rregjistruar 126 procedime penale më pak se në vitin 2022, (në vitin 2022 janë rregjistruar 1767 procedime penale), me **një rënie prej 7 %**.
- Janë mbartur nga viti 2022, rreth **1047** procedime penale për vepra të ndryshme penale. Nga këto **23** procedime penale janë të ardhura me transferim. Gjithashtu, janë rifilluar **573 procedime penale** të pezulluara në vite, për shkak të identifikimit të autorit, administrimit të letërporosive, por pjesa më e madhe për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe shkaqe të tjera ligjore. Nga këto **16 procedime penale** janë rifilluar për shkak identifikimit të autorit ose për shkak të administrimit të letërporosive dhe **557** janë rifilluar për shkak të parashkrimit të vepres penale, ku **532** janë dërguar me kërkesë në gjykatë për pushimin e çështjes dhe **25** procedime penale janë pushuar me vendim të Prokurorit duke qenë për vepra që përbëjnë kundravajtje penale.

NGARKESA E VITIT 2023



▣ KALLEZIMET ▣ PROC.REJA ▣ PROC TE MBARTURA ▣ TE RIFILLUARA ▣ RAPORTIME

- Ndërsa për **356 materiale kallëzuese** (339 Prokuroria Shkodër dhe 17 Prokuroria Pukë) ku është vendosur mosfillimi i procedimit penal, duke qenë se fakti i referuar nuk përbën veper penale apo për shkaqe të tjera.
- Gjithashtu janë arshivuar edhe **400 raportime** të referuara gjatë vitit (352 raportime në vitin 2022, me një rritje prej 48 raportime ose me një rritje prej 13.6 %), kjo në zbatim të

Udhëzimin e Përgjithshëm me Nr.15, datë 30.10.2020, “Për trajtimin e njoftimeve nga viktima akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementët e vepres penale”, të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me nr.1460 prot, datë 30.09.2020.

- Gjatë vitit 2023, në total janë trajtuar rreth **3261 procedime penale**, që e përbëjnë, procedime penale të mbartura, të ardhura për kompetencë, të rifilluara dhe të rregjistruara gjatë vitit 2023, (gjatë vitit 2022 janë hetuar 3653 procedime penale) ose me një rënie prej 392 procedime penale më pak apo me rënie prej 10.7 %. Nga këto **1641** janë procedime penale të reja, 1047 janë të mbartura, 23 janë të ardhura me transferim dhe 573 janë procedime penale të rifilluara.
- Pra gjatë këtij viti janë rregjistruar **1641 procedime penale të reja**, (Prokuroria Shkodër dhe Prokuroria Pukë) rezulton se ka një rënie të procedimeve të reja të rregjistruara gjatë vitit 2023 në krahasim me një vit më pare, me .

✚ *Në vitin 2023 janë rregjistruar 1641 procedime penale të reja.*


✚ *Në vitin 2022 janë rregjistruar 1767 procedime penale të reja.*

✚ *Në vitin 2021 janë rregjistruar 1618 procedime penale të reja.*

✚ *Në vitin 2020 janë rregjistruar 1587 procedime penale të reja.*

✚ *Në vitin 2019 janë rregjistruar 2244 procedime penale të reja.*

PROCEDIMET E REJA PENALE NE VITE




- Rezulton se ka një ulje të procedimeve të reja të rregjistruara gjatë vitit 2023 në krahasim me një vit më parë edhe më herët. Në vitin 2022 janë rregjistruar 1767 procedime. Në vitin 2021 janë rregjistruar 1618 procedime. Në vitin 2020 janë rregjistruar 1587 procedime penale të reja. Në vitin 2019 janë rregjistruar 2244 procedime penale të reja.

- Nga tërësia e procedime penale të hetuara gjatë këtij viti rezulton se janë **përfunduar 2570 procedime penale** me vendimarrje të ndryshme kundrejt 2547 procedime penale të përfunduara në vitin 2022. Nga këto janë
- Ndërsa mbetën në hetim **695** procedime penale që mbarten në vitin 2024 (*ku përfshihen procedime penale të mbartura dhe të rifilluara, etj*). Ku në vitin 2022 dhe vitet e mëparshme janë mbartur mbi 1047 procedime penale. Pra ka një rënie të procedime të mbartura me një vit më parë me rreth 352 procedime më pak ose me një ulje të ngarkesës me 33%.

Nga procedimet penale të përfunduara gjatë vitit 2023, rezulton se:


- Gjatë vitit 2023, janë **pezulluar 552 procedime penale** (*në vitin 2022 janë pezulluar 604 procedime*). Kryesisht këto procedime janë pezulluar për mos njohje apo mosidentifikimin e autorit por, edhe për shkak të dërgimit të letërporosive dhe për shkaqe papërgjegjshmërie në pak raste. Veprat penale më të shpeshta për të cilat janë pezulluar hetimet janë për nenet 134, 141/a, 150, 151, 152, 199/a, 278, 284, 287, 293/b, 324/a të K.Penal.
 - *Në vitin 2023 janë pezulluar 552 procedime penale.*
 - *Në vitin 2022 janë pezulluar 604 procedime penale.*
 - *Në vitin 2021 janë pezulluar 401 procedime penale.*
- Janë pushuar ose është paraqitur kërkesë në gjykatë për **pushimin e rreth 566 procedime penale** (*janë pushuar 856 procedime në vitin 2022*), nga këto procedime 120 procedime janë pushuar për shkak të mungesës së faktit, 63 procedime për mungesë provash dhe rreth 373 procedime penale për shkaqe të tjera.
 - *Në vitin 2023 janë pushuar 566 procedime penale.*
 - *Në vitin 2022 janë pushuar 856 procedime penale.*
 - *Në vitin 2021 janë pushuar 428 procedime penale.*
- Në vitin 2023, janë transferuar për kompetencë 36 procedime penale në prokurori të tjera në raport me 34 procedime penale të transferuara në vitin 2022. Nga këto 33 janë transferuar nga Prokuroria Shkodër dhe 3 janë transferuar nga Prokuroria Pukë.
 - *Në vitin 2023 janë transferuar 36 procedime penale.*
 - *Në vitin 2022 janë transferuar 34 procedime penale.*
 - *Në vitin 2021 janë transferuar 20 procedime penale.*
- Gjatë vitit 2022, rezulton se janë dërguar për gjykim **859 procedime penale me 1030 të pandehur** (*në vitin 2022 janë dërguar për gjykim 1053 procedime penale*), janë dërguar për gjykim gjatë këtij viti rreth 194 procedime penale më pak dhe 164 të pandehur më paj se një vit më parë, ose me një rënie prej 18 %.
 - *Në vitin 2023 janë dërguar për gjyq 859 procedime penale.*
 - *Në vitin 2022 janë dërguar për gjyq 1053 procedime penale.*
 - *Në vitin 2021 janë dërguar për gjyq 691 procedime penale.*

VENDIMARRJA GJATE VITIT 2023



- Janë mbartur në hetim **695 procedime penale**. Nga sa më sipër, konstatohet një numër më i vogël i procedimeve penale të mbetura në hetim dhe të mbartura në vitin 2024, në raport me procedimet e përfunduar dhe në raport me procedimet e mbartura. Ky numër është shumë më i vogël se një vit më parë, por në raport edhe me numrin e prokurorëve vlerësojmë se përsëri mbetet relativisht i lartë në raport me numrin e çështjeve të reja në vit dhe ngarkesën e prokurorëve në drejtim të kontrollit të dosjeve dhe realizimit të procedimeve cilësore dhe pa vonesa. Kjo ngarkesë edhe pse më e ulët se një vit më parë, vazhdon të jetë jo optimale dhe për të kanë ndikuar një sërë faktorësh, si nga numri i vogël i prokurorëve në raport me organikën, nga ngarkesa e madhe që kanë me çështje në hetim dhe në gjykim, qoftë të mbartura dhe qoftë të reja, problemet dhe ngarkesa me përfaqësimin në gjykim, problematikat e infrastrukturës, etj, të cilat kanë ndikuar edhe në pamundësinë e kryerjes së veprimeve të shpejta hetimore nga oficerët e policisë gjyqësore dhe përfundimin e një numri akoma më të madh të tyre. Por konstatojmë që trendi u uljes së ngarkesës ka vijuar gjatë vitit 2023 dhe po vijon edhe gjatë muajve të parë të vitit 2024.
- Janë referuar në tërësi në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër **2411 materiale si kallzime penale**, raportime apo për vlerësim juridik. Pjesa më e madhe e referimeve dhe kallzimeve penale për procedimet penale të vitit 2023, i takon përgjithësisht "**Policisë së shtetit**"; Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, Komisarariatit të Policisë Shkodër, Komisarariatit të Policisë Vau Dejës dhe Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe, Komisarariatit të Policisë Pukë, në total janë 1615 materiale referuese që përbën rreth 75 % të kallzimeve penale të kryera nga institucionet. Janë rreth 120 referime nga policitë e tjera.
- Nga funksionarë publikë dhe institucione janë referuar 171 kallzime penale. Nga shtetasit e ndryshëm janë 48 kallzime penale. Rreth 13 referime janë sjelle nga Prokuroria e Përgjithshme. Rreth 57 procedime penale kanë ardhur me transferim nga Prokuroritë e

Rrethve të tjera. Ndërsa 22 materiale kanë ardhur për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.



■ P.Shtetit ■ Pol.Tjera ■ Prok.Pergj ■ Qytetaret ■ I.Publike ■ I.Qendrore ■ SPAK

- Nga ana e shtetasve ka pasur rreth 48 kallëzime të bëra drejtëpërdrejtë në prokurori, të cilat janë regjistruar procedime dhe janë filluar kryesisht nga prokurori. Kallëzimet nga shtetasit, përbëjnë më pak se 2 % të referimeve të bëra, por duhet thënë se një numër i madh kallëzime janë paraqitur nga ana shtetasve para policisë gjyqësore. Ndërsa 58 janë referime dhe kallëzime të bëra para oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve në Prokurori. Ndërsa 15 raste janë ti filluara kryesisht nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Gjithashtu, ka referime nga institucione të tjera si Bashkitë kryesisht nga Inspektoriatet e Mbrojtjes së Territorit me 53 kallëzime penale, kryesisht në lidhje me veprën penal të parashikuar nga neni 199/a të K.Penal, apo në rastet e cënimit të kompetencave apo veprimtarisë së organeve të tyre. Referime në një përqindje më të vogël janë bërë edhe nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave apo Agjensia e Mbikqyerjes Policore me 26 referime, Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve ka paraqitur 7 referime, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve 6 kallëzime, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqësore Dega Shkodër 8 kallëzime penale, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër 3 kallëzime penale, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoritë e saj, Drejtoria e Hetimit Tatimor, si dhe Drejtoria e Doganave, Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Shkodër, etj.

❖ **Mosfillimet e procedimeve penale dhe raportimet gjatë vitit 2023.**

Nga studimi i të dhënave statistikore, rezulton se gjatë vitit 2023 janë administruar **2420 materiale referuese** apo kallëzuese, ku 1969 janë regjistruar si kallëzime penale nga Prokuroria Shkodër dhe 42 kallëzime janë regjistruar nga Prokuroria Pukë dhe 9 kallëzime të mbartura nga fundi i vitit 2022 dhe të përfunduara në vitin 2023. Ndërsa 400 janë regjistruar si raportime. Pjesa e madhe e kallëzimeve penale janë regjistruar si procedime penale.

Gjithashtu janë administruar edhe materiale të tjera të dërguara për vlerësim ku për rreth **400 materiale të raportuara** është vendosur arshivimi i tyre (në raport me 352 raportime në vitin 2022, kjo sipas parashikimeve të Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr.15, datë 30.10.2020, “Për trajtimin e njoftimeve nga viktime akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementët e vepres penale”, të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me nr.1460 prot, datë 30.09.2020. Gjithashtu, në rreth 20 raste është vendosur kthimi i materialeve për plotësim me qëllim plotësimin e verifikimeve dhe paraqitjen e materialeve sipas modeleve raportim për marrjen dijeni të faktit dhe raportim për marrjen dijeni të vepres penale sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Ku në vijim materialet janë ri-dërguar për raportim apo janë paraqitur si kallëzime penale për vepra të tjera penale.

Gjatë vitit 2023 ka pasur një përmirësim në numrin dhe cilësinë e rasteve të raportimeve krahasuar me një vit më parë, pasi edhe numri i rasteve të kthimit të materialeve për plotësim është përgjysmuar. Nga ana tjetër, vlerësojmë se nevojitet nxitje më e madhe dhe trajnime të policisë gjyqësore në lidhje me zbatimin e parashikimeve nënligjore për raportimet e fakteve dhe të kallëzime penale që ndiqen sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, pasi rezulton se vijojnë të referohen materiale nga policia gjyqësore “Për vlerësim” dhe për vepra penale që ndiqen sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, pa ndjekur procedurat dhe modelet e raportimeve sipas Udhëzimit të Përgjithshëm dhe Memorandumit të Mirëkuptimit.

Gjatë vitit 2023, është vendosur mosfillimi për **365 materiale kallzuese** apo të referuara nga të cilat **356 janë mosfillime** në lidhje me kallzimet e referuara në vitin 2023 dhe 9 mosfillime lidhen me kallzime të referuara në vitin 2022, por që vendimi është marrë në vitin 2023. Nga këto 339 janë mosfilluar si materiale të paraqitura në Prokurorinë Shkodër, ku 27 referime janë për vlerësim juridik pa një veper penale konkrete dhe 17 raste janë të mosfilluara nga Prokuroria Pukë. Mosfillimet e këtij viti janë më shumë se mosfillimet e marra gjatë vitit 2022 (gjatë vitit 2022 janë mosfilluar 287 materiale referuese) me një rritje prej 24 %.

Nga këto materiale, rastet më të shpeshta kur është vendosur mosfillimi i procedimit penal lidhen me veprat penale si:

- për veprën penale “Kanosje” neni 84 i K.Penal, në 11 raste, të referuara edhe në lidhje me vepra të tjera penale;
- për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje” neni 89 i K.Penal, në 5 raste;
- për veprën penale “Dëmtime të tjera me dashje” neni 90 i K.Penal, në 4 raste;
- për veprën penale të “Fyerjes” neni 119 i K.Penal, në 2 raste;
- për veprën penale “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”, parashikuar nga neni 121 të K.Penal, në 3 raste;
- për veprën penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a të K.Penal, në 3 raste;
- për veprën penale “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134 të K.Penal, në 3 raste;

- për vepren penale “Mashtrim”, parashikuar nga neni 143 të K.Penal, në 3 raste;
- për vepren penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 të K.Penal, në 8 raste;
- për vepren penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr” neni 151 i K.Penal, në 13 raste;
- për vepren penale “Punësimi i paligjshëm” neni 170/a i K.Penal, në 10 raste;
- për vepren penale “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë” neni 178 i K.Penal, në 4 raste;
- për vepren penale “Fshehje e të ardhurave” neni 180 i K.Penal, në 5 raste;
- për vepren penale “Moslëshimi i kuponit tatimor” neni 180/a i K.Penal, në 6 raste;
- për vepren penale “Falsifikimi i dokumenteve”, neni 186 të K.Penal, në 8 raste;
- për vepren penale “Falsifikimi kompjuterik”, neni 186/a të K.Penal, në 4 raste;
- për vepren penale “Shpërdorimi i tokës”, neni 199 i K.Penal, në 7 raste;
- për vepren penale “Ndërtimi i paligjshëm”, neni 199/a i K.Penal, në 16 raste;
- për vepren penale “Pushtimi i tokës” neni 200 i K.Penal, në 3 raste;
- për vepren penale “Prerje e paligjshme e pyjeve”, neni 205 i K.Penal, në 23 raste;
- për vepren penale “Shpërdorimi i detyrës”, neni 248 i K.Penal, në 20 raste;
- për vepren penale “Prishja e qetësisë publike”, neni 274 i K.Penal, në 3 raste;
- për vepren penale “Vetëgjyqësia”, neni 277 i K.Penal, në 5 raste;
- për vepren penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, neni 283 i K.Penal, në 13 raste;
- për vepren penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, neni 284 i K.Penal, në 5 raste;
- për vepren penale “Shkelje e regullave të qarkullimit rrugor”, neni 290 i K.Penal, në **88 raste**, ku në shumicën dërmuese bëhet fjalë për aksidente pa pasoja në njerëz ose me pasoja të lehta dhe jo nga ato që kërkon domosdoshmërisht dispozita penale.
- për vepren penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, neni 291 i K.Penal, në 4 raste.
- për vepren penale “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, neni 293/b i K.Penal, në 6 raste.
- për vepren penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, neni 320 i K.Penal, në 6 raste.
- për vepren penale “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, neni 324/a i K.Penal, në 3 raste.

Vepra penale për të cilën është marrë më shpesh vendimi i mosfillimit është “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 të K.Penal, me 88 vendime mosfillimi.

Gjithashtu, ka pasur vendime mosfillimi edhe për kallëzime që lidhen me vepra të tjera penale në një numër më të vogël 1-2 raste, duke argumentuar mungesën e elementëve të vepres penale konkrete apo dyshimeve për to.

Fakti që ka pasur një rritje të vendime të mosfillimit, tregon për analizimin në kohë nga ana e prokurorëve të akteve dhe provave të administruara dhe mundësinë e vlerësimit të tyre në afatin 15 ditor. Një rritje të lartë e përbën rastet e aksidenteve rrugore ku gjatë këtij viti janë mosfilluar 88 kallzime që lidhen me mungesën e pasojës që kërkon dispozita penale konkrete.

Nga këto vendime mosfillimi një pjesë e vogël e tyre është ankimuar nga palët në gjykatë rreth 14 raste ku rezulton se në **2 raste**, Gjykata ka marrë vendim për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit dhe urdhërimin e prokurorisë të rregjistrojë procedim penal dhe të kryejë hetime. Në këto raste, prokurori ka bërë ankim ose në rastet kur ka vlerësuar se nuk ka vend për të bërë ankim ka rregjistruar procedim penal dhe vijuar me hetimet sipas urdhërimeve në vendimet e gjykatës.

❖ Sipas ngarkesës dhe vendimarrjes së prokurorëve mosfillimet të marra në vitin 2023 dhe të mbartura, janë ndarë si më poshtë:

Prokurori	Mosfilluar
Ndriçim Halilaj	54
Pierind Çukaj	47 (30+17)
Shqiponja Milla	42
Besmira Vishe	37
Blerta Hamza	32
Entela Hasmujaj	32
Albulena Kuliçi	28
Albert Murçaj	22
Ledion Tema	16
Franceska Lekani	15
Gezim Spahiu	15
Adnan Hoxha	15
Marsida Frashëri	6
Vate Staka	4

❖ Procedimet penale të pezulluara gjatë vitit 2023.

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, gjatë vitit 2023, është marrë vendim për **pezullimin e procedimit penal** (kryesisht për mosnjohje autori, si dhe në disa raste shkak të gjendjes shëndetësore/mendore të personit nën hetim) për **552 procedime penale**, që përbëjnë rreth **21.4 %** të procedimeve penale të përfunduara.



Procedimet penale të pezulluara në vitin 2023, në krahasim me numrin e rasteve të pezulluara në vitin 2022 është më i vogël (604 procedime në vitin 2022), që përbën një ulje me 52 procedime penale më pak apo me një rënie prej 8.6 %.

- **Në vitin 2022 janë pezulluar 552 procedime penale.**
- Në vitin 2022 janë pezulluar 604 procedime penale.
- Në vitin 2021 janë pezulluar 401 procedime penale.
- Në vitin 2020 janë pezulluar 267 procedime penale.
- Në vitin 2019 janë pezulluar 335 procedime penale.

Nga këto procedime, rastet kur është vendosur pezullimi e përbëjnë në pjesën më të madhe procedimet penale për veprat penale, si më poshtë:

- për vepren penale “Vrasje me paramendim” parashikuar nga neni 78 i K.Penal, në 10 raste;
- për vepren penale “Kanosja” parashikuar nga neni 84 i K.Penal, në 7 raste;
- për vepren penale “Vjedhje” parashikuar nga neni 134 i K.Penal, në 143 raste;
- për vepren penale “Vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i K.Penal, në 6 raste;
- për vepren penale “Vjedhje me armë”, parashikuar nga neni 140 i K.Penal, në 5 raste;
- për vepren penale “Trafikimi i mjeteve motorrike”, parashikuar nga neni 141/a i K.Penal, në 12 raste;
- për vepren penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i K.Penal, në 8 raste;

- për vepren penale “Mashtrimi kompjuterik”, parashikuar nga neni 143 i K.Penal, në 5 raste;
- për vepren penale “Shkatërrimi i pronës me dashje”, parashikuar nga neni 150 i K.Penal, në 9 raste;
- për vepren penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i K.Penal, në 35 raste;
- për vepren penale “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, parashikuar nga neni 152 i K.Penal, në 12 raste;
- për vepren penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K.Penal, në 6 raste;
- për vepren penale “Falsifikimi kompjuterik”, parashikuar nga neni 186/a i K.Penal, në 5 raste;
- për vepren penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i K.Penal, në 8 raste;
- për vepren penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” parashikuar nga neni 205 i K.Penal, në 5 raste;
- për vepren penale “Largimi nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i K.Penal, në 8 raste;
- për vepren penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 275 i K.Penal, në 18 raste;
- për vepren penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i K.Penal, në 9 raste;
- për vepren penale “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a i K.Penal, në 5 raste;
- për vepren penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i K.Penal, në 166 raste;
- për vepren penale “Pastrimi i produkteve të vepres penale ose të veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në 7 raste;
- për vepren penale “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, parashikuar nga neni 293/b i K.Penal, në 9 raste;
- për vepren penale “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, parashikuar nga neni 293/b i K.Penal, në 7 raste;

Vepra penale për të cilën është marrë më shpesh vendimi i pezullimit është vepra penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i K.Penal, me 166 vendime pezullimit.

Pezullimi është vendosur edhe për vepra të tjera penale, por në numër procedimesh më të pakta. Mungesa e identifikimit të autorëve ka ardhur për arsye të ndryshme, dërgimi i letërporosive për jashtë shteti, si nga veprimet e para hetimore të kryera me vonesë, largësia dhe pozicioni gjeografik i vendit të ngjarjes, si rastet e vjedhjeve apo kultivimit të bimëve

narkotike në zona të thella malore, janë faktorë që kanë ndikuar në marrjen e vendimit të pezullimit. Gjithashtu, ka ndikuar edhe cilësia jo e mirë e hetimeve të kryera dhe mungesa e një bashkëpunimi të mirë dhe të shpejtë me përfaqësues të organeve lokale dhe me banorë të zonës, etj.

Për veprat penale të parashikuara nga nenet 134 dhe 284 të K.Penal, janë veprat për të cilat janë pezulluar më shumti procedimet penale, ku duhet thënë se evidentohen mangësi në hetimin e tyre që në veprimet e para hetimore, si dhe në vijimësi në kryerjen e veprimeve periodike dhe këmbëngulëse në identifikimin e autorëve dhe evidentimin e provave të fajësisë së këtyre autorëve.

Vlerësojmë se duhet të vijojnë nxitja dhe kërkimi i rritjes së cilësisë hetimore dhe gjurmuese nga ana e policisë gjyqësore, si dhe rritja e bashkëpunimit me aktorët dhe institucionet e tjera ligjzbatuese me qëllim uljen e numrit të procedimeve penale të pezulluara dhe nga ana tjetër, rifillimin dhe hetimin e procedimeve penale të pezulluar në vitet e mëparshme duke bërë identifikimin e autorëve të vepra penale dhe procedimeve penale të pezulluara, me qëllim ngritjen e akuzës dhe dërgimin në gjyq të autorëve para përfundimit të afateve ligjore të parashkrimit të ndjekjes penale. Kjo do të shërbejë jo vetëm rritjen së efikasitetit të ndjekjes penale, por edhe rritjen e luftës kundër kriminalitetit dhe të parandalimit të kryerjes së këtyre veprave penale në të ardhmen.

❖ **Procedimet penale të pushuara gjatë vitit 2023.**

Gjatë vitit 2023, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është vendosur ose është kërkuar në gjykatë **pushimi i procedimit penal** për **566 procedime penale**, që përbëjnë rreth 22 % të procedimeve penale të përfunduara gjatë vitit, të cilat në krahasim me numrin e rasteve të pushuara në vitin 2022 janë 290 procedime penale më pak se një vit më parë (në vitin 2022 janë 856 procedime penale), me një rënie prej 33 %.


- **Në vitin 2023 janë pushuar 566 procedime penale;**
- Në vitin 2022 janë pushuar 856 procedime penale;
- Në vitin 2021 janë pushuar 428 procedime penale;
- Në vitin 2020 janë pushuar 480 procedime penale;
- Në vitin 2019 janë pushuar 496 procedime penale;

Nga këto procedime penale, rastet kur është vendosur pushimi ose kur është kërkuar pushimi i çështjes apo akuzës në gjykatë për mugesë fakti e përbëjnë 120 procedime penale. Ndërsa në 63 procedime penale është kërkuar pushimi i çështjes për mungesë prove dhe në 383 procedime penale të tjera është kërkuar pushimi i çështjes për shkaqe të tjera nga ato të parashikuara nga neni 328 të K.Pr.Penale.

Nga pushimet e vitit 2023, rezulton se 79 procedime penale janë me vendim pushimi të prokurorit në lidhje me kundravajtje penale, kryesisht për nenet 84, 89, 90, 200, 204, 205, 272, 277, 297, 320, 321, etj të Kodit Penal.

Gjithashtu edhe për 27 raste të tjera janë marrë vendime pushimi në rastet e zbatimit të masave të shmangies nga ndjekja penale për të miturit në konflikt me ligjin për vepra të ndryshme penale, e cila ka një rritje të rasteve në raport me një vit më parë (në vitin 2022 ka pasur 18 vendime dhe masa shmangiet për të miturit në konflikt me ligjin).

ÇËSHITJE TË PUSHUARA NË VITE



Ndërsa 460 procedime penale janë me kërkesë të prokurorit të paraqitur në gjykatë për pushimin e çështjes. Nga tërësia e kërkesave të dërguara në gjykatë gjatë vitit 2023 dhe të shqyrtuara gjatë vitit 2023, rezulton se janë shqyrtuar në total 490 kërkesa për pushimin e çështjes apo akuzës për 123 persona nën hetim. Nga këto çështje ka përfunduar gjykimi për 430 kërkesa, ku janë pranuar 392 kërkesa për pushimin e procedimeve penale nga gjykata duke vendosur pushimin e çështjes që përbëjnë rreth 91 % të kërkesave të shqyrtuara. Në rreth 38 raste gjykata nuk ka pranuar kërkesën duke e kthyer çështjen për hetime, të cilat përbëjnë rreth 9 % të kërkesave të paraqitura dhe refuzuara për pushimin e çështjes.

Në lidhje me këto raste, prokurorët me administrimin e vendimit të arsyetuar kanë vlerësuar nëse ka vend për të ushtruar ankim, apo arsyetimi i gjykatës qëndron plotësisht dhe nuk ka vend për ankim, por për vijimin e hetimeve sipas urdhërimeve të gjykatës.

Gjithashtu, janë edhe **557 procedime penale** të pezulluara në vite për shkaqe të ndryshme dhe që janë rifilluar gjatë këtij viti, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe shkaqe të tjera ligjore. Nga këto **532 procedime penale të rifilluara** janë dërguar me kërkesë në gjykatë për pushimin e çështjes dhe **25 procedime penale** janë pushuar me vendim të Prokurorit duke qenë për vepra që përbëjnë kundravajtje penale.

❖ Përsa i përket llojit të veprave penale për të cilat është vendosur ose është kërkuar më shumë raste pushimi i çështjes janë si më poshtë:

- për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, në 10 raste, pushime që kanë ardhur si pasojë e vlerësimit se fakti i kallëzuar nuk përbën veprën penale, etj;
- për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, në 6 raste, pushime që kanë ardhur si pasojë e mungesës së pasojës, tërheqjes apo heqjes dorë nga ankimi, mungesës së provave të plota të autorësisë, etj;
- për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, në 13 raste, ku pjesa më e madhe e tyre ka rezultuar se vetëvrasja apo tentativa e vetëvrasjes ka ndodhur për

shkaqe personale të viktimës (shëndetit mendor, depresionit, etj) dhe nuk lidhet me veprime apo sjellje sistematike të dhunshme të ndonjë personi të tretë;

- për vepren penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, në 6 raste, ku rezulton se kryesisht lidhte me mungesën e provave që mbështesin kallëzimin penal, apo veprimet e kallëzuara nuk përbëjnë përndjekje në kuptimin penal;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, në 17 raste, ku rezulton se kryesisht lidhte me mungesën e provave që mbështesin kallëzimin penal, fakti nuk lidhet me subjektet e parashikuar nga ligji apo veprimet e kallëzuara nuk përbëjnë dhunë në kuptimin penal;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, në 10 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal, në 7 raste, pasi nuk është bërë e mundur të provohet vjedhja e energjisë elektrike, kjo edhe për shkak të procedurave jo korrekte nga ana e punonjësve të OSHEE dhe problematikave të tjera në lidhje me abonentët, aparatet matëse apo linjat, etj;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, në 11 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, në 13 raste, kjo lidhet me faktin se në një pjesë të rasteve ka rezultuar konflikt apo mosmarrëveshje juridiko-civil dhe jo veper penale;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal, në 6 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, në 9 raste, ku në shumicën e rasteve ka rezultuar se mungon pasoja e kërkuar nga ligji apo fakti nuk përbën veper penale;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal, në 11 raste, ku në shumicën e rasteve ka rezultuar ngjarje aksidentale nga problematikat e vetë objektit të djegur;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, në 8 raste, ku në shumicën e rasteve nuk janë ndjekur procedurat e duhura tatimore dhe procedurale duke bërë kallëzime penale për shkelje që parashikohen si shkelje administrative nga legjislativi tatimor;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 180/a i Kodit Penal, në 6 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal, në 6 raste, ku në shumicën e rasteve nuk janë ndjekur procedurat e duhura tatimore dhe procedurale duke bërë kallëzime penale për shkelje që parashikohen si shkelje administrative nga legjislativi tatimor;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në 19 raste, ku një pjesë e këtyre rasteve lidhet me akte dhe dokumente për të cilat është parashikuar ndjekja penale;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në 6 raste;

Vepra penale për të cilën është paraqitur më shpesh kërkesë për pushimin e çështjes në gjykatë është vepra penale e “Shpërdorimit të detyrës” e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në 44 kërkesa për pushim.

Nga sa më sipër rezulton se pushimet e hetimeve apo kërkesa për pushimin e hetimeve kanë ardhur për shumë faktorë. Kërkesa për pushimin e hetimeve për veprat penale të parashikuara nga nenet 84, 89, 99, 130/a, 180, 180/a, 181, 199/a, 248, 287, etj, duhet të vlerësohet në tërësi nga gjithë zinxhiri hetimor, me qëllim shmangien e kallëzimeve të paplota, të pabaza, si dhe nga ana tjetër, kryerjen e hetimeve më të thelluara dhe më të plota në drejtim të evidentimit të elementëve të vepres penale dhe provave të sakta dhe të plota që provojnë qoftë veprën penale ashtu edhe individualizimin e autorëve të këtyre veprave penale dhe të përgjegjësisë penale të tyre.

❖ **Procedimet penale për të cilat është vendosur moskompetenca gjatë vitit 2023.**

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, gjatë vitit 2023, janë marrë vendime për shpalljen e moskompetencës lëndore ose tokësore dhe kalimi i akteve në prokurorinë kompetente për **36 procedime penale** të cilat janë më shumë në vitin 2022 me 34 procedime penale të transferuara.

Këto vendime janë marrë për vepra të ndryshme penale kryesisht si më poshtë:

- 1 procedim penal për nenin 78/1 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 130/a/1 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 134/2 të K.Penal;
- 4 procedime penale për nenin 141/a të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 143 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 144/a të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 145 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 150 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 172/1 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 181 të K.Penal;
- 1 procedime penale për nenin 186/1 të K.Penal;
- 2 procedime penale për nenin 189/1 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 190 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 199/a të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 236/1 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 245 të K.Penal;
- 4 procedime penale për nenin 248 të K.Penal;

- 1 procedim penal për nenin 258/1 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 278/1 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 283/a të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 284 të K.Penal;
- 4 procedime penale për nenin 287 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 297 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 318 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 323 të K.Penal;
- 1 procedim penal për nenin 328 të K.Penal;

Procedimet e dërguara për kompetencë janë kryesisht në lidhje me përcaktimin e saktë të kompetencës territoriale, ose në rastet e kompetencës lëndore janë procedimet e dërguara për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në rastet e veprave penale të parashikuara nga nenet 248, 258/1, 287, 328, etj, të Kodit Penal.

❖ **Procedimet penale të bashkuara dhe të ndara gjatë vitit 2023.**

- Gjatë vitit 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, janë marrë vendime për bashkimin e procedimeve penale në përputhje me parashikimet e neneve 79 e vijues të K.Pr.Penale, të ndodhura tek një prokuror apo në prokuror të ndryshëm. Në këto raste janë marrë **100 vendime për bashkimin e procedimeve** për dy ose më shumë procedime, sipas rastit, për vepra të ndryshme penale, kjo në varësi të subjektit apo lidhjes së tyre nëpërmjet provave të procedimit penal tjetër, etj. Ka një ulje të vendimeve të bashkimit në raport me një vit më parë (në vitin 2022 ka pasur 161 vendime bashkimi procedimesh penale).
- Këto vendime sipas rastit janë marrë nga prokurori i çështjes ose nga drejtuesi i prokurorisë, në varësi të prokurorëve që kanë pasur procedimet për tu bashkuar. Kryesisht rastet e procedimeve të bashkuara lidhen me veprat penale të parashikuara nga nenet 134, 135, 137, 199/a, 248, etj, të K.Penal, në rastin e zbulimit të autorëve të disa vjedhjeve apo në rastet e disa referimeve nga institucione të ndryshme për të njëjtin objekt apo ndërtime të paligjshëm, etj.
- Gjithashtu, gjatë vitit 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, janë marrë vendime për ndarjen e procedimeve penale në përputhje me parashikimet e neneve 93 e vijues të K.Pr.Penale, të ndodhura tek një prokuror duke vlerësuar rrethanat e çështjes. Në këto raste janë marrë **19 vendime për ndarjen e procedimeve penale** në dy ose më shumë procedime penale më vehte, sipas rastit, për vepra të ndryshme penale, ku një procedim është përfunduar duke u dërguar për gjykim apo me kërkesë për pushim, ndërsa për procedimin penal tjetër kanë vijuar hetimet. Ka një ulje të ndjeshme edhe të çështjeve për të cilat janë marrë vendim ndarje gjatë këtij viti në raport me vitin 2022 (ku gjatë vitit 2022 janë marrë 63 vendime ndarje procedimesh).

❖ **Procedimet penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2023.**

Gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka dërguar për gjykim **859 procedime penale me 1030 të pandehur**, nga të cilët 121 të pandehur kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”.

Nga këto procedime, rezulton se nga Prokuroria Pukë janë dërguar për gjykim **18 procedime penale me 30 të pandehur**, nga të cilët 7 të pandehur kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”. Ndërsa nga Prokuroria Shkodër, janë dërguar për gjykim **841 procedime penale me 1000 të pandehur**, nga të cilët 114 të pandehur kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”.



- **Në vitin 2023 janë dërguar për gjykim 841 procedime penale;**
- Në vitin 2022 janë dërguar për gjykim 1053 procedime penale;
- Në vitin 2021 janë dërguar për gjykim 691 procedime penale;
- Në vitin 2020 janë dërguar për gjykim 754 procedime penale;
- Në vitin 2019 janë dërguar për gjykim 704 procedime penale;

Procedimet penale të dërguara për gjykim përbëjnë rreth 33 % e procedimeve penale të përfunduara gjatë vitit, të cilat në krahasim me numrin e rasteve të dërguara për gjykim në vitin 2022 janë 212 procedime penale më pak se një vit më parë ose me një rënie prej 20 %. Por mbetet një numër i lartë në raport me vitet 2019-2021.

Efiçenca e prokurorisë, pra raporti mes dosjeve të dërguara për gjykim me ato të pushuara që është, të dërguara për gjykim 841 kundrejt 566 të pushuara ose 1.48. Është më i lartë në raport me një vit më parë që ka qenë 1.2.

- ❖ **Në raport me veprat penale, shpeshësinë e tyre, për të cilat procedimet penale janë dërguar për gjykim, janë si më poshtë:**

- 2 procedime penale, me 10 të pandehur, janë dërguar për gjykim për vepren penale të parashikuar nga neni 76 të Kodit Penal;
- 2 procedime penale, me 2 të pandehur, janë dërguar për gjykim për vepren penale të parashikuar nga neni 78/1 të Kodit Penal;
- 4 procedime penale, me 4 të pandehur, janë dërguar për gjykim për vepren penale të parashikuar nga neni 88 të Kodit Penal;
- 11 procedime penale, me 14 të pandehur, janë dërguar për gjykim për vepren penale të parashikuar nga neni 89 të Kodit Penal;
- 4 procedime penale, me 4 të pandehur, janë dërguar për gjykim për vepren penale të parashikuar nga nenet 126 të Kodit Penal;
- 47 procedime penale, me 47 të pandehur, janë dërguar për gjykim për vepren penale të parashikuar nga neni 130/a të Kodit Penal, ku pjesa më e madhe janë dërguar për paragrafin e katërt të këtij neni;
- 17 procedime penale me 23 të pandehur janë dërguar në gjykim për vepren penale të parashikuar nga neni 134 të Kodit Penal;
- 46 procedime penale me 47 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 137 të Kodit Penal;
- 4 procedime penale me 5 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 141/a të Kodit Penal;
- 12 procedime penale me 16 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 143 të Kodit Penal;
- 10 procedime penale me 10 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 145 të Kodit Penal;
- 12 procedime penale me 12 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 159/1 të Kodit Penal;
- 5 procedime penale me 6 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 178 të Kodit Penal;
- 7 procedime penale me 7 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 179/a të Kodit Penal;
- 11 procedime penale me 17 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 186 të Kodit Penal;
- 4 procedime penale me 4 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 189 të Kodit Penal;
- 6 procedime penale me 6 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 197 të Kodit Penal;
- 117 procedime penale me 121 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me vepren penale të parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal;

- 6 procedime penale me 7 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 236 të Kodit Penal;
- 5 procedime penale me 6 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 237 të Kodit Penal;
- 7 procedime penale me 9 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 242 të Kodit Penal;
- 14 procedime penale me 51 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal;
- 8 procedime penale me 18 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 274 të Kodit Penal;
- 10 procedime penale me 11 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 277 të Kodit Penal;
- 19 procedime penale me 22 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 278 të Kodit Penal;
- 7 procedime penale me 7 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 279 të Kodit Penal;
- 4 procedime penale me 4 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 280 të Kodit Penal;
- 28 procedime penale me 56 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 283 të Kodit Penal;
- 6 procedime penale me 11 të pandehur janë dërguar për gjykim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 283/a të Kodit Penal;
- 3 procedime penale me 3 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a të K.Penal.
- 18 procedime penale me 26 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 284 të K.Penal.
- 1 procedim penal me 2 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të K.Penal.
- 16 procedime penale me 16 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 290 të K.Penal.
- 268 procedime penale me 268 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 291 të K.Penal.
- 17 procedime penale me 17 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 297 të K.Penal.
- 7 procedime penale me 8 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 298 të K.Penal.

- 5 procedim penal me 5 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 305 të K.Penal.
- 5 procedim penal me 6 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 305/b të K.Penal.
- 8 procedim penal me 8 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 323 të K.Penal.
- 12 procedim penal me 14 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 324/a të K.Penal.
- 1 procedim penal me 10 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 327/a të K.Penal.

Vepra penale e dërguar më shpesh në gjykim është vepra penale e “Drejtimin të mjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 të K.Penal, me 268 procedime penale dhe 268 persona të pandehur.

❖ **Procedimet Penale sipas Kodit Penal Ushtarak për vitin 2023.**

- Gjatë vitit 2023, rezulton se janë referuar 3 (tre) kallëzime penale në lidhje me veprat penale sipas Kodit Penal Ushtarak, të gjitha nga Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau Dejës. Këto kallëzime janë trajtuar me përparësi duke u rregjistruar si procedime penal në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 36/1 (2 raste) dhe 37/1 (një rast) të Kodit Penal Ushtarak. Në vijim janë kryer hetime të shpejta dhe në vijimësi dhe të tre procedimet penale janë dërguar për gjykim me 4 persona të marrë të pandehur.
- Gjithashtu janë rifilluar edhe disa procedime të tjera penale për vepra të ndryshme penale, por kryesisht për shkaqe të parashkrimit të ndjekjes penale dhe janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e procedimit për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Të cilat janë miratuar nga gjykata.

❖ **Vlerësimet e arresteve, ndalimeve dhe caktimet e masave të sigurimit gjatë vitit 2023.**

- Nga ana e policisë gjyqësore, gjatë gjithë vitit 2023, janë kryer 238 arrestime në flagrancë dhe ndalime me iniciativë apo me urdhër ndalimi të Prokurorit (në vitin 2022 kanë qenë 179). Nga këto 199 janë arrestime në flagrancë dhe 15 janë ndalime me iniciativë dhe 24 janë ndalime në zbatim të urdhërit të prokurorit. Ndërkohë janë nxjerrë **48 urdhëra ndalimi** nga prokurorët, nga të cilat 22 janë ekzekutuar, ndërsa pjesa tjetër ose nuk janë ekzekutuar në kohë ose në vijim është paraqitur kërkesë për caktim mase sigurimi duke humbur fuqinë urdhëri i ndalimit.
- Gjithashtu, ka pasur arreste dhe ndalime edhe për procedime të mbartura nga vitet e mëparshme dhe ekzekutime të vendimeve penale të formës së prerë në lidhje me procedime penale në hetim apo në gjykim të rregjistruara në vitet e mëparshme në total janë dhënë 298 masa sigurimi apo ndaluese dhe mjekësore.

- Gjithashtu, janë paraqitur edhe **42 kërkesa për caktim mase sigurimi në mungesë të personit nën hetim**. Gjithashtu janë gjykuar edhe **26 kërkesa për verifikimin e zbatimit të kushteve të masës së sigurimit** parashikuar nga neni 248 të K.Pr.Penale.
- Nga këto 199 janë arrestime në flagrancë, ndërsa 15 janë ndalimet me iniciativë. Rreth 22 urdhëra ndalimesh të prokurorëve janë ekzekutuar në vijimësi, ndërsa vijnë pa ekzekutuar 12 urdhëra ndalimi.
- Në **4 raste** është vlerësuar arresti në flagrancë apo ndalimi i paligjshëm nga ana e vetë Prokurorit duke urdhëruar **lirimin e menjëhershëm** të të arrestuarit apo të ndaluarit.
- Nga 219 arrestime në flagrancë apo ndalime të dërguara në gjykatë, nga ana e gjykatës në 213 raste i ka vlerësuar arrestimet e ligjshme ndërsa në 6 raste i ka vlerësuar arrestimet e paligjshme. Në këto raste është bërë ankim nga ana e prokurorit të çështjes dhe në gjysmën e tyre Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e prokurorit, ndërsa në pjesën tjetër ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës për vlerësimin e paligjshëm të arrestit apo të ndalimit.
- Në të gjitha rastet e mësipërme janë dërguar kërkesat në gjykatë për caktimin edhe të masës së sigurimit. Ku në 118 raste është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg”. Në një rast është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg me afat”. Në 42 raste është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, në 73 raste është kërkuar masa e sigurimit “Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”, në 12 raste masa e sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shteti” e cila është kërkuar përgjithësisht në lidhje me një masë tjetër sigurimi, dhe më rradhë masat e tjera të sigurimit. Gjithashtu janë kërkuar edhe 6 raste masa mjekësore e parashikuar nga neni 239 të K.Pr.Penale.
- Në lidhje me kërkesat për caktim masash sigurimi nga ana e Prokurorisë, Gjykata e e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka vendosur në 81 raste masën e sigurimit “arrest në burg”, në 4 raste ka vendosur arrest me burg me afat. Në 21 raste ka vendosur masën e sigurimit arrest në burg në mungesë. Në 50 raste ka vendosur masën e sigurimit “arrest në shtëpi”. Në 1 rast ka vendosur masën e sigurimit “Garanci pasurore”, më vehte ose edhe të lidhur me një masë tjetër sigurimi. Në 93 raste ka vendosur masën e sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore. Masat e tjera të sigurimit janë vendosur në lidhje dhe së bashku me masat e mësipërme të sigurimit, si në rastin e masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shteti” të parashikuar nga neni 233 të K.Pr.Penale.
- Në të gjitha rastet kur ka vendosur paligjshmërinë e arrestit në flagrancë, apo të ndalimit (në 6 raste), si dhe në rastet e caktimit të një mase sigurimi më të lehtë se ajo e kërkuar nga prokurori është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit, ku janë ushtruar rreth 25 raste ankimesh për vleftësimin e arrestit apo ndalimit dhe në lidhje me llojin e masës së sigurimit. Këto kërkesa pjesërisht janë mbështetur nga Gjykata e Apelit, e cila nga çështjet e shqyrtuara në rreth 8 raste ka pranuar ankimin e prokurorit ndërsa në 10 raste nuk është pranuar ankimi dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

❖ **Masat e sigurimit arrest në burg janë kërkuar për vepra të rënda penale si më poshtë:**

- për veprën penale të parashikuar nga neni 76 të K.Penal në 4 raste;
- për veprën penale të parashikuar nga neni 79/a të K.Penal në 1 rast;

- për vepren penale të parashikuar nga neni 84 të K.Penal në 2 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 100/1 të K.Penal në 1 rast;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 121/a të K.Penal në 2 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 130/a të K.Penal në 29 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 134 të K.Penal në 4 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 135 të K.Penal në 1 rast;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 139 të K.Penal në 1 rast;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 143 të K.Penal në 2 raste;
- për vepren penale tëparashikuar nga neni 278 të K.Penal në 9 raste;
- për vepren penale tëparashikuar nga neni 279 të K.Penal në 1 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 283 të K.Penal në 21 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 283/a të K.Penal në 2 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 284 të K.Penal në 19 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 290 të K.Penal në 5 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 291 të K.Penal në 3 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 298 të K.Penal në 2 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 323 të K.Penal në 4 raste;
- për vepren penale të parashikuar nga neni 324/a të K.Penal në 1 raste;

Masa e sigurimit “Arrest në burg” është kërkuar më rradhë edhe në vepra të tjera penale. Vlen për tu theksuar se në veçanti në lidhje me masën arrest në burg, në ato raste që nuk është pranuar nga gjykata rreth 27 (njëzet e shtatë) raste, pothuajse në të gjitha rastet është ushtruar ankim nga prokurori i çështjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në disa prej tyre kemi gjetur mbështetjen e Prokurorisë së Apelit dhe të Gjykatës së Apelit duke pranuar ankimit dhe ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm duke caktuar masën e sigurimit “Arrest në burg” për të dyshuarit e veprave penale konkrete.

❖ **ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SHKALLËS PARË SHKODËR.**

- o Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe dënimin e të pandehurve;
- o Të dhëna për gjykimet e posaçme;
- o Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve/ kërkesa e prokurorit dhe vendimet e gjykatës;

- Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit, si gjinia, mosha, arsimi, punësimi, etj;
- Të dhëna për të pandehurit e mitur, numri i procedimeve të regjistruara, numri i procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të mitur të regjistruar, të dërguar për gjykim, të dënuar, numër procedimesh regjistruar, masa sigurimi e denime të zbatuara, denime alternative, etj;
- Të dhëna për pasojat e veprave penale.

❖ Treguesi i efektivitetit të procedimeve penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2023:

- Gjatë vitit 2023, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, janë përfaqësuar në gjyq 1985 kërkesa dhe çështje të ndryshme penale. Ndërsa janë gjykuar **1406 çështje penale themeli me 1689 të pandehur**. Nga këto **45 çështje themeli me 63 të pandehur** kanë qenë çështje të Prokurorisë Pukë.
- Nga këto rezulton se 547 çështje penale me 659 të pandehur, nga të cilët 85 me masë sigurimi arrest në burg janë mbartur në gjykim nga një vit më parë. Nga këto, 27 çështje me 33 të pandehur, nga të cilët 15 me masë sigurimi arrest në burg janë të Prokurorisë Pukë.
- Ndërsa janë dërguar për gjykim **859 procedime penale**, me 1030 të pandehur, nga të cilët 121 me masë sigurimi arrest në burg. Nga këto procedime, 18 procedime penale me 30 të pandehur nga të cilët 7 me masë sigurimi arrest në burg, i përkasin Prokurorisë Pukë, e gjithë pjesa tjetër janë çështje të Prokurorisë Shkodër.
- Gjithashtu prokuroret kanë marrë pjesë edhe në 799 çështje dhe seanca gjyqësore në lidhje me masat e sigurimit, zëvendësimet, shuarjet, etj, në rreth 986 çështje dhe kërkesa në seancë paraprake dhe në lidhje me kërkesa të tjera penale apo administrativo penale gjatë hetimeve. Gjithashtu kanë marrë pjesë edhe në një numër të lartë të çështjeve ku kërkohet prania e prokurorit si palë apo si person i tretë, në çështjet që gjykohen sipas nenit 59 të K.Pr.Penale, në çështjet në fazën e ekzekutimit dhe në çështjet për heqje të zotësisë për të vepruar apo caktimin e masave mjekësore, etj.
- Nga këto çështje është përfunduar gjykimi për rreth 812 procedime penale me rreth 927 të pandehur, nga të cilët 76 me masë sigurimi arrest në burg. Ndërsa vijojnë të jenë në gjykim 594 procedime penale me 762 të pandehur. Në lidhje me çështjet e mbartura në gjykim, lidhen me rastet e gjykimit të zakonshëm ku ka pasur një numër të madh dëshmitarësh dhe zvarritje në paraqitjen dhe pyetjen e tyre, si dhe rastet e gjykimit në mungesë, kur nga gjykata është vendosur pezullimi për 1 vit sipas parashikimeve të nenit 352 të Kodit të Procedurës Penale dhe ka rifilluar gjykimi me plotësimin e këtij afati gjatë këtij viti dhe po vijojnë procedurat e njoftimeve dhe të gjykimit me gjykim të zakonshëm.
- Në lidhje me grupveprat penale kundër veprimtarisë shtetërore janë hetuar 36 procedime penale, ku vepra penale më e hetuar është ajo e “Mosbindjes ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit public” të parashikuar nga neni 242 të Kodit Penal me 12 procedime të rregjistruara të rregjistruara, nga të cilat janë përfunduar hetimet për 24 procedime penale, ndërsa mbetet në hetim 12 procedime penale.
- Në lidhje me grupveprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë janë hetuar 105 procedime penale, ku vepra penale më e hetuar është ajo e “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me 79 procedime penale të rregjistruara. Nga këto procedime 80 procedime penale janë përfunduar, ndërsa 25 procedime penale vijojnë të jenë në hetim.
- Në lidhje me grupveprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike janë hetuar 1024 procedime penale, ku vepra penale më e hetuar është ajo e “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, me 345 procedime penale të rregjistruara, më pas vjen vepra penale e “Kultivimit të bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 të Kodit Penal, ku janë rregjistruar 236 procedime penale, më pas vijon veprat penale të parashikuara nga nenet 283 dhe 290 të K.Penal. Nga këto procedime penale 798 procedime penale janë përfunduar dhe 226 procedime penale vazhdojnë në hetim.
- Në lidhje me grupveprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë janë hetuar 62 procedime penale, ku vepra penale më e hetuar është ajo e “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal, me 43 procedime penale të rregjistruara. Nga këto 39 procedime penale janë përfunduar, ndërsa vazhdojnë të jenë në hetim 23 procedime penale.
- Në lidhje me grupveprat penale kundër drejtësisë janë hetuar 94 procedime penale, ku vepra penale më e hetuar është “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në një institucion të ekzekutimit të vendimeve me burgim”, parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal, me 47 procedime penale të rregjistruara, ku nga tërësia e tyre janë përfunduar 58 procedime penale, ndërsa kanë mbetur në hetim edhe 36 procedime penale.
- Në lidhje me grupveprat penale kundër zgjedhjeve të lira janë hetuar 6 procedime penale, për veprat penale të parashikuara nga nenet 327/a, 328, 328/a dhe 330 të K.Penal. Nga këto janë përfunduar hetimet për 3 procedime penale dhe mbeten në hetim edhe 3 procedime penale.

❖ **Në lidhje me ndarjen sipas seksioneve rezulton si më poshtë:**

- ***Seksioni 1, Seksioni i Përgjithshëm***, me 5-7 prokurorë ka hetuar gjithësej 1696 procedime penale dhe kallëzime, pa përfshirë procedimet e parashkruara, ku ndër to ka përfunduar 1306 procedime penale e kallëzime dhe ka mbartur në hetim 390 procedime penale. Gjithashtu ka përfaqësuar në gjykim mbi 411 procedime penale të dërguara gjatë këtij viti.

- ***Seksioni 2, Seksioni për ndjekjen penale dhe ngritjen e akuzës në gjykim për veprat penale të kryera nga të miturit apo ndaj tyre, veprat penale kundër moralit dhe marrëdhënieve familjare dhe veprat penale në fushën e qarkullimit, etj***, me 2-3 prokurorë ka hetuar gjithësej 760 procedime penale dhe kallëzime, pa përfshirë procedimet e parashkuara, ku ndër to ka përfunduar 643 procedime penale dhe ka mbartur në hetim 117 procedime penale. Gjithashtu ka përfaqësuar në gjykim edhe 312 procedime penale të dërguara në gjykim gjatë këtij viti.
- ***Seksioni 3, Seksioni i Posaçëm kundër Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit, Krimeve Financiare dhe Hetimeve Pasurore***, me 2-3 prokurorë ka hetuar gjithësej 611 procedime penale dhe kallëzime, si dhe 41 referime pasurore, ku ndër to ka përfunduar 436 procedime penale dhe ka mbartur në hetim 175 procedime penale. Gjithashtu ka përfaqësuar në gjykim edhe 141 procedime penale të dërguara në gjykim gjatë këtij viti.

❖ Ekzekutimet e vendimeve penale të formës së prerë.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, gjatë vitit 2023 ka vijuar punën edhe zyra e ekzekutimeve të vendimeve penale në pamundësi për krijimin e një seksioni të plotë, për shkak të mungesës së prokurorëve dhe lëvizjes së tyre. Për këtë arsye, në këtë zyrë përveç prokurorit janë caktuar dy oficerë të policisë gjyqësore dhe dy sekretarë për të ndihmuar prokurorin e vetëm të kësaj zyre në lidhje me detyrët në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, etj.

Gjatë vitit 2023, ashtu si edhe vitet e tjera zyra/seksioni i ekzekutimeve ka qënë i ngarkuar me ekzekutimet e vendimeve të formës së prerë, mbikqyerjen e tyre, marrëdhëniet me IEVP, Zyrën e Përmbartimit, Degët e Shërbimit të Provës dhe me ekzekutimin e letërporosive, ekstradimeve dhe marrëdhënieve të tjera juridiksionale me jashtë. Ku këtë ngarkesë e ka mbajtur prokurori z. **Agron Bushati**, i cili ka pasur një ngarkesë të lartë të urdhërave të ekzekutimit por edhe numrit të madh të seancave gjyqësore të zhvilluara në gjykatë, në lidhje me kërkesat e të dënuarve në fazën e ekzekutimit, e shkaktuar edhe nga ngarkesa e krijuar nga kërkesat e të dënuarve kryesisht nga IEVP Reç Malësi e Madhe dhe shtimi i vazhdueshëm i numrit të të dënuarve në këtë institucion që ka ndikuar edhe në punën dhe ngarkesën e këtij prokurori dhe të kësaj zyre në tërësi.

Rezulton se gjatë vitit 2023, janë vënë në ekzekutim të gjitha vendimet penale të formës së prerë duke respektuar përgjithësisht afatet ligjore të parashikuara në ligjin Nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar.

Janë nxjerrë dhe vënë në ekzekutim duke u lëshuar **671 urdhëra për ekzekutimin** e vendimeve penale, e konkretisht;

- 59 urdhëra ekzekutimi për vendime me burgim;
- 52 urdhëra ekzekutimi për vendime me gjobë;
- 20 vendime dhe urdhëra të dhëna për dënimet plotësuese.

- Janë nxjerrë 483 urdhëra për vendime sipas nenit 59 të K.Penal,
- 15 urdhëra për vendime sipas nenit 59/a të K.penal,
- 139 urdhëra për vendime sipas nenit 63 të K.Penal;
- 34 urdhëra për vendime sipas nenit 64 të K.Penal;
- Gjithashtu po kaq urdhëra janë nxjerrë edhe 671 urdhëra në lidhje me pagimin e shpenzimeve procedurale, për secilin vendim dhe procedim penal të përfunduar.

Nga këto urdhëra të nxjerre janë ekzekutuar;

- 59 urdhëra ekzekutimi për vendime me burgim;
- 59 urdhëra ekzekutimi për vendime me gjobë,
- 21 urdhëra për vendime për dënime plotësuese.
- Janë ekzekutuar 483 urdhëra për vendime sipas nenit 59 të K.Penal,
- 15 urdhëra për vendime sipas nenit 59/a të K.penal,
- 139 urdhëra për vendime sipas nenit 63 të K.Penal;
- 34 urdhëra për vendime sipas nenit 64 të K.Penal;
- Gjithashtu po kaq urdhëra janë nxjerrë edhe në lidhje me pagimin e shpenzimeve procedural, për secilin vendim dhe procedim penal të përfunduar.

Nga këto urdhëra, kanë mbetur pa u ekzekutuar;

- 2 urdhëra ekzekutimi për vendime me burgim;
- 2 urdhëra ekzekutimi për vendime me gjobë;
- Janë mbartur edhe 2 urdhëra pa ekzekutuar;
- Gjithashtu janë nxjerrë dhe ekzekutuar urdhëra në lidhje me pagimin e shpenzimeve procedural, për secilin vendim dhe procedim penal të përfunduar.

Nga ana e sektorit të ekzekutimit të vendimeve penale është bërë një punë e mirë lidhur me nxjerrjen e urdhërave të kërimit ndërkombëtar në zbatim të kërkesave të reja ligjore që kanë sjelle ndryshimet e legjislacionit në këtë fushë. Gjithashtu edhe në lidhje me kërkesat për ekstradime dhe ekzekutimin e letërporosive nga jashtë shtetit. Kështu në zbatim të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Policinë nga kjo prokurori janë nxjerrë disa urdhëra për kërkim ndërkombëtar.

❖ **Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë gjatë vitit 2023.**

Gjithashtu gjatë vitit 2023 ka pasur një ngarkesë të konsiderueshme pune në lidhje me marrëdhëniet juridikionale me autoritetet gjyqësore të huaja, në lidhje me dërgimin e letërporosive për jashtë shteti apo ekzekutimin e letërporosive të ardhura nga jashtë shteti, në lidhje me ekstradimet apo edhe në lidhje me njohjet e vendimeve penale të huaja apo transferimet e procedimeve.

Përsa i përket ngarkesës dhe numrit të letërporosive apo akteve të tjera në lidhje me marrëdhëniet juridikionale me jashtë janë si më poshtë konkretisht;

- Gjatë këtij viti janë dërguar për jashtë shtetit **59 kërkesa për ndihmë juridike** në fushën penale;
- Janë ekzekutuar **26 kërkesa** për ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja të dërguara nga ana jonë gjatë vitit 2023, si dhe janë ekzekutuar edhe një sërë kërkesash rreth 18 të dërguara nga vitet e mëparshme;
- Për **5 kërkesa** autoritetet e huaja kanë vendosur mospranim ekzekutimi.
- Nga autoritet gjyqësore të huaja, kanë ardhur për t'u ekzekutuar **26 kërkesa për ndihmë juridike**, ku 24 kërkesa janë ekzekutuar deri tani, ndërsa 2 të tjerat janë në proces ekzekutimi.
- Kanë ardhur **8 kërkesa për ekstradim** për jashtë shtetit nga autoritet gjyqësore të huaja, të cilat janë vënë në ekzekutim duke paraqitur kërkesat pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku për të 8 kërkesat është vendosur pranimi i ekstradimit dhe janë ekzekutuar.
- Gjithashtu gjatë këtij viti ka pasur **11 kërkesa për njohje të vendimeve penale** të dhëna nga autoritet gjyqësore të huaja të cilat janë në proces ekzekutimi.
- Gjatë këtij viti nuk ka pasur kërkesa për ekzekutim të vendimeve penale shqiptare drejt autoriteteve të huaja.

❖ **Në lidhje me marrëdhëniet juridikionale me jashtë mbetet për tu bërë më shumë dhe konkretisht:**

- Të rritet komunikimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në drejtim të rritjes numrit të kërkesave për ndihmë juridike në fushën penale nga prokurorët, dhe ekzekutimin e tyre në kohë dhe ulja e rasteve të refuzimit për ekzekutim të tyre.
- Trajnimi dhe njohja me mirë e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar që rregullon këto marrëdhënie, nga ana e prokurorëve, me qëllim rritjen e cilësisë së këtyre kërkesave.
- Të nxirren menjëherë urdhërat e kërimit ndërkombëtar që në momentin e konstatimit të pamundësisë së ekzekutimit të masës së sigurimit dhe jo vetëm pas dërgimit të çështjes për gjykim apo vetëm për vendimet penale të formës së prerë por edhe në rastet e masave të sigurimit në mungesë, dhe t'i dërgohen menjëherë Prokurorisë së Përgjithshme për kalimin e tyre për ekzekutim.

- Në disa raste konstatohet se kërkesat për ndihmë juridike formulohen dhe dërgohen me vonesë nga momenti i evidentimit të nevojës për një kërkesë të tillë.
- Gjithashtu, ka vonesa në ekzekutimin e tyre, nuk ka një komunikim të vazhdueshëm dhe periodic me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe me Drejtorinë përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe nuk shfrytëzohen sa duhet komunikimet direkte me autoritet e huaja apo me oficeret ndërlidhës pranë ambasadave në Tiranë, në ato raste kur është mundësia për një gjë të tillë e mundur dhe jep rezultate.

❖ **Problematikat e hasura gjatë vitit 2023.**

- Gjatë vitit 2023, puna e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ashtu si puna e prokurorisë në përgjithësi ka hasur një sërë problematikash ku një pjesë të mirë të tyre janë cekur apo trajtuar si më sipër, si në cilësinë e referimeve të veprave penale, në kallëzimet penale, në drejtimin e hetimeve të plota dhe të gjithëanshme apo në përfaqësimin e akuzës në gjyq.
- Implementimi i “Hartës së Re Gjyqësore” ka qenë deri një sfikë e kapërcyer që ka ndikuar drejtpërdrejtë në punën dhe ngarkesën e prokurorisë, por në cilësinë e hetimeve në tërësi dhe krijimin e një raporti të ri me të gjitha zonat dhe institucionet që përfshijnë juridiksionin e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Gjithashtu, janë hasur vështirësi edhe në administrimin e prokurorisë dhe në drejtim të përmirësimit e punës në tërësi, përse i përket mbajtjes dhe menaxhimit të të dhënave statistikave dhe informacioneve të plota, por duhet thënë se ka një përmirësim të ndjeshëm që po shkon në drejtim të duhur, përse i përket saktësisë së të dhënave, statistikave apo informacioneve sa më të plota dhe të sakta dhe paraqitjes së tyre në kohë reale.
- Vështirësi janë hasur qoftë në zbatimin e plotë të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe Urdhërave dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu edhe në aktet e tjera nënligjore, ku duhet të vazhdojë nxitja dhe orientimi i prokurorëve në mënyrë periodike dhe sistematike, me qëllim realizimin sa më të plotë dhe gjithanshëm të të gjitha rekomandimeve prioritare në vitin e në veçanti atyre të vitit 2023.
- Përse i përket, hetimit të veprave penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar janë hasur vështirësi qoftë përse i përket numrit të referimeve dhe cilësisë së tyre, ashtu edhe numrit të procedimeve penale të hetuara dhe kapaciteteve jo të plota në hetimin e këtyre grup veprave penale, mungesën e trajnimit të oficerëve të shërbimeve dhe të institucioneve në fushën ekonomike dhe financiare, jo vetëm të DVP Shkodër, por edhe të DVKM Shkodër, Tatimeve, Doganave etj.
- Në lidhje me grupveprat penale të shpërdorimit të detyrës, megjithëse ka pasur një numër të konsiderueshëm referimesh, cilësia e tyre dhe mbështetja në fakte dhe prova nuk është në nivelin e duhur dhe të kërkuar, ku konstatohet se një pjesë e këtyre kallëzimeve janë paraqitur në formë pakënaqësishë nga subjektet kallëzuese dhe nuk evidentojnë shkelje konkrete të dispozitave ligjore apo procedurale dhe nuk evidentohet saktë apo qartë

ndonjë pasoje konkrete materiale apo jomateriale apo cënim konkret i të drejtave të tyre ligjore. Megjithatë, ka një numër më të lartë të dosjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim gjatë këtij viti në raport me një vit më parë.

- Një situatë e ngjashme vijon të jetë edhe në lidhje me veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, ku kohët e fundit vërehet një përmirësim në drejtim të paraqitjes së referimeve më të plota, kryesisht ato të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, por përsëri vlerësoj se në pjesën verifikuese duhet të bëhet një punë më e madhe dhe një analizë për secilin rast të referuar me qëllim shmangien e hetimeve pa rezultate. Gjatë vitit 2023 dhe aktualisht ka një rënie e dukshme edhe të numrit të referimeve të veprës penale të parashikuar nga neni 287 të K.Penal dhe një staniacion të referimeve pasurore.
- Në hetimin e vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore si vrasjet, vjedhjet me armë apo me dhunë, shtrëngimi për dhënien e pasurisë, ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit, prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike, etj, janë trajtuar në tërësi, por konstatohen mangësi dhe pamundësi në hetimin e gjithëanshëm të tyre. Kërkohej një angazhim më i madh në drejtim të hetimeve sa më cilësore dhe në drejtim të ri-fillimit të hetimeve për ngjarjet e vjetra të ndodhura për këto grup veprash penale dhe të pezulluara më pas, ku për to dhe për të arritur rezultate duhet bashkëpunuar me ngushtësisht me policinë e shtetit dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe përdorimi më cilësor i metodave speciale të hetimit dhe aplikimi i hetimeve proaktive.
- Në lidhje me hetimet për veprat penale “Vjedhje” dhe “Vjedhje e energjisë elektrike” ku rezultojnë prej vitesh veprat më të përhapura në rrethin tonë dhe në vendin tonë dhe për hetimin e tyre është zhvilluar një volum pune relativisht të lartë. Megjithëse ka një ulje të numrit të përgjithshëm të këtyre procedimeve, përsëri konstatojmë se referimet për këto vepra janë të mangëta dhe hetimet në vijim nuk kanë cilësinë dhe shpejtësinë e kërkuar për përfundimin e tyre apo në lidhje me ngritjen e një akuze të bazuar. Gjithashtu, konstatojmë se referimet për nenin 137 të K.Penal, janë fokusuar në pjesën dërmuese të tyre vetëm ndaj personave fizik, duke pasur raste të pakta të hetimit të subjekteve apo ndaj personave juridik, që në vlerësimin tonë shkaktojnë një dëm ekonomik të konsiderueshëm dhe shumë herë më të lartë se sa rastet e personave fizik apo familjar. Një element pozitiv, gjatë këtij viti është fakti se janë hetuar 14 procedimi për nenin 137/2 të K.Penal dhe janë përfunduar duke u dërguar në gjyq 11 procedime penale me 12 të pandehur, për nenin 137/2 të K.Penal, fakt që tregon se hetimet gjatë këtij viti kanë qenë më serioze në drejtim të kryerjes së kësaj vepre penale nga abonent jofamiljarë, pra për qëllime biznesi, etj.
- Në hetimin e veprave penale si “Ndërtimet pa leje”, ka një volum pune të lartë, si dhe një bashkëpunim të mirë dhe në rritje me policinë dhe drejtorinë përkatëse në bashkitë e qarkut, por hetimet edhe këtu janë fokusuar kryesisht ndaj personave fizik dhe hetimet ndaj personave juridik janë të pakta dhe parandalimi i këtij fenomeni larg pritshmërive. Theksojmë se gjatë këtij viti, janë hetuar 38 procedimi për nenin 199/a/3 të K.Penal dhe 18 procedime penale për nenin 199/a/4 të K.Penal. Ku janë dërguar për gjykim përkatësisht 36 procedime penale me 36 të pandehur për nenin 199/a/3 të K.Penal dhe 16 procedime penale me 16 të pandehur për nenin 199/a/4 të K.Penal. Të dhëna që tregojnë një angazhim më serioz dhe më të madh në drejtim të hetimit të ndërtimeve pa leje nga persona juridik, në tokën e huaj apo me funksion biznesi. Gjithashtu konstatojmë se

bashkëpunimi dhe kordinimi i punës mes komisariateve dhe drejtorive përkatëse në bashkitë e rrethit, vijon të jetë jo në lartësinë e duhur, pasi vijnë të kemi kallëzime apo referime nga të dy institucionet për të njëjtët objekte të paligjshme por, në kohë të ndryshme dhe me të dhëna të mangëta, fakt që sjell rregjistrimin e dy ose më shumë procedimeve penale për të njëjtin fakt apo objekt dhe më pas bashkimin e tyre.

- Në hetimin e veprave penale që lidhen me “Mastrimet në sigurime”, ka një rënie të numrit të procedimeve në raport me një vit më parë me 18, ku 12 procedime janë të mbartura dhe 6 procedime penale të reja, por kallëzimet dhe në vijim hetimet janë fokusuar vetëm ndaj personave fizik, duke mos hetuar siç duhet nëpunësit shtetëror që kanë mbajtur dokumentacion e pensioneve në lidhje me bashkëpunimin e tyre, falsifikimin e dokumenteve dhe shpërdorimin e detyrës të kryer nga ana e tyre. Në këtë drejtim edhe pse për pjesën e madhe të rasteve ndjekja penale mund të jetë parashkruar vlerësohet se duhet të ketë një reagim dhe nxitje më të madhe për referimet për nenin 248, 248/a të K.Penal në lidhje me nëpunësit që kanë mbajtur rregjistrat e institucioneve të ndryshme në lidhje me vitet e punës të shtetasve përfitues të pensioneve me të padrejtë apo me ndërhyrje. Ku gjatë këtij vitit ka pasur një sërë kallëzimesh në lidhje me nëpunësit shtetërorë.
- Në hetimin e veprave penale që lidhen me “Shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor”, ka një volum të konsiderueshëm të referimeve dhe hetimeve, ku në përgjithësi ka përmirësime në drejtim të masave të marra dhe veprimeve të para hetimore, por përsëri kërkohet një bashkërendim më i mirë në rastin e pasojave të rënda dhe aksidenteve komplekse, ku mungesa e ekspertëve të licencuar dhe mosprania e tyre në vendin e ngjarjes në kohën e ngjarjes dhe domosdoshmëria e kryerjes së ri-ekspertimeve me grup ekspertësh, ndikon në cilësinë e hetimeve, në zgjatjen e tyre dhe në ngritjen e akuzës së kontestuar nga palët qoftë pala e akuzuar ashtu edhe nga pala viktimë e vepres penale. Ku në vijimësi qoftë nga e akuzuar dhe ashtu edhe nga pala viktimë ka pasur pretendime në kryerjen e 2-3 apo edhe më shumë akteve të ekspertimeve kryesisht autoteknike në lidhje me evidentimin e saktë të shkeljeve të rregullave nga secili përdorues i rrugës. Konstatohet që ka një rritje të numrit të veprave penale të referuara për nenin 291 të K.Penal në raport me një vit më parë dhe një ulje të veprave penale të referuara për nenin 290 të K.Penal, në raport me një vit më parë. Për arsye, vlerësojmë me shtimi i referimeve dhe hetimeve për nenin 291 të K.Penal, ka shërbyer si një masë parandaluese në lidhje me uljen e numrit të aksidenteve rrugore me pasoja në njerëz.

❖ **NGARKESA E PUNËS SË PROKURORËVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE GJATË VITIT 2023.**

Gjate vitit 2023, nga ana e prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është përballuar një ngarkesë e lartë çështjeve penale dhe përfaqësimi në gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Ashtu sic edhe e kemi trajtuar në pikën e parë të këtij raporti, rezulton se nga prokurorët janë verifikuar dhe hetuar dhe në vijim

përfunduar një numër relativisht i madh i çështjeve penale të rregjistruara dhe të mbartura.

Me konkretisht po japin në një tabelë përmbledhëse të dhënat e ngarkesës së secilit prokuror dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

Prokurori	Materiale	Gjyqit	Pushuar	Pezulluar	Mokomp	Mosfilluar	Gjithësej Përfunduar	Mbetur Hetim
A.Murçaj	183	64	29	27	4	22	146	37
F.Lekani	191+ 60	104	45	27	0	15	191	0
B.Hamza	239	38	68	14	7	31	158	81
Sh.Milla	298	76	35	85	5+7	42	250	48
V.Staka	298+ 50	82	95	117	0	4	298	0
G.Spahiu	408	132	79	101	4	15	331	77
N.Halilaj	286	125	50	20	3+1	54	253	33
E.Hasmujaj	288	73	45	87	1+5	32	243	45
A.Kuliçi	283	83	60	26	2	28	199	84
B.Vishe	189	39	36	16	4	37	132	57
P.Çukaj	174	35	17	29	3+1	30	115	59
A.Hoxha	84	5	1	0	3	15	24	60
L.Tema	76	8	1	1	3+3	16	32	44
M.Frasher	70	0	3	3	1	6	13	57
A.Bushati	1	0	0	0	0	0	0	1

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, gjatë vitit 2023 ka funksionuar me një numër të reduktuar prokurorësh, ku nga 20 prokurorë që ka qenë organika kanë hetuar faktikisht 11 deri në 15 prokurorë vetëm në dy muajt e fundit të vitit. Ku 1 prokuror për shkak të kërkesave të fazës së ekzekutimeve është marrë vetëm me ekzekutimet dhe nuk ka kryer hetime. Gjithashtu ka pasur lëvizje prokurorësh gjatë gjithë vitit, si leje, transferime, pezullime, caktime të përkohëshme, emërimet, etj.

Në disa momente gjatë vitit 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër nuk ka funksionuar sistemi CAMS, ose ka pasur një shoërndarje jo të balancuar mes prokurorëve të të njëjtit seksion. Gjatë kësaj periudhe materialet kallëzuese dhe hetimore janë hedhur në short manual në seksione dhe mes prokurorëve të ndarë në seksione pasi nuk ka funksionuar sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ose kur është përjashtuar një prokuror për shkak të lejes apo mbingarkese. Gjithashtu problematike ka qenë edhe hedhja në short manual për të gjitha dosjet e shortuara dhe të mbetura pas largimeve, pezullimeve apo dorëheqjeve të prokurorëve.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, gjatë vitit 2023, nga janari deri në korrik ka funksionuar me tre seksione dhe një seksion/zyrë, seksioni i parë për krimet e rënda, vrasjet, vjedhjet, drogës, etj, seksioni i dytë për të miturit, dhunën në familje, seksioni i tretë seksioni i posaçëm për krimin financiar, pastrimin e parave, etj, duke vijuar punën të ndarë në tre seksione dhe një seksion/zyrë për ekzekutimet e vendimeve penale dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, si seksion më vehte, pamvarësisht fakt që ka qenë e pamundur të kishte gjatë gjithë kohës së paku tre prokurorë për çdo seksion siç e kërkon ligji për prokurorinë, por kjo ka qenë për shkaqe objektive dhe në vijimësi janë marrë masa për plotësimin e seksioneve.

Gjatë këtij viti, materialet kallëzuese dhe procedimet e tjera penale dhe ato të rifilluara janë hedhur apo ri-hedhur në short sipas seksioneve, ku për shkak të kategorisë së veprave penale, numrit të tyre dhe materialeve kallëzuese përkatëse, numri i materialeve hetimore të hedhura në seksione të ndryshme nuk ka qenë i barabartë, gjithashtu për këto arsye dhe të gadishmërisë një pjesë e materialeve në lidhje me vepra të caktuara penale janë hedhur në short edhe mes prokurorëve të seksioneve të tjera pamvarësisht faktit që vepra penale objekt hetimi ka qenë e një seksioni të caktuar.

❖ Ngarkesat e prokurorëve gjatë vitit 2022, rezultojnë si më poshtë :

Prokurori Albert Murçaj :

Rezultojnë se gjatë këtij viti ka mbajtur detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë ku ka qenë i angazhuar edhe me detyrat drejtuese dhe administrative. Në pjesën më të madhe të vitit ka qenë pjesë e Seksionit 3, Seksionit të Posaçëm, ku ka marrë materiale në short dhe ka qenë pjesë e gadishmërisë mujore. Gjatë vitit 2023 rezultojnë se ka trajtuar **183** procedime penale dhe kallëzime të trajtuara, nga janari 2023 deri në dhjetor 2023, si dhe ka mbajtur edhe raportimet vjetore gjithësej **400 raportime** dhe arkivime. Ka përfunduar 146 procedime penale.

Ka hetuar 9 procedime penale me metoda speciale dhe hetime proaktive në vijimësi duke përfunduar hetimet me sukses dhe duke dërguar për gjykim pjesëm më të madhe të tyre.

Ka hetuar dhe dërguar për gjykim 5 procedime penale me 8 pandehur të dërguar për gjykim me marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe 1 procedim penale me Urdhër penal.

Ka marrë pjesë në trajnime dhe seminare të ndryshme gjatë vitit 2023, qoftë në lidhje me dispozitat e Kodit Penale, Kodit të Procedurës Penale, si dhe në seminare të ndryshme në lidhje me Krimet Financiare dhe Pastrimit të Produkteve të vepres penale. Gjithashtu ka marrë pjesë në një sërë takimesh dhe mbledhjes si përfaqësues i prokurorisë në nivel vendor.

Prokurore Franceska Lekani :

Rezultojnë se ka trajtuar rreth **191** procedime penale dhe kallëzime të trajtuara, nga janari 2023 dhe të përfunduara dhe ka dorëzuar edhe 63 procedime penale në hetim dhe rreth 55 çështje në gjykim. Në muajin dhjetor 2023 është pezulluar nga detyra si rrjedhojë e procesit të Vetëinspektimit me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Dosjet në hetim dhe gjykim të dorëzuara prej saj janë hedhur në short manual, një pjesë mes prokurorëve të seksionit 2 dhe pjesa tjetër mes gjithë prokurorëve. Gjatë vitit 2023 ka mbajtur detyrën e Zëvendës drejtueses së Prokurorisë dhe të Drejtueses së Seksionit për të Miturit dhe nuk

ka lëvizur nga ky seksion. Në vijim ka marrë dosje me short manual dhe elektronik duke pasur edhe çështje të bashkuara si dhe në vijim ka marrë çështje me short elektronik dhe manual duke mbajtur një ngarkesë të madhe edhe për shkak të detyrave si Zëvendës drejtuese.

Ka marrë pjesë në trajnime dhe seminare të ndryshme gjatë vitit 2023, si dhe ka përfaqësuar prokurorinë një një sërë takimesh dhe seminaresh në cilësinë e Zëvendës drejtueses dhe në cilësinë e Drejtueses së Seksionit për të Miturit.

Prokurori Vate Staka :

Rezulton me **298** procedime penale dhe kallëzime të trajtuara të përfunduara, nga janari 2023 deri në 18 dhjetor 2023, kur ka filluar detyrën e Anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku ka dorëzuar rreth 50 procedime penale në hetim. Gjatë gjithë vitit ka mbajtur detyrën e prokurorit në Seksionin 1, Seksionin e Përgjithshëm dhe nuk ka lëvizur nga ky seksion. Në vijim ka marrë dosje me short manual dhe elektronik duke pasur edhe çështje të bashkuara si dhe ka qenë nga prokurorët më të ngarkuar gjatë këtij viti, duke pasur edhe një numër të lartë të çështjeve të përfunduara. Dosjet në hetim dhe gjykim të dorëzuara prej tij në dhjetor janë hedhur në short manual, një pjesë mes prokurorëve të seksionit 2 dhe pjesa tjetër mes gjithë prokurorëve.

Nga fillimi i vitit është caktuar prokuror i Medias. Ndërsa me datë 18.12.2023, është zgjedhur dhe ka filluar detyrën si anëtar i KLP.

Gjatë vitit 2023, ka hetuar 6 procedime me metoda speciale dhe hetime proaktive duke përfunduar hetimet dhe duke dërguar për gjykim pjesëm më të madhe të tyre.

Ka marrë pjesë në disa trajnime të zhvillua nga Shkolla e Magjistraturës.

Prokurori Gezim Spahiu :

Rezulton me **421** procedime penale dhe kallëzime të trajtuara dhe materiale të trajtuara prej tij. Është caktuar prokuror në Seksionin e 1, Seksionin e Përgjithshëm gjatë gjithë vitit 2023. Ka qenë prokurori më i ngarkuar gjatë vitit 2023, për shkak të dosjeve të mbartura dhe për shkak marrjes me short manual edhe të dosjeve të dorëzuara nga prokurorët e tjerë. Në vijim ka marrë dosje me short manual dhe se ka pasur edhe çështje të bashkuara si dhe në vijim ka marrë çështje me short elektronik. Rezulton prokurori që ka përfunduar edhe numrin më të madh të dosjeve brenda vitit 331 procedime dhe kallëzime pa përfshirë dosjet e parashkruara.

Ndër materialet e hetuara gjatë vitit 2023, në 5 procedime penale janë **rregjistruar kryesisht** prej këtij prokurori, për veprat penale që kanë rezultuar të provuara rishtazi nga hetimet e thelluara, për të cilat është ushtruar më pas ndjekja penale (kryesisht për falsifikim të dokumenteve nga punonjës shtetërorë, pastrim të produkteve të veprës penale etj.);

Ka hetuar dhe marrë të pandehur për kryerjen e **krimeve kundër jetës** 6 persona. Ka hetuar dhe marrë të pandehur për kryerjen e **krimeve të rënda kundër pasurisë** (vjedhje e bankave; vjedhje me armë) 4 persona. Ka kërkuar dhe vendosur **sekuestro preventive** për dy pasuri të paluajtshme të dyshuara si produkte të veprës penale (truall dhe objekt), si dhe është ngritur akuzë ndaj 7 personave për veprën penale të pastrimit të produkteve

të veprës penale. Ka regjistruar dhe hetuar 12 procedime penale **proaktive dhe me metoda speciale të hetimit**.

Ky prokuror është angazhuar si **lehtësues** në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës në 5 ditë, respektivisht, në trajnimet me temë “*Seanca Paraprake*” dhe “*Bandat e Armatosura*”, dhe si **pjesëmarrës** në 7 trajnime të tjera të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, OSBE, AIRE Centre, ILO etj.

Prokurore Shqiponja Milla :

Rezulton me **298** procedime penale dhe materiale të trajtuara, ku nga janari deri në dhjetor 2023 ka mbajtur detyrën e prokurores dhe të Drejtueses së Seksionit 1, të Seksionit të Përgjithshëm. Në vijim ka marrë dosje me short manual dhe se ka pasur edhe çështje të bashkuara dhe në pjesën më të madhe ka marrë çështje me short elektronik. Ka trajtuar dhe përfunduar pjesëm më të madhe të dosjeve të hetuara dhe të verifikuara prej 250 materiale.

Ndër të tjera, gjatë vitit 2023 ka hetuar **4 procedime penale** me metoda speciale të hetimit, nga të cilat njëri ka rezultuar i suksesshëm dhe është finalizuar me arrestimin e të dyshuarit, si dhe dërgimin në gjyq të tij më pas (proc.611/2023, për veprën penale të parashikuar nga neni 284/1 i K.Penal).

Ndër dosjet më të suksesshme të vitit 2023:

Proc.752 të vitit 2022, me të pandehur shtetasit E.M. dhe J.M., (marrë nga prokuror tjetër me vendim zëvendësimi), dërguar për gjykim me akuzën për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 137/2, e 170/ç-25 të K.Penal, finalizuar me vendim fajësie, brenda vitit 2023 (kapur në flagrancë me makineri Bitcoin).

Proc. nr.1399, të vitit 2022, në ngarkim të të pandehurve J.P. dhe F.P., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashttrim kompjuterik”, parashikuar nga neni 143/b/2 i **K.Penal**, si dhe të pandehurve S.R. dhe A.U., të akuzuar për veprën penale “Organizimi ose ushtrimi i lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 179-25 i K.Penal, finalizuar me vendim fajësie gjatë vitit 2024 (ushtruar nëpërmjet Call Center).

Proc. **nr.1124 të vitit 2013**, me të pandehur P.Rr., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287/1/a i **K.Penal**, dërguar për gjykim gjatë vitit 2022, dhe gjykuar gjatë vitit 2023, duke u finalizuar me vendim fajësie dhe konfiskim pasurie në vlerën **206,802,638 lekë**.

Proc. 1238 të vitit 2020, në ngarkim të të pandehurve I.H. dhe V.B., të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/dh-22-25 dhe 278/1 të **K.Penal**, dërguar për gjykim në vitin 2022 dhe finalizuar gjykimi gjatë vitit 2023, me vendim fajësie për veprat e akuzuara.

Proc. 439 të vitit 2022, me të pandehur M.H., i akuzuar për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike apo impulseve telefonike” dhe “Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare”, parashikuar nga neni 137/2 dhe 170/ç/1 i K.Penal, dërguar për gjykim gjatë vitit 2022 dhe finalizuar me vendim fajësie gjatë vitit 2023, për të dy veprat penale (kapur në flagrancë me makineri Bitcoin).

Proc. 454 të vitit 2022, në ngarkim të të pandehurit K.N., i akuzuar për veprat penale të “Vjedhje e energjisë elektrike” përdorues jofamiljar, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal dhe “Kultivim i bimëve narkotike” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe F.E., i akuzuar për veprën penale “Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga neni **305/b, i Kodit Penal**, dërguar për gjykim gjatë vitit 2022, gjykuar dhe finalizuar me vendim fajësie për veprat penale në fjalë gjatë vitit 2023.

Procedimi penal nr.1280, i vitit 2021, në kuadër të të cilit gjatë vitit 2023 është vendosur me vendim Gjykate sekuestro preventive, si dhe referimi pasuror 21 i vitit 2019, në kuadër të të cilit është vendosur sekuestro preventive gjatë vitit 2023 dhe në vitin 2024 është bërë kërkesë për konfiskim të pasurisë së paligjshme.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, ka punuar shumë në drejtim të zbardhjes së çështjeve të regjistruara rishtazi, duke i regjistruar dhe deleguar në kohë optimale, dhe njëkohësisht i është dhënë përparësi çështjeve të vjetra të marra nga prokurorët e tjerë gjatë viteve 2021-2022, duke i hetuar shpejt dhe duke i dërguar për gjykim çështje shumë të vjetra, të finalizuara më vendime fajësie nga Gjykata gjatë vitit 2023.

Po ashtu, ka treguar vigjilencë në mosfillimin në kohë të materialeve kallëzuese apo shpalljen në kohë të moskompetencës për materialet kallëzuese të ardhura nga Prokuroritë e tjera, për të cilat, në pjesën dërrmuese ka pasur vendimmarrje të Prokurorit të Përgjithshëm në favor të vendimit të moskompetencës apo konfliktit për kompetencë të prokurores.

Gjatë vitit 2023, ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës:

- *Hetimi proaktiv. Kuadri ligjor. Burimet e informacionit për hetimet kriminale të bazuara në inteligjencë dhe marrëdhëniet e prokurorit me shërbimet pas administrimit të informacionit prej tyre...*
- *Afatet e paraburgimit sipas nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale, e parë në këndvështrimin e ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale lidhur me fazën e hetimit paraprak dhe fazën e gjyimit paraprak. ...*
- *Seanca paraprake në tërësinë e saj. Praktika gjyqësore e deritanishme. Neni 332/d, vendimi i seancës paraprake dhe konsekuencat e tij për vazhdimësinë e procedimit të filluar nga prokurori.*
- *Veprat penale vazhduese dhe ato të qëndrueshme (permanente).*
- *Trajnim për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave të pastrimit të parave, përfshirë çështjet e lidhura me korrupsionin. Etj.*

Prokurore Blerta Hamza :

Rrezultoni me **239** procedime penale dhe kallëzime të trajtuara, gjatë vitit 2023. Gjatë gjithë vitit 2023 ka qenë prokurore dhe Drejtuese e Seksionit të Posaçëm dhe Pikë Kontakti pranë Sektorit të Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme. Në vijim ka marrë çështje me short elektronik dhe manual. Ka përballuar pjesëm më të madhe të procedimeve të krimit ekonomik dhe referimeve pasurore të këtij seksioni.

Gjatë vitit 2023, ka mbikqyerur dhe monitoruar plotësimin e sistemit Presto dhe administrimin e tij, monitorimin e sistemit E-tracking, platformën online për hedhjen e rasteve të krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave dhe në vijim ka mbajtur detyrën e Zv/drejtueses së Prokurorisë.

Gjatë vitit 2023, procedimet penale të hetuara në të cilat janë aplikuar metodat speciale të hetimit kanë qënë shumë pak, madje në kujtesën time ska patur të tilla të cilat të jenë regjistruar në vitin 2023.

Gjatë këtij viti nga ana ime janë aplikuar gjykimet e posacme si marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit si dhe urdhëri penal, për aq sa e ka lejuar marzhi i dënimit për veprën penale të regjistruar. Urdhëri penal është aplikuar në **dy raste** ndërsa marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit është aplikuar në **7 raste**.

Gjatë vitit 2023 ka hetuar **30 procedime penale** për kryerjen e veprës penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”** parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Gjithashtu, ka hetuar **42 procedime penale** për kryerjen e veprës penale **“Shpërdorim i detyrës”**, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, prej të cilave 23 janë pushuar, 7 janë dërguar për gjykim duke u marrë si të **pandehur 33 shtetas**.

Gjithashtu, janë hetuar dy dosje penale për kryerjen e veprave penale **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”** parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal dhe **“Kultivimi i bimëve narkotike”** parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, në kuadër të të cilave janë marrë si të **pandehur 21 shtetas**.

Gjatë vitit 2023 ka hetuar 57 procedime pasurore prej të cilave 27 janë pushuar, për 2 është shpallur moskompetenca, janë vendosur 3 sekuestro dhe 2 konfiskime në kuadër të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 **“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”**, i ndryshuar.

Gjëtë këtij vitit kam kryer trajnime të ndryshme pranë Shkollës së Magjistraturës me tema të ndryshme, si dhe trajnime të organizuara nga ana e organizmave të ndryshme ndërkombëtare jashtë shtetit me tema të ndryshme.

Prokurori Pierind Çukaj :

Rezulton me 174 procedime penale dhe kallëzime të trajtuara dhe të përfunduara në periudhën Maj – Dhjetor 2023. Në periudhën Janar –Maj 2023, ka qënë prokuror i vetëm dhe Drejtues Prokurorie në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, ku gjatë kësaj periudhe ka trajtuar 60 materiale të kësaj prokurorie. Në vijim të zbatimit, të «Hartës së Re Gjyqësore» ka marrë masat e duhura administrative dhe procedurale si dhe gjatë muajit Maj 2023 është angazhuar në drejtim të shkrirjes së kësaj Prokurorie dhe administrimit të materialeve dhe dërgimit të tyre në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, duke shmangur problematikat dhe vëshirësitë në shkrirjen e dy prokurorive. Në vijim është caktuar prokuror në Seksionin e 1, Seksionin e Përgjithshëm, ku ka marrë çështje kryesisht me short elektronik, por edhe manual në lidhje me largimet dhe zëvendësimet e prokurorëve.

Gjatë periudhës janar-prill 2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, ka ushtruar edhe detyrën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Pukë.

Gjithashtu, ka trajtuar **73** materiale, nga këto **17 mosfillime penale**, **21** procedime penale janë pezulluar, **15** procedime penale janë pushuar, **2** procedime janë në hetim, **18** janë dërguar në gjykatë, fillimisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe nga këto kanë vijuar gjykimin për **6** në Gjykatën e Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Në periudhën maj-dhjetor 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka trajtuar **116** materiale penale, **31** mosfillime penale, **1**(një) kallëzim është dërguar për kompetencë tokësore, **84** procedime penale, nga këto rezultojnë **8** procedime penale të pezulluara, **2** procedime penale janë pushuar, **17** procedime penale janë dërguar në gjykatë dhe **55** procedime penale janë në hetim.

Janë aplikuar **në 5(pesë)** procedime penale metodat speciale të hetimit. Në lidhje me luftën kundër kriminalitetit, gjatë periudhës objekt raportimi, një vëmendje dhe kujdes i veçantë i është kushtuar edhe veprave penale në fushën e narkotikëve, kundër pasurisë kundër personit etj dhe sipas të dhënave rezultojnë se janë regjistruar procedime penale, veprën penale të "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*", "*Kultivimi i bimëve narkotike*" neni 283/2 dhe 284/2 Kodit Penal dhe procedim penal është regjistruar për veprën penale "*Vrasja me dashje*" të parashikuar nga neni 76 i Kodit penal dhe për veprën penale të "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*" të parashikuar nga neni 283/2 Kodit Penal, me 12 persona nën hetim me masa sigurimi shtrënguese personal në fuqi. Në **3(tre)** raste këto metoda hetimore janë përdorur gjatë periudhës janar-prill 2023 pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në vijim në **2(dy)** raste në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, maj-dhjetor 2023.

Gjatë periudhës objekt raportimi, një vëmendje dhe kujdes i veçantë i është kushtuar veprave penale në fushën e narkotikëve, kundër pasurisë, kundër personit. Gjithashtu evidentohet procedimi penal për veprat penale "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*" të parashikuar nga neni 283/2 i Kodi Penal, "*Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve dhe municionit*" neni 278/1-25 K.Penal, "*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*" të parashikuar nga neni 236/1 të Kodit Penal, "*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, duke u arrestuar në flagrancë 3 shtetas si rezultat i hetimeve sipas metodave speciale në këto hetime edhe me agjent të infiltruar. Hetimet për këto raste janë përfunduar, çështja është dërguar në gjykatë me akuzë, duke u deklaruar fajtor nga Gjykata e Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Gjatë periudhës janar-prill 2023, ka hetuar **1** procedim penal, të dërguar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, ku është aplikuar dhe pranuar gjykimi me marrëveshje. Për **1 (një)** procedim penal të dërguar pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është aplikuar dhe pranuar gjykimi i drejtpërdrejtë.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur **1 (një)** një rast pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ku gjykata është shprehur për heqjen e përgjegjësisë prindërore. Ka pasur **2 (dy)** raste të aplikimit të masës mjekësore.

Ka marrë pjesë në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, në temat:

- *Bashkëpunëtori i jashtëm. Praktika gjyqësore vendase dhe e huaj. Bashkëpunëtori i drejtësisë, kriteret e njohura për deklarimin si të tillë, roli në zbulimin e veprimtarisë kriminale të kryer nga organizmat kriminalë. Praktika gjyqësore.*
- *Hetimi proaktiv. Kuadri ligjor. Burimet e informacionit për hetimet kriminale të bazuara në inteligjencë dhe marrëdhëniet e prokurorit me shërbimet pas administrimit të informacionit prej tyre....*
- *Lirimi me kusht. Kushtet e lejimit, kriteret ligjore që duhen përmbushur. Dënimi me burgim të përjetshëm dhe përllogaritjet e kohës së vuajtjes së dënimit. Periudha e sigurisë dhe lirimi me kusht. Përsëritja në krim, sjellja e të dënuarit në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe marrëdhënies autorë-viktimë si elemente thelbësore të raportit të vlerësimit të shërbimit të provës. ...*
- *Roli i prokurorit në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Gjykata kompetente e trajtimit të kërkesave përgjatë ekzekutimit të vendimit. Jurisprudenca vendase dhe GJEDNJ-së, konstatimet dhe interpretimet lidhur me kërkesat apo të drejtat themelore të pretenduara të cenuara nga të dënuarit në fazën e ekzekutimit.*
- *Gjykimi në mungesë. Dallimi i mungesës objektive nga mospjesëmarrja ose shmangia e gjykimit. Rëndësia e tyre në raport me rishikimin, neni 450 i Kodit të Procedurës Penale. Jurisprudenca vendase dhe e GJEDNJ-së. Rivendosja në afat e ankimit në rastin e gjykimit në mungesë.*
- *Hetimi dhe gjykimi i veprave penale që lidhen me cenimin e pronësisë intelektuale. Trajtimi i elementeve civile që lidhen me dëmin në këtë procedurë.*
- *Seanca paraprake në tërësinë e saj. Praktika gjyqësore e deritanishme. Neni 332/d, vendimi i seancës paraprake dhe konsekuencat e tij për vazhdimësinë e procedimit të filluar nga prokurori;*
- *Raportet procedurale dhe kompetenca ligjore e GJHP-së, GJSP-së dhe GJTH-së. Kufijtë e veprimtarisë së secilit në një proces penal. Praktika gjyqësore e deritanishme. Kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake referuar parashikimeve të nenit 329/4 të Kodit të Procedurës Penale. Dallimi i kësaj kompetence me atë të parashikuar në nenin 329.3/ctë Kodit të Procedurës Penale.*
- *Prokurimi publik. Trajtimi i rasteve dhe hetimi efektiv i veprave penale që lidhen me fushën e prokurimeve publike, prishjen e barazisë në tender dhe me mospagimin e taksave dhe tatimeve. Pabarazia në tendera. Marrëveshjet në oferta në procedurat e prokurimit publik;*
- *Metodika dhe teknikat e hetimit të krimit kibernetik. Administrimi i provave kompjuterike dhe sekuestrimi i pajisjeve që mbartin prova dhe të dhëna që lidhen me teknologjinë në këtë fushë.*

Prokurori Ndricim Halilaj :

Rezulton me 286 procedime penale dhe kallëzime të trajtuara. Është caktuar prokuror në Seksionin e 2, Seksionin për të miturit dhe dhunën në familje, etj, gjatë gjithë vitit 2023. Ka qenë prokurori më i ngarkuar në këtë seksion dhe nga më të ngarkuarit në prokurori, kjo edhe për shkak të marrjes së dosjeve të mbartura dhe për shkak marrjes me short

manual edhe të dosjeve të dorëzuara nga prokurorët e tjerë. Në vijim ka marrë dosje me short elektronik dhe manual dhe se ka pasur edhe çështje të bashkuara. Rezulton se ka përfunduar një numër të lartë të dosjeve në verifikim dhe hetim 253 çështje, duke mos llogaritur çështjet e rifilluara dhe të pushuara për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjatë vitit 2023, ndër të tjera ka hetuar me metoda speciale dhe hetime proaktive 7 procedime penale, përgjim telefonik përgjim ambjental, vëzhgim ambjental etj. Ndër to rezultate të suksesshme në hetime ka dhënë përgjimi ambjental.

Procedimet penale, me nr.556/2023 dhe nr.1263/2023, janë rregjistruar kryesisht nga ana e prokurorit mbi bazën e të dhënave dhe materialeve në media e rrjete sociale, pamvarësisht se më pas janë sjellë materiale shtesë nga ana e Komisarariatit të Policisë Shkodër, duke treguar vigjilencën dhe reagimin e shpejtë të prokurorit. Në lidhje me informacione ku janë përfshirë të mitur, apo rast të mashtrimit ndaj personave të ndryshëm.

Nga ana e prokurorit është hetuar dhe gjykuar 1 procedim duke u dërguar në gjykatë me marrëveshje fajësie dhe 1 procedim penal me Urdhër Penal.

Duke qenë pjesë e seksionit për të mitur, ndër të tjera ka hetuar 14 procedime penale me të mitur ku ka marrë vendime për paralajmërim me shkrim, këshillim, si dhe ndjekjen e kurseve dhe trajnimeve të të miturve, duke marrë masën e shmangies nga ndjekja penale dhe pushimin e çështjes me të mitur në konflikt me ligjin.

Gjatë gjykim në 1 rast ka kërkuar masë mjekësore ndaj subjektit të papërgjegjshëm. Gjithashtu ka përfaqësuar 2 çështje në gjykatë me të dëmtuar akuzues sipas parashikimeve të nenit 59 e vijues të K.Pr.Penale.

Ka hetuar një sërë procedimesh penal duke kryer veprime të drejtëpërdrejta dhe në vijimësi, sin ë procedimet penale me nr.2211/2019, nr.1755/2019. Gjithashtu, ka hetuar procedimin penal me nr.193/2023 dhe me nr.1673/2022, ku nga prokurori janë kryer veprime hetimore personalisht dhe në vijimësi deri në provueshmërinë e autorësisë së veprës penale.

Ka përfaqësuar prokurorinë në gjykatë në 20 çështje me të dëmtuar akuzues sipas nenit 59 të K.Pr.Penale, si dhe në kërkesat për rivlerësim të masave mjekësore.

Është pjesëmarrëse në trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit me tema:

- *Fillimi kryesisht i procedimit penal dhe pavarësia e prokurorit. Kuadri ligjor. Rastet dhe procedura që ndiqet për regjistrimin e procedimit kryesisht. Standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare;*
- *Shfrytëzimi seksual online i të miturve dhe metodat e hetimit. Raste të praktikës gjyqësore. Problematikat dhe sfidat në luftën kundër shfrytëzimit seksual të të miturve;*
- *Zbatimi i "Masave mjekësore dhe edukuese", neni 46 i Kodit Penal. Kërkesa e prokurorit për caktimin e masave mjekësore ndaj personave të papërgjegjshëm sipas nenit 46 të Kodit Penal. Gjykata kompetente e shqyrtimit;*
- *Seanca paraprake në tërësinë saj. Praktika gjyqësore e deritanishme. Neni 332/d, vendimi i seancës paraprake dhe konsekuencat e tij për vazhdimësinë e procedimit të filluar nga prokurori;*

- *Metodika dhe teknikat e hetimit të krimit kibernetik. Administrimi i provave kompjuterike dhe sekuestrimi i pajisjeve që mbartin prova dhe të dhëna që lidhen me teknologjinë në këtë fushë;*
- *Kontrolli i vendeve dhe banesës, rëndësia e tyre për suksesin e procedimit penal. Lidhja e këtij mjeti të kërkimit të provës me llojin e veprës penale për të cilën procedohet dhe "detyrueshmëria" e zbatimit të tij në rastet e veprave penale të veçanta. Standardi kushtetues dhe procedural i kontrollit të banesës, jurisprudenca e gjykatave shqiptare dhe GJEDNJ-së;*
- *Kuptimi i veprave penale të reja që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe ndërtimeve. Trajtimi i rasteve praktike lidhur me veçoritë në hetimin e veprave penale në këtë fushë;*
- *Krimi kibernetik. Kuadri ligjor. Metodika dhe teknikat e hetimit, administrimi i provave kompjuterike dhe sekuestrimi i pajisjeve që mbartin prova dhe të dhëna që lidhen me teknologjinë në këtë fushë. ...*
- *Veprat penale të korrupsionit. Teknikat e hetimit të veprave penale të korrupsionit. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive në kuadër të ligjit "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet asave parandaluese kundër pasurisë";*
- *Parimi i barazisë, mosdiskriminimit dhe krimet e urrejtjes;*
- *Training Skill Certification program for judges and prosecutors. Sharing Electronic Evidence in International Investigations (Maqedonia e Veriut);*
- *Seminar mbi Pastrimin e Parave, Hetimin Financiar dhe Asistencën e Ndërsiellte Juridike të zhvilluar nga ekspertë Spanjoll.*
- *Parandalimi dhe mbrojtja nga trafikimi i të miturve shqiptarë të pashoqëruar në Francë. vizitë studimore të zhvilluar në Lyon, Francë.*

Prokurore Besmira Vishe :

Rezulton me 189 procedime penale dhe kallëzime të trajtuara, gjatë vitit 2023. Është caktuar prokurore në seksionin e 3, Seksionin e Posaçëm gjatë gjithë vitit 2023. Ka marrë çështje me short manual nga dosjet e dorëzuara nga prokurorët e pezulluar. Në vijim ka marrë çështje kryesisht me short elektronik. Ka mbajtur një ngarkesë të konsiderueshme të dosjeve të seksionit të posaçëm së bashku me drejtuesen Blerta Hamza. Ka përfunduar një pjesë të madhe të dosjeve të marra prej 132 çështjesh.

Nga totali i procedimeve penale të hetuara prej saj, rezulton se 39 procedime penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, 36 procedime penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e procedimit, 16 janë pezulluar me vendim të prokurorit dhe 4 procedime janë dërguar për moskompetencë tokësore/lëndore.

Nga procedimet e dërguara në gjykim rezulton se për tre prej tyre prokurori ka paraqitur kërkesë për miratim të marrëveshjes të pranimit të fajësisë dhe dënimit, të cilat janë pranuar nga gjykata.

Një procedim është kryer me gjykimin e posaçëm të drejtpërdrejtë. Nga procedimet e dërguara në gjykim rezulton se dy prej tyre është kërkuar caktimi i masës mjekësore.

Nga verifikimet rezulton se në 9 procedime penale janë përdorur mjetet proaktive të kërkimit të provës sikurse janë përgjimi telefonik, përgjimi ambjental dhe vëzhgimi.

Gjatë vitit 2023, ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit. Temat e trajnimit fokusoheshin në Migracioni dhe e Drejta për Azil, Pastrimi i parave dhe hetimi pasuror (organizuar nga EU4Focal), E drjeta e mjedisit (organizuar nga Shkolla e Magjistraturës së Francës), format e krimit të kryera përmes internetit dhe kriptomonedhat (organizuar nga EU4Focal), Trajnim mbi të drejtat e njeriut (organizuar nga EU4Focal), te drejtat themelore në BE (organizuar nga EIPA Luksenburg), trafikimi i armëve nëpërmjet sistemit postar (organizuar nga UNODC Global), Parimi i barazisë mosdiskriminimit dhe krimet e urrejtes, Raporti i krimit dhe komunikimi i publikut me drejtësinë dhe institucionet e mbyllura. Rëndësia e të vërtetës paraqitur në burimet e hapura. Sekretet hetimor dhe përgjegjësia që rrjedh prej tij, si dhe një sërë trajnimesh të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Prokurore Entela Hasmujaj :

Rezulton me **302** procedime penale dhe kallëzime të trajtuara, gjatë vitit 2023. Është caktuar prokurore në seksionin e 1, Seksionin e Përgjithshëm gjatë vitit 2023, ndërsa nga data 12.12.2023 e në vijim është caktuar Drejtuese e seksionit “Për veprat penale të kryera nga të miturit e ndaj tyre...”. Ka marrë çështje me short manual nga dosjet e dorëzuara nga prokurorët e pezulluar. Në vijim ka marrë çështje kryesisht me short elektronik. Ka mbajtur një ngarkesë të konsiderueshme të dosjeve të seksionit të përgjithshëm. Ka përfunduar një pjesë të madhe të dosjeve të marra prej 243 çështjesh.

Gjithashtu, ka regjistruar dhe hetuar **6** procedime penale **proaktive dhe me metoda speciale të hetimit**, kryesisht lidhur me vepra penale në fushën e kultivimit të bimëve narkotike dhe krimet kundër jetës;

Ndër materialet e hetuara gjatë vitit 2023: - Ka hetuar dhe marrë të pandehur për kryerjen e **krimeve të rënda kundër pasurisë** (vjedhje, mashtrim) **8** persona. Ka hetuar dhe marrë të pandehur për kryerjen e **veprave penale kundër rendit e sigurisë publike** (Kultivim i bimëve narkotike, prodhim dhe shitje e narkotikëve, trafikim i narkotikëve) **11** persona. Ka hetuar dhe marrë të pandehur për kryerjen e **vepra penale kundër autoritetit të shtetit** **5** persona.

Veçojmë si dosje të veçantë të ndjekur në gjykim për shkak të kompleksitetit të saj, distancës kohore të kryerjes së veprës penale dhe kohës së gjykimit, konkretisht procedim viti 24/ 2002, i regjistruar për veprën penale “*Vrasje me paramendim*”, parashikuar nga neni 78 i K.Penal, fakti penal i ndodhur në vitin 2001 në shtetin Belg.

Në hetim veçojmë procedimin penal Nr. 942/2023, i regjistruar për veprën penale “Kultivim i bimëve narkotike” dhe “Prodhim e shitje e narkotikëve”, parashikuar nga nenet 284 e 283 të Kodit Penal, ku janë asgjesuar 11,274 bimë narkotikë cannabis sativa në Nj.Adm. Shalë dhe është arritur identifikimi i autorëve, ku numri e personave nën hetim është **15** (pesëmbëdhjetë), për të cilët janë caktuar masa sigurimi personal.

Nga llojet e gjykimeve të posaçme është aplikuar gjykimi me me marrëveshje në **3** raste. Në **2** raste për shkak të papërgjegjshmërisë së subjektit të veprës penale është caktuar masa mjeksore shtrim i detyruar në spital psikiatrik në njërin rast dhe në rastin tjetër mjekim i detyruar ambulator.

Është pjesëmarrëse në **6** trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, me tema:

- *“Shfrytëzimi seksual online i të miturve dhe metodat e hetimit. Raste të praktikës gjyqësore. Problematikat dhe sfidat në luftën kundër shfrytëzimit seksual të të miturve”, dt. 26.01.2023;*
- *“Seanca paraprake në tërësinë e saj. Praktika gjyqësore e deritanishme. Neni 332/d, vendimi i seancës paraprake dhe konsekuencat e tij për vazhdimësinë e procedimit të filluar nga prokurori”, dt.5-6 Prill 2023;*
- *“Krimi kibernetik. Aktet me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike”, dt. 18-19 Maj 2023;*
- *“Aftësitë e Prokurorëve për Paraqitjen e Çështjes në Gjyq” “prane ambienteve të Shkolles së Magjistratures” trajnim i përbashkët me Prokurorinë Themelore të Kosovës, dt. 25 Tetor 2023.*
- *“Parimi i barazisë, mosdiskriminimit dhe krimet e urrejtjes”, trajnim datë 25 Maj 2023;*
- *“Masat mjeksore”, dt.31 Tetor 2023;*

Prokurore Albulena Kuliçi :

Rezulton me 283 procedime penale dhe kallëzime të trajtuara, gjatë vitit 2023. Është caktuar prokurore në seksionin e 2, Seksionin për të miturit, dhunën në familje, etj, gjatë gjithë vitit 2023. Ka marrë çështje me short manual nga dosjet e dorëzuara nga prokurorët e pezulluar. Në vijim ka marrë çështje kryesisht me short elektronik. Ka mbajtur një ngarkesë të konsiderueshme të dosjeve të seksionit të dytë. Ka përfunduar një pjesë të madhe të dosjeve të marra prej 199 çështjesh.

Gjatë kësaj periudhe ka hetuar 5 procedime penale duke përdorur metoda special të hetimit dhe hetimet proaktive.

Gjatë kësaj periudhe ka hetuar dhe dërguar për gjykim 1 procedim penale me marrëveshje për pranimin e fajësisë. Gjithashtu ka hetuar dhe dërguar për gjykim 2 procedime penale me Urdhër Penal.

Duke qenë pjesë e seksionit për të mitur, ndër të tjera ka hetuar 12 procedime penale me të mitur ku ka marrë vendime për paralajmërim me shkrim, këshillim, si dhe ndjekjen e kurseve dhe trajnimeve të të miturve, duke marrë masën e shmangies nga ndjekja penale dhe pushimin e çështjes.

Gjatë gjykim në 1 rast ka kërkuar masë mjekësore ndaj subjektit të papërgjegjshëm. Gjithashtu ka përfaqësuar 2 çështje në gjykatë me të dëmtuar akuzues sipas parashikimeve të nenit 59 e vijues të K.Pr.Penale.

Është pjesëmarrëse në trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, me tema:

- *Fillimi kryesisht i procedimit penal dhe pavarësia e prokurorit. Kuadri ligjor. Rastet dhe procedura që ndiqet për regjistrimin e procedimit kryesisht. Standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare.*
- *Shfrytëzimi seksual online i të miturve dhe metodat e hetimit. Raste të praktikës gjyqësore. Problematikat dhe sfidat në luftën kundër shfrytëzimit seksual të të miturve.*

- *Seanca paraprake në tërësinë e saj. Praktika gjyqësore e deritanishme. Neni 332/d, vendimi i seancës paraprake dhe konsekuencat e tij për vazhdimësinë e procedimit të filluar nga prokurori.*
- *Krimi kibernetik. Aktet me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike. ... Provat elektronike për hetimin e krimit kibernetik.*
- *Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria – si element i anës subjektive i figurës së veprës penale. Përgjegjshmëria penale e kufizuar, në rastin e turbullimit psikik ose neuropsikik që ul ekuilibrin mendor. Roli i ekspertimit mjekësor (psikik ose neuropsikik) në të dy rastet.*
- *Krijimi i turmave të armatosua, banda e armatosur dhe prodhimi i armëve luftarake.*

Prokuror Adnan Hoxha :

Rezulton me **86** procedime penale dhe kallëzime të trajtuara, ku është caktuar prokuror pranë kësaj prokurorie me vendim transferimi të KLP-së, me efekt në Tetor 2023. Në periudhën Tetor-Dhjetor, në fillim ka marrë çështje me short manual nga dosjet e dorëzuara nga prokurorët e pezulluar apo nga dosjet e prokurorëve të tjerë të mbingarkuar. Është caktuar prokuror në seksionin e 1, Seksionin e Përgjithshëm në këtë periudhë më pak se 3 mujore. Në vijim ka marrë çështje kryesisht me short elektronik. Ka përfunduar një pjesë të dosjeve të marra gjatë kësaj periudhe të shkurtër, prej 26 çështjesh.

Gjithashtu, ka përfaqësuar në gjykatë 4 çështje me të dëmtuar akuzues sipas nenit 59 të K.Pr.Penale, dhe 29 çështje të prokurorëve që nuk ushtrojnë më detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Është angazhuar si **lehtësues** në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës në 1 ditë, në trajnimin me temë “Krimet kibernetike dhe gjuha e urrejtjes në internet”, dhe si **pjesëmarrës në 15 trajnime** të tjera të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, OSBE, Shkolla e Magjistraturës Francë etj.

Prokuror Ledion Tema :

Rezulton me **78** procedime penale dhe kallëzime të trajtuara, ku është caktuar prokuror pranë kësaj prokurorie me vendim transferimi të KLP-së, me efekt në Tetor 2023. Në periudhën Tetor-Dhjetor, në fillim ka marrë çështje me short manual nga dosjet e dorëzuara nga prokurorët e pezulluar apo nga dosjet e prokurorëve të tjerë të mbingarkuar. Është caktuar prokuror në seksionin e 1, Seksionin e Përgjithshëm në këtë periudhë më pak se 3 mujore. Në vijim ka marrë çështje kryesisht me short elektronik. Ka përfunduar një pjesë të dosjeve të marra prej 34 çështjesh dhe materialesh.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka përfaqësuar në gjykatë 1 çështje me të dëmtuar akuzues sipas nenit 59 të K.Pr.Penale, 1 çështje të ardhur në gjykim për kompetencë tokësore nga një gjykatë tjetër dhe 29 çështje të prokurorëve që nuk ushtrojnë më detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për shkak të pezullimit apo komandimit, etj.

Gjatë vitit 2023, ka marrë pjesë në rreth 15 trajnime në kuadër të trajnimit vazhdues, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, UN, OSCE, etj.

Prokurore Marsida Frashëri :

Rezulton me 70 procedime penale dhe kallëzime të trajtuara në periudhën Tetor- Dhjetor. Është ri-kthyer si prokurore pranë kësaj prokurorie me vendim të K.P.K-së dhe të KLP-së, me efekt në Tetor 2023, pasi ka qenë e pezulluar. Në periudhën Tetor-Dhjetor, në fillim ka marrë çështje me short manual nga dosjet e dorëzuara nga prokurorët e pezulluar apo nga dosjet e prokurorëve të tjerë të mbingarkuar. Është caktuar prokurore në seksionin e 1, Seksionin e Përgjithshëm në këtë periudhë më pak se 3 mujore. Në vijim ka marrë çështje kryesisht me short elektronik. Ka përfunduar një pjesë të dosjeve të marra prej 13 çështjesh.

Ka përfaqësuar në gjykim dosjet e dorëzuara nga prokurorët e tjerë, të pezulluar, apo të komanduar.

Ka marrë pjesë në trajnime të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës;

Prokurori Agron Bushati :

Nuk rezulton me procedime penale të trajtuara gjatë vitit 2023, ka vetëm një procedim penal të mbartur për arsye letërporosie dhe në proces përfundimi. Nga janari 2023 deri në fund të vitit 2023 ka mbajtur detyrën e prokurorit dhe Drejtuesit të Zyrës së Ekzekutimeve dhe për shkak të ngarkesës me urdhëra ekzekutimi, marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, kërkesat në fazën e ekzekutimit të vendimeve është përjashtuar nga shorti manual dhe elektronik. Duke kryer detyrat e fazës së ekzekutimit dhe të marrëdhënieve me jashtë, si dhe përfaqësimit në gjykim të të gjitha çështjeve në lidhje me fazën e ekzekutimeve dhe marrëdhënieve me jashtë.

Sa më sipër, sqarojmë se gjatë këtij viti është synuar edhe në balancimin e ngarkesës mes prokurorëve dhe seksioneve por përveç faktit që ka një përmirësim nga viti i mëparshëm duhet pranuar se balancimi dhe shpërndarja e ngarkesës në mënyrë të barabartë ka qenë e pamundur të realizohet plotësisht për shumë arsye. Ku konstatohet një diferencë mes disa prokurorëve. Ku prokurorët e seksionit të parë kanë qenë më të ngarkuarit, më pas janë prokurorët e seksionit të dytë dhe të miturit, më pak të ngarkuar përse i përket numrit kanë qenë prokurorët e seksionit të posacëm por rëndësia, volumi dhe kompleksiteti i këtyre dosjeve justifikojnë ngarkesën e tyre.

Nga ana tjetër, një prokuror ka filluar detyrën gjatë muajit maj 2023 dhe tre prokurorë kanë filluar detyrën duke marrë ngarkesë gjatë muajit tetor 2023.

Gjithashtu, Diferenca me numrin e dosjeve të trajtuara nga prokurorët të ndryshëm, ka ndodhur për disa arsye, si nga koha e ushtrimit të funksionit, lejet, pezullimet, komandime, nga ndryshimi i seksioneve, dosjet e marra gjatë gadishmërisë, procedimet e bashkuara, etj.

Gjithashtu, ka ndodhur edhe për shkak të numrit të kallëzimeve penale të mosfilluara të cilat ndryshojnë në varësi të vendimarrjes. Numrit të çështjeve të mbartura nga secili prokuror në vitin e mëparshëm. Gjithashtu, ka ndikuar edhe fakti se një pjesë të kohës shorti është hedhur manualisht dhe se disa prokuror kanë qenë me leje apo janë përjashtuar nga shorti për shkak të ngarkesës me dojtë të vjetra në hetim, dosje të vitit

2022 apo të viteve të mëparshme. Kjo ka ndodhur në periudha të caktuara apo edhe për shkak të zëvendësimeve të prokurorëve për arsye të ndryshme ligjore.

Gjithashtu, në rastet e largimit, transferimit apo pezullimit të prokurorëve, dosjet e dorëzuara prej tyre janë hedhur me short manual jo mes të gjithë prokurorëve por bazuar në seksionet përkatëse, për aq sa ka qenë e mundur.

❖ **Ngarkesa e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve gjatë vitit 2023.**

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, edhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve kanë patur një ngarkesë të konsiderueshme. Në prokurori gjatë vitit 2023 kanë qenë 17 oficerë të policisë gjyqësore që janë ndarë në seksione dhe kanë përballuar një ngarkesë të lartë pune në raport me tërësinë e materialeve të hetuara gjatë vitit nga kjo prokurori.

Më poshtë po japin në një tabelë përmbledhese të dhënat e ngarkesës së secilit prej oficerëve të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër:

NR	OF.POL. GJYQËSORE	SEK	ÇËSHTJET	PËRFUND	HETIM
1	Diana Tahiraga	Sek 1	153	136	17
2	Fatmira Vata	Sek 1	132	120	12
3	Suela Kërxfhaliu	Sek 2	131	111	20
4	Çlirim Halili	Sek 1	130	125	5
5	Kozeta Çomo	Sek 3	130	123	7
6	Benardin Ndoj	Sek 3	122	81	41
7	Nuredin Dunisha	Sek 2	114	96	18
8	Artor Muja	Sek 3	111	89	22
9	Bledar Vujoshi	Sek 1	97	78	19
10	Skender Dodaj	Sek 3	78	59	19
11	Eriselda Kraja	Sek 2	77	75	2
12	Tonin Marku	Sek 3	76	58	18
13	Lorena Kosteri	Sek 2	76	55	21
14	Xhelal Bajraktari	Sek 1	74	56	18
15	Valbona Kalaci	Sek 1	73	69	4
16	Kujtim Livalli	Sek 4	9	8 + Urdhëra Ek. 623 + 16 + 75	1
17	Hasan Hasani	Sek 4	25	24 + Urdhëra Ek. 117 + 4 + 5	1
	TOTALI		1608	1363	245

Nga sa më sipër rezultojnë se oficerët e seksioneve kanë trajtuar **1608 çështje** ose rreth 60 % të procedimeve penale të trajtuara gjatë vitit 2023 në prokurori, si dhe një numër të lartë të kallzimeve penale që u janë deleguar për verifikim, ndërsa pjesa tjetër prej 40 % është trajtuar nga oficerët e shërbimeve në Drejtori Vendore të Policisë, në Komisariate dhe shërbimet e tjera të policive gjyqësore. Në lidhje me çështjet e përfunduara gjatë këtij viti rezultojnë se kanë relatuar për përfundim **1363 çështje** të ndryshme që përbëjnë 84 %

të çështjeve të mara në hetim nga oficerët e seksioneve ose rreth 50 % e të gjitha procedimeve të përfunduara nga Prokuroria gjatë vitit 2022.

Janë mbartur për në vitin 2024, rreth 245 çështje nga oficerët e seksioneve të cilat përbëjnë rreth 35 % të të gjitha dosjeve të mbartura në Prokurori. Këto të dhëna tregojnë për një punë të mirë të bërë nga oficerët e policisë gjyqësore në prokurori dhe nga ana tjetër është dukshëm më e mirë dhe më efciente se puna dhe hetimet e kryera nga policia gjyqësore e shërbimeve në Drejtori, Komisarati apo të shërbimeve të institucioneve të tjera edhe pse numri i oficerëve të tyre në total është 2 apo 3 herë më i madh.

Sqarojmë se, oficerët e policisë gjyqësore Kujtim Livalli dhe Hasan Hasani kanë qenë gjatë gjithë vitit 2023, pjesë e zyrës së ekzekutimeve ku ka bërë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në lidhje me provat materiale, të urdhërave dhe të letërporosive, në lidhje me njoftimet e të dënuarve, paralajmërimin e tyre, etj. Gjatë kësaj periudhe kanë ekzekutuar urdhëra për kthim provash. Kanë ekzekutuar urdhëra për asgjësim provash. Ka ndjekur zbatimin e vendimeve të gjykatës dhe urdhërat në lidhje me 623 praktika ekzekutimi dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal. Ka proceduar me ekzekutimin e 42 letërporosive nga jashtë shteti, si dhe procedura të tjera ekzekutimi urdhërash gjatë fazës së ekzekutimit.

Oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të parë kanë pasur efcensë më të lartë duke vlerësuar edhe çështjet më të lehta që ata hetojnë.

Rezulton se edhe oficerët e Seksionit të Miturve dhe dhunës në familje ka mbajtur dhe kanë trajtuar një numër të lartë të çështjeve të deleguara duke paraqitur të dhëna dhe statistika më të mira se një vit më parë.

Nga ana tjetër oficerët e policisë gjyqësore të Seksionit të Posaçëm kanë punuar shumë, ku duhet pranuar dhe theksuar se dosjet e hetuara prej këtij seksioni karakterizohen nga vështirësia e lartë, volume dhe zgjatja në kohë e tyre, fakt që është evidentuar në vijimësi edhe në vitet e mëparshme.

Të gjithë oficerët e policisë gjyqësore kanë ndjekur seminare dhe trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucione dhe organizata të tjerë, qoftë për tema sipas seksioneve që u përkasin ashtu edhe për tema të cilat i kanë vlerësuar të nevojshme apo që kanë evidentuar mangësi gjatë punës së tyre.

❖ Administrimi i Prokurorisë gjatë vitit 2023.

- Gjatë vitit 2023, puna e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shakallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në një masë të rëndësishme bazohet edhe në punën e administratës së saj. Gjatë këtij viti është punuar edhe në drejtim të përmirësimit të punës së administratës dhe imazhit të saj.
- Nëpërmjet urdhërave, udhëzimeve dhe mbledhjeve është kërkuar dhe orientuar në vijimësi drejt përmirësimit të shërbimeve dhe punës së administratës qoftë në dhënie e informacioneve apo në përgjigjen e kërkesave të subjekteve të ndryshme ashtu edhe në drejtim të mbajtjes së regjistrave të ndryshëm, në lidhje me komunikimet me institucionet e ndryshme, me subjektet dhe me vetë nëpunësit e kësaj prokurorie. Gjithashtu, është kërkuar përgjegjshmëri dhe kujdes në mbajtjen dhe raportimin periodik

të të dhënave dhe statistikave të Prokurorisë, në protokollimet dhe kthimet e përgjigjeve ndaj institucioneve të ndryshme dhe qytetarëve, etj.

- Në vijimësi duhet një angazhim në rritje, me qëllim sigurimin dhe mbajtjen në kohë reale të dhënave të sakta dhe të plotë të të gjithë treguesve dhe të databazave të prokurorisë.
- Është punuar në drejtim të mirëmbajtjes dhe përdorimit të plotë të sistemit CAMS të menaxhimit të çështjeve, megjithë problematikat dhe defektet e evidentuar në disa periudha të mosfunksionimit të tij. Gjithashtu po punohet në drejtim të përdorimit të sistemit të ri E-Tracking PRESTO.
- Janë orientuar prokurorët, policia gjyqësore dhe në veçanti administrata sipas funksioneve që ata kanë, në mbajtjen sa më të rregullt dhe të saktë të arkivave, të provave materiale, si dhe në lidhje me disponimin e tyre, mbajtja e qëndrimeve uniforme në lidhje me sekuestrimet, lënien në ruajtje të tyre, konfiskimet apo kthimin e tyre pronarëve të ligjshëm është një detyrë që mbetet për tu përmirësuar dhe unifikuar.
- Përsa i përket respektimit të disiplinës në punë dhe të etikës nga ana e punonjësve të Prokurorisë, janë nxjerrë urdhëra dhe janë kryer verifikime dhe gjithashtu është kërkuar në vijimësi respektimi i disiplinës në punë, respektimi i kodit të etikës, gjithashtu u është tërhequr vërejtje dhe janë marrë masa të tjera disiplinore apo kërkesa llogarie kur është konstatuar devijim nga respektimi i këtyre detyrimeve ligjore. Megjithatë, vlerësojmë se mbetet detyrë e vazhdueshme kontrolli dhe llogaridhënia dhe nga ana tjetër marrja e masave të tjera qoftë nga ana e urdhërave dhe udhëzimeve ashtu edhe në kontrollin faktit të disiplinës.
- Konstatojmë se mungesa e **Kancelarit të Prokurorisë** mbetet një problem dhe mangësi që është ndjerë në vazhdimësi dhe ka krijuar problematika dhe vështirësi në ushtrimin e detyrave administrative në prokurori. Një mangësi që shpresojmë të zgjidhet në vijim.
- Në aspektin financiar vlerësojmë se është synuar në respektimin me rigorozitet të parashikimeve ligjore dhe nënligjore në administrimin e fondeve buxhetore. Mendojme se shtimi i buxhetit për disa zëra do të ndihmonte në përmirësimin e punës së prokurorisë qoftë përsa i përket bazës materiale, kompjutera, printera, fotokopje, etj, ashtu edhe në pajisjet moderne, si dhe në administrimin e sistemeve të institucioneve të ndryshme me qëllim kryerjen e hetimeve të plota dhe të gjithëanshme, si dhe në lidhje me ekspertimet, eksperimtet hetimore, etj, për të cilat kërkohen njohuri nga ekspertë të fushave të ndryshme, përkthyes, psikologë, ndihmës të tjerë dhe grupe hetimore, si dhe veprime të shumta hetimore, të cilat në tërësinë e tyre kërkojnë shpenzime më të mëdha, etj.
- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Shkodër gjatë vitit 2023 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike – financiare janë çelur dhe shpenzuar fondet si vijon:

Raporti i shpenzimeve sipas programit për vitin 2023.

Fondi i akorduar për këtë program në fillim të vitit është 137,900 mijë lekë përfaqëson shpenzimet korrente, ndërsa buxheti i rishikuar për vitin 2023 është 210.821 mijë lekë dhe shtesa prej 72.921 mijë lekë

000/Lekë

PROGRAMI 01110	BUXHE TI FILLIM TË VITIT 202 3	BUXHETI I RISHIKU AR VJETOR 2023	REALIZI MI PËR VITIN 2023	% E REALIZIM IT
Planifikim, Menaxhim , Administri m	137.90 0	210.821	210.781	99.98%

Për vitin 2023 për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, buxheti i planifikuar është 210.821 mijë lekë, ndërsa realizimi është 210.781 mijë lekë ose realizuar në masën 99.98 % (të rakorduara edhe me sistemin AFMIS).

Emertimi	Struktura organizative Viti 2023	Struktura faktike ne fund te Vitet 2023	Diferen ca
Prokurorë/magjistratë	20	18	2
Oficerë të policisë Gjyqësore	17	17	-
Administratë	23	23	-
TOTALI	60	58	2

Nga numri faktik prej 20 prokurorë, ku vetëm 14 janë në detyrë, pasi 4 prokurorë janë pezulluar nga KPK dhe paguhen me 75%, një prokurore është e komanduar në Apel, një prokuror i emëruar në KLP.

Aneksi-2.Raporti i shpenzimeve të programit sipas artikujve për vitin 2023.

Lekë

PROGRAMI 01110	BUXHETI NË FILLIM TË VITIT 2023	BUXHETI I RISHIKUAR VJETOR 2023	REALIZIMI PER VITIN 2023	% E REALIZIMIT
Shpenzime korrente				
Shpenzime korrente artikulli Paga (600)	109.900.000	179.157.330	178.156.452	100

Shpenzime korrente artikulli Sigurime shoqërore (601)	13.650.000	15.945.000	15.906.763	99.76
Shpenzime korrente artikulli Shpenzime operative (602)	14.350.000	15.352.393	15.352.267	100
Shpenzime korrente artikulli Tranferta per buxhetet familjare (606)		365.868	365.868	100
TOTALI	137.900.000	210.820.591	210.781.350	99.98

“Artikulli 600 + 601” - Buxheti vjetor në “Shpenzime personeli” për këtë program në fillim të vitit është 123.550 mijë lekë. Buxheti i rishikuar për vitin është 195.103 mijë lekë dhe realizimi faktik 194.063 mijë lekë ose realizuar në masën 99.47% (të rakorduara edhe me sistemin AFMIS).

“Artikulli 602” - Buxheti vjetor i alokuar në “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” për këtë program është 14.350 mijë lekë, Për vitin 2023 buxheti është 15.352 mijë lekë dhe është realizuar 15.352 mijë lekë ose në masën 100% (të rakorduara edhe me sistemin AFMIS). Ky fond ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të institucionit me materiale e shërbime zyre si dhe janë kryer likuidimet e 5.408 mijë lekë dhe shpenzimet për ruajtjen fizike të godinave me subjektin “ILLYRIAN GUARD SHA” (5.408 mijë lekë) dhe që zenë pjesën më të madhe të shpenzimeve operative.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas procedurave të prokurimit ka kryer shërbim mirëmbajtje automjetesh, blerje goma dhe pjesë këmbimi, blerje materiale për funksionimin e zyrave, mirëmbajtja e paisjeve si fotokopje dhe printera.

Lekë

Pershkrimi	Gjendja ne 01.01.2023	Krijuar gjate periudhes raportuese	Likujduar gjate periudhes raportuese	Gjendja ne 31.12.2023
Eksperte te ndryshem	280.000	2.838.166	2.899.500	218.666
Avokat	-	263.000	230.000	33.000
Përkthyes	94.000	393.301	487.301	-
Shpenzime kadastrale	220.500	954.000	999.900	174.600
T O T A L I	594.500	4.448.467	4.616.701	426.266

Siç shihet edhe nga të dhënat e mësipërme janë zbritur detyrimet e papaguara për këtë grup shpenzimesh.

“**Artikulli 606**” - Buxheti vjetor në “Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individë” për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në fillim të vitit 2023, është 366 mijë lekë, dhe realizuar në masën 366 mijë lekë ose 100%. Ky fond është përdorur vetëm për dhënie e demshperblimit për vjetersine në punë për 2 (dy) ish-punonjesve e Prokurorise së rrethit Pukë, të liruar nga detyra për shkak të ri-organizimit të prokurorive.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, "Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe shkresës së Prokurorise së Përgjithshme, ku është paraqitur kërkesa për transferim fondi me qëllim demshperblimin e punonjesve të liruar nga detyra për shkak të riorganizimit të prokurorive.

Niveli i shpenzimeve të pasqyruara më sipër është rakorduar me degën e thesarit Shkodër, çdo muaj, sipas situacionit analitik, të mbajtur sipas standartit të përgatitur nga Ministria e Financave, situacion i cili është përcjellur çdo muaj në Prokurorinë e Përgjithshme.

❖ **DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LÛFTEN KÛNDER KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS VITI 2024 DHE REKOMANDIME.**

- Duke analizuar punën e bërë gjatë vitit 2023 dhe rezultatet e arritura nga njëra anë, si dhe problematikat apo mangësitë e evidentuara, synojnë që për vitin 2024, të rrisin angazhimin tonë në përmbushjen e plotë dhe në kohë të detyrave kushtetuese dhe ligjore, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit dhe cilësisë së hetimeve gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, përmirësimin më tej të rezultateve vjetore, si dhe në mbrojtjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe gjithashtu në lidhje me detyrat e tjera administrative.
- Gjatë vitit 2024, do të synohet në zbatimin sa më të plotë të të gjitha prioriteteve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave, të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe të vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, si detyra primare me synim përmirësimin e dhe rritjen e efikasitetit së punës së Prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit dhe paligjshmërisë.
- Nxjerrja dhe zbatimi i urdhërave, udhëzime të përgjithshme dhe të posaçme gjatë vitit 2024, duke vlerësuar rastet, nevojat apo mangësitë që janë evidentuar gjatë vitit 2023, do të jetë një detyrë dhe objektiv në drejtim të përmirësimit dhe rregullimit të punës në prokurori dhe implementimin dhe normimin sa më të plotë të praktikave më të mira dhe ruajtjen e standardeve në fazën hetimore dhe atë gjyqësore, si dhe të administrimit në tërësi të prokurorisë.
- Vijimin e plotësisht të organikës dhe strukturës së prokurorisë me prokurorë për vendet vakante me qëllim rregullimin dhe fuqizimin e seksioneve të krijuara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, sipas grupve penale, si dhe bashkërendimin e punës brenda seksioneve dhe mes seksioneve,

me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave dhe roleve të Drejtuesve të Seksioneve dhe mbikqyerjen punës brenda seksioneve, si të prokurorëve, ashtu edhe të oficerëve të policisë gjyqësore në këto seksione.

- Konsolidimin e mëtejshëm dhe garantimin e pavarësisë së Prokurorëve dhe profesionalizmit të oficerëve të policisë gjyqësore në ushtrimin e detyrës në lidhje me ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, duke reflektuar realisht ndryshimet thelbësore që ka pësuar drejtësia penale nga reforma në drejtësi dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies e transparencës qoftë si një detyrim ligjor, ashtu edhe si objektiv për rritjen e besimit të publikut në organin e prokurorisë.
- Konsolidimin e ushtrimit të ndjekjes penale kryesisht nga prokurorët duke rritur numrin e procedimeve penale të filluara kryesisht, në veçanti ato vepra penale që nuk kanë gjetur elaborim në praktikë megjithëse mbeten shqetësim i përgjithshëm, por të cilat nuk janë referuar në prokurori gjatë vitit 2023. Rritja e numrit të çështjeve të filluara kryesisht duhet të jetë një objektiv permanent edhe gjatë vitit 2024 ashtu edhe në vijimësi.
- Rritjen e shpejtësisë së hetimeve, sidomos të çështjeve të mbartura me qëllim uljen e mëtejshme të ngarkesës dhe shmangien e zvarritjes së mëtejshme të çështjeve, veprim që do të ndikojë në uljen e ngarkesës tek çdo prokuror dhe do të lejonte kryerjen e hetimeve sa më të plota dhe cilësore në procedimet në vijimësi dhe mundësinë e rritjen së procedimeve kryesisht dhe atyre proaktive.
- Forcimin e bashkëpunimit sa më të ngushtë me të gjitha policitë gjyqësore, kryesisht me policinë e shtetit, si një hallkë shumë e rëndësishme në luftën kundër kriminalitetit, si dhe me të gjitha instancat dhe organet e tjera ligjzbatuese, me qëllim kryerjen e hetimeve me grupe hetimore dhe sa më cilësore dhe të plota dhe në një kohë sa më të shkurtër të mundshme.
- Forcimin e bashkëpunimit me strukturat e hetimit tatimor dhe doganor dhe me drejtorinë e parandalimit të pastrimit të parave, drejtorinë e agjensive të mbikqyerjes policore dhe të shërbimit të kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve duhet të mbetet një prioritet me qëllim bashkërendimin e punës dhe shfrytëzimin e asetëve dhe i informacioneve që këto agjensi dhe institucione kanë, për realizimin e një hetimi më të plotë dhe të dhe të sukseshëm për veprat penale në kompetencë të tyre.
- Ndryshime ligjore në Kodin e Procedurës Penale, në drejtim të lehtësimit në aplikimin e gjykimeve të posaçme si, Gjykimi i Drejtëpërdrejtë, Gjykimi me Marrëveshje, Urdhëri Penal, etj, kjo pasi ndryshimet e bëra në vitin 2021, në lidhje me seancën paraprake dhe gjykimin e shkurtuar kanë sjellë një ulje të mundësisë së aplikimit të këtyre institutive.
- Të sugjerohen ndryshime në seksionet apo sektorët e krimit ekonomik dhe seksionet e Krimit Kibernetik në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, si në drejtim të trajnimit por, edhe fuqizimit të këtyre seksioneve pasi qoftë referimet e tyre, ashtu edhe kapacitetet e hetimit mbeten prapa, me kushtet aktuale dhe nevojat e hetimit të veprave penale në fushën e krimit ekonomik, pastrimit të parave, referimet pasurore dhe rritjes së rasteve të krimeve kompjuterike, si, falsifikimit kompjuterik, mashtrimin kompjuterik, ndërhyrja në të dhënat kompjuterike, etj.
- Ndryshime ligjore në drejtimin të ndryshimit të kompetencave, strukturës dhe rolit të shërbimeve të policisë gjyqësore pranë Drejtorive Vendore të Tatimeve dhe Dogana pasi

struktura aktuale qëndrore rezulton jo funksionale dhe efikase ku referimet nga këto institucione së paku në dy vitet e fundit janë minimale.

- Shtimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shtimin e rasteve të bashkëpunimit të drejtëpërdrejtë me autoritetet e huaja dhe me vendet kufitare, në veçanti në hetimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, të narkotikëve, të mjeteve motorrike, dhënies ndihmë për kalimin e paligjshëm të kufirit, të pastrimit të produkteve të vepres penale apo veprimtarisë kriminale, kontrabandës, etj.
- Rritjen e numrit të trajnimeve, seminareve dhe grupeve hetimore të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe i administratës, me qëllim rritjen e performancës dhe aftësive të tyre në zbatimin e plotë dhe të drejtë në praktikë, të të gjitha ndryshimeve ligjore, si dhe legjislacionit për të miturit dhe në fushën e hetimit ekonomik financiar dhe në hetimet pasurore, si një detyrim ligjor dhe objektiv për tu realizuar me qëllim përmirësimin e punës së këtij institucioni. Ku duhet pranuar se gjatë vitit 2023, ka pasur një rritje të pjesëmarrjes në këto trajnime.
- Rritjen e numrit të hetimeve proaktive dhe të aplikimit të metodave speciale të hetimit, sidomos në veprat penale të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, në lidhje me narkotikët, pastrimit të produkteve të vepres penale dhe në fushën ekonomike dhe financiare.
- Lehtësimin dhe përdorimin sa më të gjërë të të dhënave dhe databazave të të tretëve (*mundësia e krijimit të një databaze me të dhënat e të gjitha institucioneve*), në lidhje me subjektet dhe institucionet që kanë rregjistra online dhe databazat e institucioneve të ndryshme si, E-Albania, ASHK, TIMS, Gjendja Gjyqësore, QKB, Sistemi i noterisë, etj, pasi mundësia e marrjes së të dhënave prej tyre, në mënyrë të drejtëpërdrejtë (online) apo në një kohë të shkurtër do të ndihmojë në kryerjen e hetimeve, të shpejta, të plota, cilësore dhe të gjithanshme.
- Rekomandojmë edhe mundësinë e marrveshjeve me Bankat dhe Kompanitë Telefonike, në mënyrë që të arritet aksesimi apo komunikimi online dhe marrja e të dhënave në kohë reale nga këto institucione duke shmangur burokracitë dhe vonesat e përgjigjeve nga këto institucione edhe me muaj vonesë.
- Krijimi i një databaze me listat dhe të dhënat e të gjithë ekspertëve dhe përkthyesve në mënyrë që të ketë një komunikim apo njoftim direktë të tyre sipas nevojave të kryerjes së ekspertimeve dhe përkthimeve do të shërbente hetimeve më cilësore dhe në një kohë më të shkurtër të mundshme.
- Rritjen e transparencës ndaj palëve të procesit dhe ndaj publikut, nëpërmjet njoftimit të tyre në lidhje me fazat e hetimit dhe gjyqimit, pasi këto rezultate do të ndikojnë në rritjen e besimit në institucionin tonë.
- Rritja e komunikimit, takimeve dhe së informacioneve ndaj institucioneve dhe shoqatave apo organizatave, qytetarëve, publikut dhe medias, duke bërë evidentimin e punës së bërë nga Prokuroria, si dhe kthimi i përgjigjeve në kohë të shkurtër ndaj subjekteve të ndryshme kërkuese brenda afatit të arsyeshëm dhe me të dhënat e duhura do të shtojë transparencën e këtij institucioni.
- Çdo prokuror duhet të transmetojë në punën e tij dhe në raport me qytetarët dhe publikun, jo vetëm pavarësinë por, në rradhë të parë përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e tij

gjatë ushtrimit të detyrës, i pandikuar nga faktorët korruptive, politik, subjektivë apo të mungesës së etikës dhe profesionalizmit, etj.

- Gjatë vitit 2024, duhet të shtohet bashkëpunimi dhe komunikimi zyrtar dhe informal me Median dhe me publikun në tërësi, por gjithmonë duke respektuar sekretin hetimor, si dhe duke mbrojtuar të dhënat personale, me qëllim informimin në kohë reale dhe periodikisht në lidhje me punën e prokurorisë, si dhe me rezultatet dhe arritjet dhe problematikat që mund të dalin.
- Respektimi i ligjit dhe akteve nënligjore, transparenca dhe informimi në kohë reale dhe të qartë për punën dhe rezultatet e Prokurorisë, si dhe në veçanti për çështjet sensitive apo me interes të gjërë në public, vlerësojmë se do të ketë një ndikim pozitiv në imazhin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në vitin 2024.

Ju faleminderit për vëmendjen!

DREJTUESI I PROKURORISË

ALBERT MURÇAJ

